



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

R A P O R T

**PËR PUNËN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR
VITIN 2018**



Prishtinë
Janar 2019

P Ë R M B A J T J A

Të dhëna të përgjithshme	4
Përbërja e Kuvendit	4
Kryesia e Kuvendit	6
Seanca Plenare	6
Aktiviteti ligjvënës	8
Aktiviteti mbikëqyrës	9
Aktiviteti zgjedhës	9
Komisionet parlamentare	36
1. Komisioni për Buxhet dhe Financa	36
2. Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim	49
3. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit.....	58
4. Komisioni për Integritet Evropian	65
5. Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike	73
6. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte, Inovacion dhe ndërmarrësi	77
7. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal	82
8. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor	91
9. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	97
10. Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media	102
11. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.....	148
12. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.....	110
13. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	116
14. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë	124
Komisionet ad-hoc.....	127
Institucionet dhe agjencitë e pavarura.....	128
Hulumtimet legjislative/ parlamentare	133
Transparenca e punës së Kuvendit	134
Protokolli dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	136
Raportet preliminare dhe hartimi i deklaratës së pajtueshmërisë së projektakteve të inicuar nga Kuvendi	138
Të dhënat për të punësuarit në Administratën e Kuvendit të Kosovës	139
Të dhënat për Buxhetin e Kuvendit gjatë vitit 218	139
Të dhënat për prokurimet e zhvilluara gjatë vitit 2018	143

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Në bazë të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, "Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli".

Kuvendi i Republikës së Kosovës i ushtron kompetencat në përputhje me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës:

1. Miraton Kushtetutën, ligje, rezoluta, deklarata dhe akte të tjera të përgjithshme.
2. Vendos ta ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë edhe dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë.
3. Shpall referendum, në pajtim me ligjin.
4. Ratifikon traktate ndërkombëtare.
5. Miraton buxhetin e Republikës së Kosovës.
6. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit.
7. Zgjedh dhe mund ta shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës, në përputhje me Kushtetutën.
8. Zgjedh Qeverinë dhe mund të shprehë mosbesimin ndaj saj.
9. Mbikëqyrë punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve i raportojnë Kuvendit.
10. Zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në përputhje me Kushtetutën.
11. Propozon gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese.
12. Mbikëqyrë politikën e jashtme dhe politikën e sigurisë.
13. Jep pëlqimin për dekretin e Presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme.
14. Vendos për çështjet e interesit të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.
15. Jep amnisti me ligj përkatës, i cili miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve.

Përbërja e Kuvendit


Sipas nenit 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi ka njëqindnjëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet e mbajtura për Kuvend.

Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqindnjëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon:

1. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

2. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim:

- komuniteti rom 1 (një) vend;
- komuniteti ashkali 1 (një) vend;
- komuniteti egjiptian 1 (një) vend; dhe
- 1 (një) vend shtesë do t'i jepet komunitetit rom, ashkali ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme;
- komuniteti boshnjak 3 (tri) vende,
- komuniteti turk 2 (dy) vende dhe
- komuniteti goran 1 (një) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.



RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR VITIN 2018

Ky raport përfshin aktivitetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës (Kryesise se Kuvendit, Seanca Plenare, Komisionet Parlamentare), në ushtrimin e funksionit ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues.

Në këtë informatë të shkurtër është përfshirë aktiviteti i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Kryesia e Kuvendit, Seanca Plenare, Komisionet Parlamentare) për periudhën 15 janar – 31 dhjetor 2018, në ushtrimin e funksionit të tij ligjvënës, të funksionit mbikëqyrës dhe të funksionit përfaqësues.

Kryesia e Kuvendit

Kryesia e Kuvendit, në kuadër të kompetencave, në bazë të nenit 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 15 të Rregullores së Kuvendit, ka mbajtur 41 mbledhje, me pjesëmarrje edhe të kryetarëve të grupeve parlamentare, në të cilat ka përgatitur rendin e ditës për 42 seanca plenare, ka nxjerr 384 vendime, ka nxjerrë 73 përfundime, si dhe është marrë me organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, organeve të tij dhe të Administratës së Kuvendit.

Aktivitetet e Kryesisë së Kuvendit gjatë vitit 2018	Nr.
Mbledhje	41
Vendime	384
Përfundime	73

Seanca Plenare

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në ushtrimin e funksionit të tij ligjvënës, funksionit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit dhe funksionin përfaqësues ka mbajtur 42 seanca (prej tyre 14 seanca të jashtëzakonshme, 4 seanca solemne dhe 1 seancë komemorative).

Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë periudhës raportuese ka kryer këto aktivitete:

- Ka mbajtur 42 seanca (prej tyre 14 seanca të jashtëzakonshme, 4 seanca solemne dhe 1 seancë komemorative),
- Ka miratuar 193 vendime,
- Ka nxjerrë 1 përfundim,
- Ka shqyrtuar 102 projektligje,
- Ka miratuar 75 ligje (prej tyre 19 marrëveshje dhe traktate ndërkombëtare),
- Janë në procedurë 56 projektligje,
- Janë në procedurë **për shqyrtim të parë 22 projektligje.**

- Janë në procedurë **për shqyrtim të dytë 34 projektligje**,
- Janë proceduar (propozuara) 115 projektligje (prej tyre 97 janë propozuar nga Qeveria dhe 18 nga Kuvendi),
- **Nuk janë miratuar 8 projektligje** (prej tyre 3 Projektligje për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare),
- Qeveria e **ka tërhequr** 1 projektligj,
- Ka formuar 3 Komisione Hetimore parlamentare,
- Ka formuar 10 komisione Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për Institucionet dhe agjencive të e pavarura të cilat i raportojnë Kuvendit,
- Janë proceduar në seancë plenare 227 pyetje parlamentare për përgjigje me gojë, prej tyre 113 pyetje parlamentare kanë marrë përgjigje, 71 pyetje nuk kanë marrë përgjigje dhe janë publikuar në Boletin, 22 pyetje janë tërhequr nga procedimi me kërkesë të deputetëve, 7 pyetje janë tërhequr nga procedimi për shkak të dorëheqjes së ministrave apo deputetëve, ndërsa 14 pyetje janë në pritje për procedim në seancë plenare.
- Deputetët kanë parashtruar 15 pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim, prej tyre vetëm 1 ka marrë përgjigje, ndërsa 14 nuk kanë marrë përgjigje dhe janë publikuar në Boletin,
- Janë zhvilluar 12 Interpelanca,
- Janë zhvilluar 21 debate parlamentare,
- Janë zgjedhur 58 anëtarë të institucioneve dhe agjencive të pavarura të cilat i raportojnë Kuvendit,
- Ka miratuar 33 raporte të institucioneve dhe agjencive të pavarura, si dhe 1 Raport vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017,
- Ka mbikëqyr zbatimin e tre (3) ligjeve,
- Ka miratuar 15 Rezoluta,
- Ka nxjerrë 12 Rekomandime,
- Ka miratuar 4 dokumente strategjike.
-

Aktivitetet e Kuvendit gjatë vitit 2018	Nr.
Seanca Plenare	23
Seanca të jashtëzakonshme	14
Seanca solemne	4
Seanca komemorative	1
Vendime të seancave plenare	193
Përfundime të seancave plenare	1
Projektligje të propozuara	115
Projektligje të shqyrtuara	102
Projektligje në procedurë	56
Projektligje të tërhequra nga Qeveria	1
Ligje të miratuara	75
Pyetje parlamentare për përgjigje me gojë dhe me shkrim	242

Interpelanca	12
Debate parlamentare	21
Mbikëqyrje të implementimit të ligjeve	3
Raportet e Institucioneve dhe Agjencive Pavarura dhe të Qeverisë së Kosovës	34
Rezoluta	15
Rekomandime	12
Dokumente strategjike	4

I. Aktiviteti ligjvënës

1. Ligjet

Programi Legjislativ i Qeverisë për Vitin 2018 i ka paraparë 75 projektligje, ndërsa me ndryshime 128 projektligje, në përqindje është ndryshuar 70.66 %.

Projektligje të propozuara nga Qeveria97
 Projektligje të propozuara nga Qeveria nga Programi Legjislativ për vitin 201880

Ligje të miratuara në vitin 2018 75
 (Prej 75 ligjeve, 19 marrëveshje ndërkombëtare)

Ligje të miratuara nga Programi Legjislativ i vitit 2017 35
 Ligje të miratuara nga Programi Legjislativ i Qeverisë për vitin 2018 37
 Projektligje të pa miratuara të Qeverisë 4
 Projektligje të tërhequra nga Qeveria 1

Projektligje të propozuara nga Kuvendi(Komisionet, GP dhe deputetët) 18
 Ligje të miratuara 3
 Projektligje të pa miratuara 4
 Projektligje të gatshme për shqyrtim të dytë (2 p/ligje të vitit 2017)15
 Projektligje në procedurë në Komisione parlamentare40
 P/ligje në procedurë të propozuara nga Qeveria31
 P/ligje në procedurë të propozuara nga deputetët dhe komisionet9

Ligje të kthyera nga Presidenti2
 1. Ligji nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare,
 2. Ligji nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare.

Ligje të miratuara me procedurë të përshpejtuar 17 (prej tyre 6 marrëveshje ndërkombëtare).

Vendime të miratuara të seancës plenare 193
Rezoluta.....15
Rekomandime.....12

II. AKTIVITETI MBIKËQYRËS I KUVENDIT /Mbikëqyrje e punës së Qeverisë dhe e zbatimit të Ligjit/

1. Interpelanca	12
2. Debate parlamentare	21
3. Pyetjet parlamentare me gojë.....	227
– 113 pyetje kanë marrë përgjigje	
– 71 pyetje nuk kanë marrë përgjigje	
– 22 pyetje janë tërhequr nga procedimi me kërkesë të deputetëve,	
– 7 pyetje janë tërhequr nga procedimi për shkak të dorëheqjes së ministrave apo deputetëve,	
– 14 pyetje janë në pritje për procedim në seancë plenare.	
4. Pyetjet parlamentare me shkrim	15
– 1 pyetje ka marrë përgjigje	
– 14 nuk kanë marrë përgjigje dhe janë publikuar në Buletin.	
5. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve	3
6. Raporte të organeve të pavarura, të miratuara.....	34
7. Raporte të organeve të pavarura, të pa miratuara.....	1
<i>Raporti vjetor i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2017</i>	

III. AKTIVITETI ZGJEDHËS I KUVENDIT

1. Zgjedhja e anëtarëve në organet e pavarura

- Zgjedhja e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit, 26.01.2018
- Zgjedhja e një (1) kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, 26.01.2018,
- Përzgjedhja Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, 15.03.2018,
- Emërimi i dy (2) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, 15.03.2018,
- Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës (nga komuniteti serb)15.03.2018,
- Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa, 15.03.2018,
- Emërimi i 5 anëtarëve dhe 5 zv/anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës, 15.03.2018,
- Emërimi i dy (2) anëtarëve të Komisionin për verifikimin dhe vendosje të pronave, 30.03.2018,

- Emërimi i dy (2) anëtarëve të Komisionin për verifikimin dhe vendosje të pronave 30.03.2018,
- Ratifikimi i nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (Agjencia për Akreditim – Arsim), 17.04.2018,
- Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave (një shqiptar - Violeta Hyseni-Kelmendi dhe një serb -Maja Slaviq), 17.04.2018,
- Përzgjedhja e dy (2) gjyqtarëve tjerë të Gjykatës Kushtetuese (jo shqiptar: Radomir Laban dhe Bajram Ljatifi), për t'i propozuar Presidentit, 18.05.2018
- Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave (Muja Ferati dhe Anita Muriqi), 30.05.2018,
- Emërimi i gjashtë (6) anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, 31.05.2018,
- Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, 06.06.2018,
- Përzgjedhja e tre (3) gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 06.07.2018,
- Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radha e komunitetit shqiptar, 15.10.2018,
- Emërimi i kryesuesit dhe katër (4) anëtarëve të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, 02.11.2018,
- Emërimi i Kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, 02.11.2018.

2. Formimi i Komisioneve Hetimore Parlamentare (Komisione)

- Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë të Republikës së Kosovës, 07.06.2018,
- Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, 28.06.2018,
- Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars 2018, 28 06.2018.

3. Formimi i Komisioneve Ad-Hoc

- Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shumicë-shqiptar, 25.01.2018,
- Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa, 25.01.2018,
- Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar nga radhët e komunitetit shqiptar dhe dy (2) anëtarëve nga radhët e komuniteteve joshqiptare të Komisionit të Pavarur të Mediave, 15.03.2018,

- Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga radhët e komunitetit shqiptar, 26.04.2018,
- Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shqiptar, 03.05.2018,
- Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga radhët e komuniteteve jo shumicë, 06.06.2018,
- Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar nga komuniteti shumicë-shqiptar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, 12.07.2018,
- Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shumicë-shqiptar 15.10.2018,
- Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radha e komunitetit jo-shumicë 02.11.2018,
- Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb, 02.11.2018.

IV. AKTIVITETI PËRMBLEDHËS I KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	426
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	1884
3.	Procesverbale të hartuara	410
4.	Projektligje të shqyrtuara	107
5.	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komision	40
6.	Numri i grupeve punuese të formuara	91
7.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	211
8.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit të përhershëm (të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)	5952
9.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të komisionit të përhershëm (të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)	265
10.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit funksional	1724
11.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të komisionit funksional	109
12.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	3
13.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	33
14.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	53
15.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	110
16.	Numri i raportimeve të ministrave	104
17.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	60
18.	Vizitat e realizuara brenda vendit	67
19.	Dëgjime publike	26

20.	Monitorimi i ligjeve	4
21.	Monitorimi i ligjeve në procedurë në komision	16
22.	Tryeza	23

I. **LIGJET E MIRATUARA**

1. Ligji nr. 06/L-019 për Standardizim,
2. Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme,
3. Ligji nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare,
4. Ligji nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës,
5. Ligji nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-214,
6. Ligji nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike,
7. Ligji nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelktuale,
8. Ligji nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080,
9. Ligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
10. Ligji Nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-034,
11. Ligji nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike,
12. Ligji nr. 06/L-026 për Azil,
13. Ligji nr.06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-219 për të huajt,
14. Ligji nr.06/L-029 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore,
15. Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim,
16. Ligji nr.06/L-037 për metrologji,
17. Ligji nr.06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vletësim të konformitetit,
18. Ligji nr.06/L-031 për pajisjet nën presion,
19. Ligji nr.06/L-039 për shërbimin gjeologjik të Kosovës,
20. Ligji nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën,
21. Ligji nr.06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit,
22. Ligji nr.06/L-040 për masat mbrojtëse në importe,
23. Ligji nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
24. Ligji nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
25. Ligji nr.06/L-046 për Inspektoratin e arsimit në Republikën e Kosovës,
26. Ligji nr.06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut,
27. Ligji nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim,
28. Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur,

29. Ligji nr. 06/L-066 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë shoferi,
30. Ligji nr. 06/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120,
31. Ligji nr. 06/L-069 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e trafikut rrugor,
32. Ligji nr. 06/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 179 për Transportin rrugor,
33. Ligji nr. 06/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L- 183 për Transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,
34. Ligji nr. 06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike,
35. Ligji nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz,
36. Ligji nr. 06/L-049 për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë,
37. Ligji nr.06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale,
38. Ligji nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë,
39. Ligji nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare,
40. Projektligji nr.06/L-033 për produkte të ndërtimit,
41. Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës,
42. Ligji nr. 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jo-kontestimore,
43. Ligji nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgimin në Kosovë,
44. Ligji nr. 06/L-010 për Noterinë,
45. Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat,
46. Ligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
47. Ligji nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve,
48. Ligji nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve,
49. Ligji nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë,
50. Ligji nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes,
51. Ligji nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës,
52. Ligji nr. 06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës,
53. Ligji nr. 06/L-038 për Shërbimet postare,
54. Ligji nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës,
55. Ligji nr. 06/L-067 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,
56. Ligji nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës.

II. MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE TË RATIFIKUARA ME LIGJ

1. Ligji nr. 06/L-053 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA REF. NO. 8116-00/2016LR 2016,
2. Ligji nr.06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi,

3. Ligji nr. 06/L-063 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Autostradës Kijevë-Zahaq,
4. Ligji nr. 06/L-061 për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi transferimin e personave të dënuar,
5. Ligji nr. 06/L-062 për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Ekstradim,
6. Ligji nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) 2014-2020,
7. Ligji nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian,
8. Ligji nr. 06/L-094 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Republikës së Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”,
9. Ligji nr. 06/L-095 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS +” Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport,
10. Ligji nr. 06/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime, për projektin e Autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq,
11. Ligji nr. 06/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin Evropa kreative për mbështetjen e sektorëve kulturorë dhe kreativ,
12. Ligji nr. 06/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, lidhur me Programin Mbështetës për Ujësjetës dhe Kanalizim në Zonat Rurale – Faza VI,
13. Ligji nr. 06/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës,
14. Ligji nr. 06/L-107 për ratifikimin e Marrëveshjes për Sigurime Sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës,
15. Ligji nr. 06/L-108 për ratifikimin e Marrëveshjes Sigurime Sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës,
16. Ligji nr. 06/L-103 për Ratifikimin e ndryshimit dhe plotësimit nr. 1 të Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian,

17. Ligji nr. 06/L-078 për ratifikimin e “Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut në kuadër të Projektit të bashkëpunimit zhvillimor, KSV/019: asistencë teknike në kontekstet e integritit evropian”,
18. Ligji nr. 06/L-129 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ (Giz Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit Agjencioni Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar) për Bashkëfinancimin e Projektit Cetep,
19. Ligji nr. 06/L-109 për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit.

III. PROJEKTLIGJET TË CILAT NUK JANË MIRATUAR NË LEXIM TË PARË

1. Projektligji nr. 06/L-050 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave,
2. Projektligji nr. 06/L-051 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar,
3. Projektligji nr. 06/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale,
4. Projektligji nr.06/L-030 për aktet juridike,
5. Projektligji nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme.

IV. MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE QË NUK JANË MIRATUAR

1. Projektligji nr.06/L-044 për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA),
2. Projektligji nr.06/L-045 për ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica,
3. Projektligji nr.06/L-099 për Aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për Themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA).

V. PROJEKTLIGJET TË TËRHEQURA NGA QEVERIA

1. Projektligji nr.06/L-028 për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

VI. LIGJE TË KTHYERA NGA PRESIDENTI

1. Ligji nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare,
2. Ligji nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare.

VII. LIGJET E MIRATUARA ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR

1. Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme,
2. Ligji nr.06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi,
3. Ligjit nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080,
4. Ligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
5. Ligji nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034,
6. Ligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e brendshëm të financave publike,
7. Ligji nr. 06/L-026 për Azil,
8. Ligji nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt,
9. Ligji nr. 06/L-029 mbi Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Sigurinë Bërthamore,
10. Ligji nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim,
11. Ligji nr. 06/L-037 për metrologji,
12. Ligji nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,
13. Ligji nr. 06/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime, për projektin e Autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq,
14. Ligji nr. 06/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës,
15. Ligji nr. 06/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin Evropa kreative për mbështetjen e sektorëve kulturorë dhe kreativ,
16. Ligji nr. 06/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, lidhur me Programin Mbështetës për Ujësjiellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale – Faza VI,

17. Ligji nr. 06/L-129 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ (Giz Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit Agjencioni Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar) për Bashkëfinancimin e Projektit Cetep.

VIII. FORMIMI I KOMISIONEVE HETIMORE PARLAMENTARE

Numri rendor	Komisioni hetimor	Data e formimit
1.	Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë të Republikës së Kosovës	07.06.2018
2.	Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës	28.06.2018
3.	Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars 2018	28.06.2018

IX. FORMIMI I KOMISIONEVE AD-HOC

Numri rendor	Komisioni AD-DOC	Data e formimit
1.	Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar nga komuniteti shumicë-shqiptar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës	25.01.2018
2.	Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa	25.01.2018
3.	Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar nga radhët e komunitetit shqiptar dhe dy (2) anëtarëve nga radhët e komuniteteve joshqiptare të Komisionit të Pavarur të Mediave	15.03.2018
4.	Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga radhët e komunitetit shqiptar,	26.04.2018
5.	Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shqiptar	03.05.2018
6.	Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga radhët e komuniteteve jo shumicë	06.06.2018
7.	Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shumicë-shqiptar	12.07.2018
8.	Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shumicë-shqiptar	15.10.2018
9.	Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1)	02.11.2018

	anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radha e komunitetit jo-shumicë	
10	Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb	02.11.2018

X. INTERPELANCAT

Numri rendor	Propozuesi	Çështja e interpelancës	Data e zhvillimit të interpelanës
1.	GP i LDK-së	Interpelanca e Kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta informuar Kuvendin në lidhje me gjuajtje me armë nga z. Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike.	26.01.2018
2.	GP i LDK-së dhe GP i LVV-së	Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe GP të Lëvizjes Vetëvendosjes lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.04/20 të datës 20.12.2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24 i datës 12 janar 2018, për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarave që marrin paga nga buxheti i Kosovës, si dhe Vendimi nr. 15/24 i datës 12 janar 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në Skemën e Ndhimave Sociale.	01.03.2018
3.	GP i LVV-së	Interpelancë e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari.	16.03.2018
4.	GP i LVV-së	Interpelanca e ministrit të Shëndetësisë, z. Uran Ismajli, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me Sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës.	17.04. 2018
5.	GP i LVV-së	Interpelancë e Kryeministri të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë.	26.04.2018
		Interpelancë e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj për ta informuar	

6.	GP i LDK-së	Kuvendin në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.02/34, të datës 05.03.2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion euro për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës.	31.05.2018
7.	Grupi Parlamentar “Deputetët e Pavarur”,	Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar “Deputetët e Pavarur - PSD”, në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e Termocentralit “Kosova e Re” të nënshkruar me 20 dhjetor 2017.	31.05.2018
8.	GP i LVV-së	Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës.	08.06.2018
9.	GP i LVV-së dhe i LDK-së	Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP-LVV dhe të GP të LDK në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës.	08.06.2018
10.	GP i LDK-së	Interpelancë e Kryeministrit në lidhje me vendimet e Ministrit Rikallo për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione.	14.06.2018
11.	GP i LDK-së	Interpelanca e Ministres së Integritimit Evropian, znj. Dhurata Hoxha, në lidhje me zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) për kuartalin e katërt (K4) 2017 dhe kuartalin e parë (K1) 2018.	19.06.2018
12.	GP: LVV dhe LDK	Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP-të Lëvizjes Vetëvendosje dhe GP të LDK-së, në lidhje me vendimin e Qeverisë Nr.01/50 të datës 05.06.2018 për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë Bechtel & Enka në Kontratën për ndërtimin e Autostradës R6, “Arbën Xhaferi” Prishtinë-Hani i Elezit	05.07.2018

XI. DEBATET PARLAMENTARE

Numri rendor	Propozuesi	Çështjet për të cilën është kërkuar debati parlamentar	Data e mbajtjes së debatit parlamentar
1	Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, i mbështetur edhe nga 39 deputetët tjerë nënshkrues	Debat parlamentar lidhur me ndotjen alarmante të ajrit	31.01.2018 dhe 01.02.2018
2	GP i LVV-së	Debat parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me dënimin e disa aktivistëve të këtij subjekti politik	08.02.2018 dhe 09.02.2018
3	Deputetët Avdullah Hoti dhe Arbërie Nagavci, të mbështetur edhe nga 38 deputetët tjerë nënshkrues	Debat parlamentar lidhur me Vendimin e Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lart (EQAR) për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit	07.03.2018
4	Deputetja Fatmire Kollçaku, e mbështetur edhe nga 8 deputetë nënshkrues nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje	Debat parlamentar në lidhje me dhunën në familje dhe adresimin institucional	08.03.2018
5	Nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe gjashtë (6) deputetëve nënshkrues	Debat parlamentar, sipas kërkesës së nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe gjashtë (6) deputetëve nënshkrues lidhur me Raportin e 100 ditëve të punës të Qeverisë së Republikës të Kosovës	14.03.2018
6	40 deputetë	Debat parlamentar lidhur me rastin e depërtimit të gjashtë (6) shtetaseve të Republikës së Turqisë	04.04.2018
7	Deputetët: Ganimete Musliu, Salih	Debat parlamentar në lidhje me skandalin e mishit të prishur të	18.04.2018

	Salihu, Driton Çaushi, mbështetur nga deputetë tjerë	ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë	
8	Deputetja Shqipe Pantina, e mbështetur edhe nga 11 deputetë nënshkrues	Debat parlamentar në lidhje me luftimin e korrupsionit si kriter për liberalizim të vizave	18.04.2018
9	Deputetja Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 5 deputetë	Debat parlamentar në lidhje me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë	18.04.2018
10	40 deputetë	Debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës	20.04.2018
11	70 deputetë, përfaqësuar nga deputetët: Saranda Bogujevci dhe Andin Hoti	Debat Parlamentar për personat e pagjetur	27.04.2018
12	GP i LVV-së LVV	Debat parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës, sipas kërkesës së GP të LVV	30.05.2018
13	Deputeti Visar Ymeri, mbështetur edhe nga 11 deputetë	Debat parlamentar në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, mbështetur edhe nga 11 deputetë,	04.06.2018
14	Deputeti Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë	Debat parlamentar në lidhje me kartonin e gjelbër, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë	04.06.2018
15	Deputeti Fidan Rekaliu, mbështetur edhe nga 5 deputetë	Debat parlamentar në lidhje me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare, sipas kërkesës së deputetit Fidan Rekaliu, mbështetur edhe nga 5 deputetë	04.06.2018

16	GP - LDK	Debat parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021	28.06.2018
17	GP - PSD	Debat parlamentar për dialogun me Serbinë	26.07.2018 dhe 30.07.2018
18	Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga 7 deputetët nënshkruar nga GP i AAK-së	Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga 7 deputetët nënshkruar nga GP i AAK-së, në lidhje me shtesat e fëmijëve.	15.10.2018
19	42 deputetë	Debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korigjim të kufijve” në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë	31.10.2018
20	42 deputetë	Debat parlamentar lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës	22.11.2018
21	40 deputetë	Debat parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mos liberalizim të vizave.	04.12.2018

XV. ZGJEDHJET E ANËTARËVE TË INSTITUCIONEVE DHE AGJENCIVE TË PAVARURA

Numri rendor	Zgjedhja e institucioneve të pavarura	Data e zgjedhjes
1	Zgjedhja e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit	26.01.2018
2	Zgjedhja e një (1) kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës	26.01.2018
3	Përzgjedhja Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës	15.03.2018

4	Emërimi i dy (2) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë	15.03.2018
5	Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës (nga komuniteti serb)	15.03.2018
6	Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa	15.03.2018
7	Emërimi i 5 anëtarëve dhe 5 zv/anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të Jurisprudencës	15.03.2018
8	Emërimi i dy (2) anëtarëve të Komisionin për verifikimin dhe vendosje të pronave	30.03.2018
9	Emërimi i dy (2) anëtarëve të Komisionin për verifikimin dhe vendosje të pronave	30.03.2018
10	Ratifikimi i nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (Agjencia për Akreditim – Arsim)	17.04.2018
11	Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave	17.04.2018
12	Përzgjedhja e dy (2) gjyqtarëve tjerë të Gjykatës Kushtetuese	18.05.2018
13	Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave	30.05.2018
14	Emërimi i gjashtë (6) anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit	31.05.2018
15	Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.	06.06.2018
16	Përzgjedhja e tre (3) gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës	06.07.2018
17	Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radha e komunitetit shqiptar	15.10.2018
18	Emërimi i kryesuesit dhe katër (4) anëtarëve të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale	02.11.2018
19	Emërimi i Kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik	02.11.2018

XII. MIRATIMI I RAPORTEVE TË INSTITUCIONEVE DHE AGJENCIVE TË PAVARURA

1	Raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016	25.01.2018
---	---	------------

2	Raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016	25.01.2018
3	Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016	26.01.2018
4	Raporti vjetor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016	26.01.2018
5	Raporti vjetor i Performancës së Zyrës Kombëtare të Audimit dhe i Pasqyrave financiare për vitin 2016, së bashku me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike	09.02.2018
6	Raporti për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016	15.03.2018
7	Raporti i performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe 2016	30.03.2018
8	Raporti i operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut-KOSTT sh. a për vitin 2016	17.04.2018
9	Raporti vjetor i Zyres së Rregullatorit për Energji për vitin 2017, me rekomandimet e Komisionit funksional	30.05.2018
10	Raporti vjetor i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017	30.05.2018
11	Raporti Vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017	04.06.2018
12	Raporti vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017.	06.06.2018
13	Raporti vjetor i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017	06.06.2018
14	Raporti vjetor i statistikave zyrtare për vitin 2017	06.06.2018
15	Raporti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017	06.06.2018
16	Raporti vjetor i Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017	14.06.2018
17	Raporti vjetor i Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017	14.06.2018
18	Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017	23.07.2018
19	Raporti vjetor i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017	23.07.2018
20	Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017	23.07.2018

21	Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për miniera dhe minerale për vitin 2017	23.07.2018
22	Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ të unionit nga KEDS-i, e cila 15.10.2018	
23	Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017	15.10.2018
24	Raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017	15.10.2018
25	Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017	15.10.2018
26	Raporti vjetor i Autoritetit rregullator për ujëra për vitin 2017	15.10.2018
27	Raporti vjetor i performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017, së bashku me rekomandimet e Komisionit funksional	15.10.2018
28	Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017	15.10.2018
29	Raporti vjetor i Qeverisë për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2017, bashkë me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike	02.11.2018
30	Raporti vjetor i Auditimit të Kompanisë Regjionale të Ujësjetës Prishtina Sh. A për vitin 2017, bashkë me Rekomandimet e Komisionit Funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike	02.11.2018
31	Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2017	02.11.2018
32	Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017	02.11.2018
33	Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017	21.12.2018
34	Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017	15.10.2018

XIII. MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË LIGJEVE

Numri rendor	Emri i ligjit	Komisioni funksional	Shqyrtimi në seancë dhe miratimi i Raportit të Komisionit
---------------------	----------------------	-----------------------------	--

			funksional
1.	Ligji për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare	Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	Është miratuar raporti me rekomandime të Komisionit Funksionale në seancën plenare më 06.06.2018
2.	Ligji Nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi	Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	Raporti i Komisionit funksional më 23.11.2018 Në pritje të miratimit të këtij Raporti
3.	Ligji nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare	Komisioni për Buxhet dhe Financa	Raporti i Komisionit funksional më 23.11.2018 Në pritje të miratimit të këtij Raporti

XIV. REZOLUTAT

Numri rendor	Propozuesi	Rezoluta	Data e miratimit
1	Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	REZOLUTË për miratimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (ose Agjendën 2030)	25.01.2018
2	Kryetari i Kuvednit dhe Grupet parlamentare	REZOLUTË lidhur me gjendjen alarmante të ajrit	01.02.2018
3	Deputetët Saranda Bogujevci, Andin Hoti (mbështetur nga 70 deputetë)	REZOLUTË për personat e pagjetur	03.05.2018
4	Grupi Parlamentar të Partisë Socialdemokrate	REZOLUTË Për heqjen e Roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë	30.05.2018

REZOLUTË			
5	Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, (harmonizuar edhe me grupet tjera parlamentare)	Për heqjen e tërësishme të kontrollit për hyrje/daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në pikat kufitare: Vërmicë, Qafë Prush, dhe Qafë Morinë.	30.05.2018
6	Deputetja Shqipe Pantina, e mbështetur nga 11 deputetë nënshkrues	REZOLUTË lidhur me korrupsionin si kriter për liberalizimin e vizave	31.05.2018
7	GP LVV	REZOLUTË lidhur me gjendjen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë	04.06.2018
8	GP LDK	REZOLUTË lidhur me gjendjen në sektorin e energjisë në Kosovë	05.06.2018
9	Deputeti Fidan Rekalii, i mbështetur nga 5 deputetë	REZOLUTË për gjendjen e rinisë në Kosovë	05.06.2018
10	Deputeti Vizar Ymeri i mbështetur nga 11 deputetët	REZOLUTË për unifikimin e pikave doganore Kosovë-Shqipëri	05.06.2018
11	GP i LDK-së	REZOLUTË për zbatimin e MSA	28.06.2018
12	Deputeti Faton Topalli nga GP i PSD-së dhe të harmonizuar edhe me grupet	REZOLUTË për heqjen e kontrollit kufitar për qytetarët nga diaspora	06.07.2018

	tjera parlamentare		
13	GP: LDK dhe LVV	REZOLUTË për gjendjen në PTK dhe VALA	12.07.2018
14	Deputetja Donika Kadaj- Bujupi, në emër të Grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe të harmonizuar edhe me grupet tjera parlamentare	të REZOLUTË për shtesat e fëmijëve Republikës së Kosovës	07.11.2018
15	GP i PSD-së	REZOLUTË Mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë	15.12.2018

XV. MIRATIMI I REKOMANDIMEVE NË SEANCË PLENARE

Numri rendor	Propozuesi	Rekomandimet	Data e nxjerrjes
1.	Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	1. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), urgjentisht të ndal praktikat e kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri të Republikës së Kosovës, te konsumatorët në pjesën tjetër të vendit, 2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me ZRRE-në dhe KEDS-in, të gjej një mënyrë alternative, për t'iu shmangur humbjeve në veri të vendit, duke trajtuar të gjithë konsumatorët, në mënyrë të barabartë, sipas normave kushtetuese dhe ligjeve kundër diskriminimit, 3. ZRRE-ja, në pajtim me Ligjin nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, të nxjerrë një vendim, me anë të të cilit do të miratohej zbritja e tarifave deri në atë masë që do të mundësonte kompensimin e konsumatorëve,	09.02.2018

		të cilët, padrejtësisht, janë faturuar dhe vazhdojnë të faturohen për energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore.	
2.	GP i LVV-së	<p>1. Për rastin e sulmit në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 4 gusht 2016, të kërkohet dhe të mundësohet një hetim i plotë i pavarur ndërkombëtar i tërë rastit nga ndonjëri nga vendet perëndimore të Bashkimit Evropian, përfshirë vendet neutrale të Evropës Perëndimore dhe Zvicrën, por këtë duke e veçuar nga rasti i Astrit Deharit.</p> <p>2. Shkarkim i të gjithë personave nga Policia e Kosovës, të involvuar në këtë rast të inskenuar.</p> <p>3. Shkarkimi dhe suspendimi i të gjithë personave që kanë qenë kompetentë dhe përgjegjës në hierarkinë shtetërore kur ka ndodhur rasti i Astrit Deharit.</p>	09.02.2018
3.	GP i LDK-së dhe GP i LVV-së Harmonizim i tekstit edhe me GP të PDK-së, GP të AKK-së dhe GP “Nisma	<p>1. Brenda afatit të ankimimit të ndërmerren të gjitha veprimet e duhura për të kthyer AKA-në si anëtar i rregullt në EQAR.</p> <p>2. Ministri të raportojë në Kuvend për:</p> <p>a. Arsyet e shkarkimit të Bordit, duke ofruar informata për Komisionin Funkcional (në raportim me dyer të mbyllura, nëse është e nevojshme),</p> <p>b. Për veprimet që janë ndërmarrë ndaj ish-anëtarëve të Bordit për shkeljet e pretenduara që mund t'i kenë bërë ata.</p> <p>3. Ministri ta tërheqë nga Kuvendi për verifikim propozim-vendimin për anëtarë të Bordit.</p> <p>4. Në afatin prej shtatë (7) ditësh, një ekip pune, i përbërë nga të gjitha palët (ekspertë të arsimit, përfaqësues të Ministrisë, përfaqësues të organizatave që monitorojnë punën e arsimit të lartë dhe të tjerë) të përgatisë Udhëzimin Administrativ që miratohet nga ministri, i cili do t'i përcaktojë kriteret dhe procedurat transparente për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit.</p> <p>5. Bazuar në këtë Udhëzim Administrativ, lista e anëtarëve të Bordit të procedohet në Kuvend për miratim.</p> <p>6. Kuvendi obligohet që brenda dhjetë (10) ditësh, nga dita e dorëzimit të propozim-vendimit nga Qeveria, ta radhisë në rend dite të seancës plenare për miratim.</p>	07.03.2018

		<p>7. Kuvendi i rekomandon ministrin të fillojë hartimin e një propozim-ligji të ri për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, i cili siguron autonominë e Agjencisë. o j hartimin e një projektligji të ri për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë i cili siguron pavarësinë e Agjencisë.</p>	
4.	<p>Deputetja Fatmire Kollçaku, e mbështetur edhe nga tetë (8) deputetë nënshkrues nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, në harmonizim me të gjitha grupet parlamentare</p>	<p>1. Rishikimi dhe plotësimi i Ligjit 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje;</p> <p>2. Ndryshimi në Kodin Penal dhe të procedurës penale për veprën penale të dhunës në familje, si dhe fuqizimi i mekanizmit koordinues për parandalimin dhe ndjekjen penale të dhunës në familje, përfshirë dëmshpërblimin për dëmet emocionale të viktimave të dhunës në familje dhe viktimave në baza gjinore;</p> <p>3. Të zbatohet në tërësi strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe plani i veprimit 2016/2020, sidomos nenet që kanë të bëjnë me ri-integrimin e viktimave të dhunës në familje, si dhe rishikimi i këtyre dokumenteve për të reflektuar ndryshimin në legjislacionin konform pikave 1 dhe 2 të kësaj rezolute;</p> <p>4. Avancimi i korrikulave arsimore për edukimin e nxënësve për rëndësinë e barazisë gjinore, si dhe eliminimi i rasteve në korrikula, ku referohet dhuna në familje si mjet komunikimi;</p> <p>5. Përfshirja e strehimoreve në planifikimin e ardhshëm buxhetor për vitin 2019 dhe shqyrtimi i mundësisë për ndihmë të jashtëzakonshme me rishikim të buxhetit për vitin 2018;</p> <p>6. Avancimi i buxhetimit të plotë gjinor në të gjitha institucionet;</p> <p>7. Programe të qarta dhe marrje parasysh e aspekteve të barazisë gjinore në ministrinë e linjës, që mbështetin gratë në biznes dhe punësim, përfshirë programe për riaftësim profesional dhe inkuadrim të grave në tregun e punës;</p>	15.03.2018

		<p>8. Mbështetje politike për programe sociale dhe strehim të viktimave, do të thotë strehim afatgjatë të viktimave të dhunës në familje; dhe</p> <p>9. Mbështetje e qendrave për punë sociale për ofrimin e shërbimeve këshilluese për familje si masë e parandalimit të dhunës dhe ndarjeve të familjes.</p>	
5.	40 deputetë, harmonizuar me grupet parlamentare	<p>1. Të formohet Komisioni Hetimor Parlamentar për ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars 2018.</p> <p>2.Kërkohet nga Grupet Parlamentare që brenda tre ditësh të dërgojnë në Kryesinë e Kuvendit emrat e përfaqësuesve të tyre në këtë Komision, në përputhje me Ligjin për Hetime Parlamentare.</p> <p>3.Në funksion të ndriçimit të plotë të kësaj çështjeje, Kuvendi obligon të gjitha institucionet relevante që lidhen me çështjen në fjalë t'i përgjigjen kërkesave të Komisionit Hetimor.</p> <p>4.Kuvendi mandaton Komisionin Hetimor të shqyrtojë përputhshmërinë e procedurave të ndjekura lidhur me këtë rast me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.</p>	04.04.2018
6.	Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje	<p>1. Qeveria e Republikës së Kosovës të fillojë me funksionalizimin dhe shtrirjen e plotë të Sistemit Informativ Shëndetësor dhe të bëjë publik kalendarin e aktiviteteve.</p> <p>2. Qeveria e Kosovës të implementojë të 22 masat e rekomanduara nga Raporti i Auditorit të Përgjithshëm “Efikasiteti dhe efektiviteti në implementimin e sistemit informativ unik të integruar shëndetësor” Dhjetor 2017.</p> <p>3. Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Oda e profesionistëve shëndetësorë dhe SHSKUK të hartojë dhe përgatisë parakushtet për Sistemin Informativ Shëndetësor ku përfshihen:</p> <p>a. Lista e shërbimeve në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor në Kosovë në institucionet publike e ato private.</p> <p>b. Kontrolli e më pas licencimi i të gjithë profesionistëve shëndetësorë që i plotësojnë kushtet, në sektorin publik dhe atë privat.</p>	26.04.2018

		<p>c. Krijimi i regjistrit shtetëror të punonjësve shëndetësore në të gjitha institucionet publike dhe private</p> <p>d. Ndërtimi i Sistemit të referimit të pacientëve</p> <p>e. Hartimi dhe zyrtarizmi i Udhërrëfyesve klinikë,</p> <p>f. Regjistri shtetëror i barnave.</p> <p>4. Kuvendi i Kosovës i kërkon Bankës Qendrore të Kosovës të paraqesë jo më vonë se 60 ditë pune Raport të detajuar mbi financat dhe operacionet e Kompanive të Sigurimit të licencuara të cilat ofrojnë dhe sigurimet private shëndetësore.</p> <p>5. Qeveria e Republikës së Kosovës bazuar në raportin e performancës së Auditorit të përgjithshëm të adresojë në institucionet e drejtësisë rastet e shkeljeve dhe të dëmit financiar nga mos implementimi në kohë i Projektit për Sistemin Informativ Shëndetësor.</p>	
7.	<p>Deputetët Ganimete Musliu, Salih Salihu dhe Driton Çausi, me 23 deputetë mbeshtetes</p>	<p>1. Kryeministri të merr masa adekuate ndaj përgjegjësve – Bordit dhe menaxhmentit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.</p> <p>2. Organet e drejtësisë të fillojnë menjëherë hetimet ndaj institucioneve përgjegjëse publike dhe subjekteve private që sjellin në treg produkte të dyshimta.</p> <p>3. Të bëhet mbështetje më e madhe buxhetore për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, për konsolidimin e saj me pajisje laboratorike, pajisjen e inspektorëve me kamera personale, ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe shtimin e stafit me inspektorë.</p> <p>4. Në funksion të rritjes së transparencës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të pasqyrojnë të gjitha të dhënat e veprimtarisë së inspektorëve në baza ditore në ëeb faqen e tyre.</p> <p>5. Të rishqyrtohet legjislacioni përkatës që saktëson periudhat kohore minimale, para skadimit të afatit të përdorimit të produkteve ushqimore që importohen në Republikën e Kosovës.</p> <p>6. Të rritet mbështetja financiare për masat</p>	26.04.2018

		mbështetëse të programit për zhvillim rural që rrit prodhimin vendor.	
8.	Deputetja Teuta Haxhiu, mbështetur nga pesë deputetë nënshkrues	<p>1. Qeveria e Republikës së Kosovës obligohet të mbrojë secilin fëmijë nga përmbajtje të dhunshme dhe të dëmshme për zhvillim, duke siguruar që institucionet përgjegjëse të ofrojnë internet të sigurt për shkolla, duke përfshirë vendosjen e filtrave dhe kufizimeve në faqe që përmbajnë përmbajtje joadekuata për fëmijë.</p> <p>2. MASHT, DKA, shkollat organizojnë aktivitete vetëdijesuese për prindër, mësime dhe nxënës për rreziqe që vijnë nga keqshfrytëzimi i internetit.</p> <p>3. Të organizohen trajnime obliguese për zhvillimin e kapaciteteve të mësimeve për përdorimin e TIK-ut në shkolla dhe mbrojtje nga rreziqet në internet.</p> <p>4. Udhëzuesit për përdorim të sigurt të internetit të promovohen dhe mësimeve të obligohen që t'i shfrytëzojnë si burime alternative gjatë procesit të mësimeve.</p> <p>5. Hartimi i rregulloreve në nivel shkollor që të rregullojnë çështjen e përdorimit të internetit brenda hapësirave shkollore.</p> <p>6. Shërbimet profesionale brenda shkollës të krijojnë mekanizma për të adresuar dhunën që buron nga keqshfrytëzimi i internetit, fuqizimi i ekipeve për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve.</p> <p>7. Plani zhvillimor i shkollës të plotësohet me masa dhe veprime konkrete për rritjen e sigurisë në shkollë, duke përfshirë masa konkrete për parandalimin e dhunës nga keqshfrytëzimi i internetit.</p> <p>8. Të organizohen debate dhe programe edukative nëpër televizione nacionale dhe në media të tjera, me qëllim të vetëdijesimit të popullatës për përdorimin e drejtë të internetit.</p> <p>9. Këshilli i prindërve dhe familjarëve nga ana e profesionistëve të punojnë me fëmijë për monitorim të fëmijëve gjatë përdorimit të internetit për të siguruar përdorim të drejtë të internetit nga fëmijët.</p> <p>10. Të vetëdijësohen prindërit dhe t'i monitorojnë fëmijët që të mos përdorin informata të rrejshme për të hapur profilet e</p>	31.05.2018

		<p>tyre si të rritur, pasi që shumica e kompanive të rrjeteve sociale e kanë të rregulluar çështjen e profileve për të rritur nën moshën 14-vjeçare, dhe</p> <p>11. Të sanksionohet me ligj shantazhi i fëmijëve në rrjetet sociale dhe ruajtja e privatësisë së fëmijëve gjatë përdorimit të internetit.</p>	
9.	GP LVV	<p>1. Qeveria brenda dy javëve, në bashkëpunim me menaxhmentin e KEK-ut, ta hartojë planin e masave për reagimin emergjent dhe afatgjatë në sigurimin e prodhimit të energjisë.</p> <p>2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë të mos pranojë kërkesa për rritjen e çmimit të energjisë nga kompania KEDS-KESCO.</p> <p>3. Qeveria e Republikës së Kosovës të iniciojë sa më shpejt rindërtimin e termocentralit “Kosova A”.</p> <p>4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me KEK-un të përshpejtojë planin e remontit të termocentralit “Kosova B”.</p> <p>5. KOSTT-i të realizojë kontraktimin e energjisë elektrike me Shqipërinë për periudhë afatgjatë.</p> <p>6. Qeveria të marrë masa urgjente dhe t’i aplikojë ato për stabilizimin e prodhimit të qymyrit si dhe sanimin e ndërtimeve të kundërligjshme në Shipitullë.</p> <p>7. Të auditohet kontrata e privatizimit të distribucionit nga KEDS-i, e cila nuk është bërë kurrë.</p> <p>8. ZRRE-ja ta kërkojë planin e mirëmbajtjes nga KEDS-i, në mënyrë që ta kontrollojë procesin e shkyçjeve që KESCO po i bën në emër të mirëmbajtjes.</p> <p>9. ZRRE-ja t’i shqyrtojë reduktimet, çmimet e larta, tarifat për biznese që janë dukshëm më të larta, përdorimin e maksigrafit dhe kategorizimin në A+, që ndodhin dhe realizohen nga KEDS-KESCO.</p>	31.05.2018
10.	Deputeti Faton Topalli i mbështetur nga	<p>1. Kuvendi i Kosovës mbështet Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision Funkcional, që t’i koordinojë hapat mbikëqyrës dhe organizativë të institucioneve kompetente në vend, në radhë të parë të</p>	05.06.2018

	11 deputetë	<p>Bankës Qendrore të Kosovës, Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave, me qëllim të zgjidhjes së shpejtë të çështjes në fjalë - duke mos përjashtuar zgjidhjet alternative deri në anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjellbër.</p> <p>2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe grupet punuese që derivojnë nga ai, ka për detyrë që t'i koordinojë dhe ndajë detyrat për institucionet relevante në vend; si dhe t'i përcaktojë veprimet konkrete brenda detyrave për secilin aktor.</p> <p>3. BQK-ja në rolin e saj mbikëqyrës mbi Byronë e Sigurimeve të Kosovës të kërkojë nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës që deri më 30 qershor 2018 ta analizojë lartësinë e primit të Policës Kufitare për ta shikuar mundësinë e uljes së çmimit të saj prej datës 1 korrik 2018.</p> <p>4. Brenda një muaji, Ministria e Punëve të Brendshme obligohet të dalë me plan veprues për reduktimin e automjeteve të paregjistruara që qarkullojnë brenda Republikës së Kosovës.</p> <p>5. Brenda periudhës tremujore, Ministria e Punëve të Brendshme ta reduktojë numrin e automjeteve të paregjistruara nga 20% në 5%.</p> <p>6. Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe grupet punuese që dalin nga ai, më së largu deri më 1 dhjetor 2018 t'ia paraqesin Kuvendit raportin për ecurinë e angazhimeve të secilit institucion. Nëse deri atëherë nuk arrihet zgjidhje e përkohshme apo e përhershme për Kartonin e Gjellbër, t'ia paraqesë Kuvendit koston financiare të njohjes së njëanshme të Kartonit të Gjellbër - si dhe rekomandimin për këtë njohje.</p>	
11.	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	Rekomandime lidhur me Raportin vjetor të Auditimit për vitin 2017.	21.12.2018
12.	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	Rekomandime lidhur me Raportin vjetor të Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Stacionit të Autobusëve në Prishtinë SH.A. për vitin 2017.	21.12.2018

XVI. MIRATIMI I DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Numri	Dokumenti	Propozuesi	Data e miratimit
-------	-----------	------------	------------------

rendor			
1.	Strategjia e Energjisë të Republikës Kosovës për periudhën 2017-2026	Qeveria	26.01.2018
2.	Plani i veprimit për biodiversitetin 2016-2020	Qeveria	30.05.2018
3.	Strategjia shtetërore e ujërave në Kosovë 2017-2036	Qeveria	30.05.2018
4.	Programi Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për periudhën 2018-2022	Qeveria	30.05.2018

II. Komisionet Parlamentare

Komisionet parlamentare (4 të përhershme, 10 funksionale), janë formuar me Vendim të Kuvendit, të datës 3 tetor 2017.

Komisionet parlamentare, gjatë kësaj periudhe përveç aktivitetit ligjvënës kanë bërë edhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, dëgjime publike, tryeza pune, vizita zyrtare brenda dhe jashtë vendit, shqyrtimin e raporteve vjetore të agjencive të pavarura, shqyrtimi i raporteve vjetore të audituara, peticione e të tjera.

Për të gjitha aktivitetet e komisioneve parlamentare, stafi i Drejtorisë për mbështetje komisioneve parlamentare, ka ofruar mbështetje teknike dhe profesionale.

Në këtë Raport për vitin 2018 të legjislaturës së VI, janë pasqyruar aktivitetet e të gjitha komisioneve parlamentare dhe aktivitetet e secilit komision veç e veç, duke përfshirë edhe raportin e zyrtarit Ndërlidhës me Institucionet dhe Agjencionet e Pavarura.

Komisioni për Buxhet dhe Financa

I. Përbërja dhe struktura e komisionit:

1.	Lumir Abdixhiku	kryetar	LDK
2.	Safete Hadergjonaj	zëvendëskryetare e parë	PDK
3.	Jelena Bontiq	zëvendëskryetare e dytë	LS
4.	Naser Osmani	anëtar	LDK
5.	Mërgim Lushtaku	anëtar	PDK
6.	Arbërie Nagavci	anëtare	VV
7.	Ali Lajçi	anëtar	PSD
8.	Dardan Molliqaj	anëtar	PSD
9.	Blerim Kuçi	anëtar	AAK
10	Fikrim Damka	anëtar	GP 6+
11	Enver Hoti	anëtar	Nisma

II. Hyrje

Raporti i punës përmban të dhëna, informacione dhe shënime që pasqyrojnë aktivitetet e komisionit, të realizuara gjatë vitit 2018, në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

III. Fushëveprimi i Komisionit

Komisioni për Buxhet e Financa, është komision i përhershëm. Kompetencat e Komisionit për Buxhet dhe Financa, janë paraparë në shtojcën nr. 2, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Komisioni, në kuadër të fushëveprimit shqyrton:

- Çështjet buxhetore dhe ato financiare;
- Implikimet buxhetore për vitin e parë dhe për vitet në vazhdim, që e shoqërojnë projektligjin dhe bëjnë rekomandime në komisionin përkatës funksional ose në Kuvend;
- Shqyrton raportet periodike të Ministrisë së Financave, për shpenzimet e institucioneve të Kosovës dhe të organizatave buxhetore që i raportojnë Kuvendit;
 - Raporton kohë pas kohe, me iniciativën e vet ose me kërkesën e Kuvendit, në mbledhje plenare për çështjet nga fushëveprimi i tij;
 - Angazhohet për shqyrtimin e programit të Qeverisë, mënyrën dhe nivelin e zbatimit të tij në fushën e financave dhe i jep rekomandime Kuvendit;
 - Mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe ligjeve të tjera që kanë të bëjnë me financat publike;
 - Bashkëpunon me Ministrinë e Financave dhe me Qeverinë, që është e detyruar t'i afrojë të gjitha të dhënat e kërkuara nga ana e komisionit, përfshirë edhe raportimet e ministrit dhe të personave të tjerë të autorizuar të Ministrisë;
 - Shqyrton legjislacionin në fushat që lidhen me lëmin e buxhetit dhe të financave;
 - Të drejtën për të iniciuar dhe hartuar projektligje;
 - Shqyrton projektligjet dhe mocionet, përmbajtjesore lidhur me koston buxhetore, si dhe për veprimtarinë e përgjithshme në Kuvend dhe në institucionet e tjera të Kosovës, që lidhen me fushëveprimin e tij;
 - Komisioni ushtron edhe veprimtari të tjera, të cilat përcaktohen me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës;
 - Shqyrton e çështje të tjera të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe çështjet, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij komisioni.

Në ushtrimin e funksioneve të tij, komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga komisioni.

III. Aktivitetet e Komisionit

Aktivitetet e komisionit për vitin 2018, kanë qenë si vijon:

1. Mbledhjet e komisionit

Komisioni gjatë kësaj periudhe mbajti 27 mbledhje, 18 takime të grupeve punuese dhe 4 mbledhje të përbashkëta me komisionet tjera parlamentare. Gjatë punës së vetë, komisioni, zbatoi rregullat dhe procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit, gjatë kohës së shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjeve, shqyrtimit të çështjeve të parashtruara para komisionit, po ashtu edhe gjatë hartimit të raporteve dhe rekomandimeve për Kuvendin. Në këtë drejtim, komisioni realizoi edhe këto aktivitete:

- Formimi i grupeve të punës për shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve dhe çështjeve të tjera me interes;
- Shqyrtimi i projektligjeve dhe raporteve me amendamente të komisioneve të tjera funksionale, në aspekt të vlerësimit të ndikimit buxhetor të tyre;
- Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit Funksional;
- Shqyrtimi i projektligjeve për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare;
- Organizim i dëgjimit publik dhe takimeve konsultative për çështje të ndryshme;
- Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës;
- Shqyrtimi i raporteve vjetore dhe financiare të institucioneve/agjencive të pavarura;
- Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private;
- Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit;
- Mbledhje të përbashkëta me komisionet tjera parlamentare;
- Dhënia e rekomandimeve dhe mendimeve komisioneve të tjera;
- Dhënia e rekomandimeve, përfundimeve dhe njoftimeve për institucionet dhe organizatat e caktuara buxhetore;
- Hartimi i raporteve me rekomandime, njoftimeve për Kryesinë dhe Kuvendin.

Në Komision ka mbizotëruar një frymë kolegjiale, është punuar me profesionalizëm, ku për çështje me rëndësi dhe përmbajtjesore ka pasur konsensus në marrjen e vendimeve. Me ftesë të komisionit, në takime kanë prezantuar përfaqësues të ministrave (ministra, zëvendësministra, përfaqësues të autorizuar të institucioneve), të agjencive dhe institucioneve të pavarura dhe përfaqësues të organizatave të tjera buxhetore. Për të qenë sa më efektiv në punën e tij, komisioni, formoi *17 grupe punuese*, nga një grup për secilën çështje të parashtruar për shqyrtim. U mbajtën 18 takime të grupeve punuese.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike dhe u monitoruan nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare vendore e ndërkombëtare. Punën e komisionit e kanë vëzhguar përfaqësuesit e USAID-it, Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë, OSBE-së, NDI-së, KDI-së, organizata të shoqërisë civile, asociacione dhe organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, puna e komisionit pati hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe ato elektronike. Puna e komisionit është mbështetur profesionalisht përmes ofrimit të ekspertizave dhe organizimit të punës nga ana GIZ-së.

2. Shqyrtimi i projektligjeve

2.1. Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit Funksional

Në cilësinë e Komisionit Funksional, komisioni shqyrtoi *7 projektligje*, për të cilat i hartoi raportet me rekomandime dhe i propozoi *200 amendamente*. Po ashtu, komisioni shqyrtoi *3 projektligjenë parim*, dhe hartoi raportin me rekomandime për Kuvend. Projektligjet e shqyrtuara, në cilësinë e Komisionit Funksional, janë si vijon:

- *Projektligjin nr. 06/L-032, për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.*

- *Shqyrtimi Projektligjit nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.*
- *Projektligji nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale.*
- *Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe me Ligjin nr.05/L-080.*
- *Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-072 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.*
- *Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-104 për Tatimin në të Ardhurat Personale.*
- *Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.*
- *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.*
- *Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-134 për tatimin mbi vlerën e shtuar.*
- *Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-122 si dhe Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256.*

2.2.Shqyrtimi i projektligjeve për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare

Komisioni shqyrtoi 5 Projektligj për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, për të cilat i hartoi raportet me rekomandime dhe i propozoi 11 amendamente për Kuvendin, si vijon:

- ◆ *Projektligji nr.06/L-063 për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Autostradës Kijevë-Zahaq.*
- ◆ *Projektligjit nr.06/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e Autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq.*
- ◆ *Projektligjit nr. 06/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, lidhur me Programin Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale – Faza VI.*
- ◆ *Projektligjit nr. 06/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës.*
- ◆ *Projektligji nr.06/L-136 për ratifikimin e Marrëveshjes për Kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe “Unicredit Bank Austria Ag”, për Projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për Komunën e Podujevës.*

2.3.Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit të Përhershëm

Në cilësinë e Komisionit të Përhershëm, për periudhën raportuese, komisioni shqyrtoi 68 projektligje dhe 1,655 amendamente të propozuara nga komisionet funksionale, deputetët dhe grupet parlamentare.

3. Shqyrtimi i Raporteve vjetore dhe financiare të Institucioneve dhe agjencive

raportuese në Kuvend

Me qëllim të përmbushjes së detyrave të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit, komisioni, gjatë punës së tij, shqyrtoi raportet vjetore të punës dhe raporte vjetore financiare të institucioneve dhe agjencive raportuese për vitin 2016 dhe 2017. Gjithsej u shqyrtuan 4 raporte vjetore të punës dhe 25 raporte vjetore financiare, Raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës 2017, Raportin financiar për shpenzimet e Kuvendit për vitin 2017, tremujorin, gjashtëmujorin e vitit 2018, si vijon:

- *Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të KOSTT-it për vitin 2016.*
 - *Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë, për vitin 2017.*
 - *Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2017.*
 - *Shqyrtimi i Raportit të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2017*
 - *Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Zyrës Rregullative për Energji, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Akademisë së Drejtësisë, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për*

vitin 2017.

- *Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2017.*
- *Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2017.*
- ◆ *Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2017.*
 - ❖ *Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2017.*
 - ❖ *Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për tremujorin e parë të vitit 2018.*
 - ❖ *Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018.*

Komisioni lidhur me këto raporte nxori rekomandime, për shqyrtim në Kuvend, respektivisht në Kryesinë e Kuvendit.

4. Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private

Gjatë periudhës raportuese, komisioni shqyrtoi kërkesa, propozim-vendime, për të cilat nxori rekomandime për Kuvendin, përkatësisht Kryesinë e Kuvendit dhe institucioneve parashtruese të kërkesave. Ndër rekomandimet e rëndësishme të Komisionit, drejtuar Kuvendit dhe/apo Kryesisë së Kuvendit ishin:

- *Rekomandim në lidhje me Buxhetin e Komunës së Suharekës për vitin 2018.*
- *Rekomandim në lidhje me Buxhetin e Komunës së Lipjanit për vitin 2018.*
- *Rekomandim në lidhje me Buxhetin e Komunës së Kamenicës për vitin 2018.*
- *Rekomandim lidhur me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për periudhën 2019-2021.*
- *Rekomandim për kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2019-2021, në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave 2019/01.*
- *Rekomandimet e Grupit Punues lidhur me pagat, shtesat dhe kompensimet e tjera të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;*
- *Raport me rekomandime lidhur me propozimin e Panelit të Bankës Qendrore për përzgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.*
- *Rekomandim për Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, lidhur me pagat, shtesat dhe kompensimet tjera të të punësuarve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.*
- *Propozim-Vendim për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të*

Komisionit për Ndhmë Shtetërore.

- *Raport me rekomandime lidhur me propozimin Komisionit për Përzgjedhje të kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.*
- *Propozim-Vendim për caktimin e kompensimit për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtarë të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije për Prona.*
- *Raport me rekomandime lidhur me propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.*
- *Përfundim lidhur me Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 11/68, datë 09.10.2018 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit e Qeverisë nr.11/64, të datës 16.12.2015.*
- *Shqyrtimi i kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për miratimin e taksave vjetore për vitin 2019.*

5. Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni më 25.6.2018, organizoi një dëgjim publik për Projektligjin nr.06/L-072 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

Të ftuar pjesëmarrës ishin: kryetari dhe një anëtar nga Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetë, guvernatori i BQK-së, drejtor i Asociacionit të Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës, përfaqësues nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile.

Anëtarët e Komisionit dhe të ftuarit e pranishëm, paraqiten mendimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me përmbajtjen e Projektligjit dhe nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e tij.

6. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

- **Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare**

Komisioni për Buxhet dhe Financa në kuadër të përgjegjësisë për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve të përcaktuar me nenin 73 të Rregullores së punës së Kuvendit dhe në pajtim me planin vjetor të punës, bëri mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

Grupi Punues, në kuadër të aktiviteteve të përcaktuara me Planin e Veprimit, zhvilloi takime me ministrin e Financave, si ministri e linjës. Po ashtu, Grupi Punues realizoi edhe vizita tjera në terren, si: në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Administratës Publike, Bankën Qendrore të Kosovës, Shoqatën e Bankave të Kosovës, Asociacionin e Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare të Kosovës, me ç'rast u zhvilluan takime me ministra, guvernatorin e BQK-së dhe përfaqësues tjerë, ku u diskutua për nivelin e zbatimit të ligjit, në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësi të tyre.

Për të gjitha vizitat e realizuara, Grupi Punues ka përgatitur raporte të veçanta për komisionin si dhe Raportin final me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit,

i cili është miratuar në mbledhjen e Komisionit më 25.7.2018, dhe është proceduar për shqyrtim në Kuvend.

- **Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-168 dhe Ligjin nr.05/L-116**

Komisioni për Buxhet dhe Financa në kuadër të përgjegjësisë për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve të përcaktuar me nenin 73 të Rregullores së punës së Kuvendit dhe në pajtim me planin vjetor të punës, bëri mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-168 dhe Ligjin nr.05/L-116.

Grupi Punues, në kuadër të aktiviteteve të përcaktuara me Planin e Veprimit, zhvilloi takime me ministrin e Financave, si ministri e linjës. Aktivitetet e Grupit Punues, pritet të vazhdojnë gjatë vitit 2019.

7. Raportimi i ministrave dhe udhëheqësve të organizatave buxhetore

Numri i përgjithshëm i ministrave/zv.ministrave, udhëheqësve të institucioneve dhe/apo agjencive të pavarura dhe institucioneve të tjera që kanë raportuar në komision ishte 45. Në kuadër të kësaj, në mbledhjet e komisionit për të dhënë arsytetime në çështjet që ishin objekt shqyrtimi nga komisioni, raportoi ministri i financave, zëvendësministri i financave dhe përfaqësues të organizatave buxhetore, respektivisht të institucioneve dhe agjencive të pavarura. Ministri i Financave/zv.ministri i financave ka raportuar 17 herë në komision, respektivisht grupet punuese të komisionit. Përveç, ministrave dhe zëvendësministrave, në komision raportuan edhe udhëheqësit e institucioneve dhe/apo agjencive të pavarura, dhe atë 28 herë, me rastin e arsytimeve të raporteve vjetore dhe financiare të institucioneve dhe/apo agjencive që udhëheqin për vitin paraprak dhe për çështjet tjera që kanë qenë objekt shqyrtimi në komision.

- **Raportim i drejtorit të Doganave të Kosovës dhe drejtorit të Administratës Tatimore të Kosovës, në kuadër të procesit të monitorimit të realizimit të planit të të hyrave, për tremujorin e parë të vitit 2018**

Në mbledhjen e mbajtur të Komisionit më 8.5.2018, raportuan drejtori i Doganave dhe drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës. Ata raportuan në lidhje me realizimin e planit të të hyrave të këtyre institucioneve për tremujorin e parë të vitit 2018. Përfaqësuesit e Doganave dhe ATK-së, informuan për trendët në realizimin e të hyrave, masat që janë marrë dhe sfidat në të ardhmen.

8. Takimet e komisionit me institucionet ndërkombëtare dhe organizatave që mbështesin komisionin

- **Takimet e Komisionit me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën**

Komisioni për Buxhet dhe Financa, më 23 mars 2018, realizoi një takim me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën. Temat e diskutimit: Korniza Afatmesme Buxhetore, Programi i Reformave në Ekonomi dhe Menaxhimi i Investimeve Publike. Po ashtu, Komisioni për Buxhet dhe Financa, më 26 tetor 2018, ka realizuar një takim me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën, për konsultime sipas artikullit IV. Temat e diskutimit: implementimi i buxhetit 2018, përgatitja e buxhetit 2019 dhe iniciativat tjera ligjore me impakt buxhetore dhe financiar. Specifikisht u diskutua për nivelin e borxhit publik dhe deficitit buxhetor, për koston buxhetore të pensioneve të veteranëve të luftës dhe nevojës për rishikimin e legjislacionit që rregullon këtë çështje, si dhe për nismat tjera ligjore që përmbajnë kosto të lartë buxhetore, që mund të rrezikojë stabilitetin e shëndoshë makrofiskal.

9. Takimet tjera në kuadër të fushëveprimtarisë së punës së Komisionit

- Grupi Punues i caktuar nga Komisioni, më 16.5.2018, mbajti një takim konsultativ lidhur me çështjen e Kartonit të Gjelbër. Në këtë takim, ishin të ftuar dhe prezent, zëvendësministri i Financave, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, guvernatori i BQK-së dhe drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimeve. Në këtë takim u diskutuar në lidhje me mundësinë e zbritjes së primeve të tarifës kufitare për automjetet jashtë vendit, për modalitetet në shitjen e kartonit të gjelbër në Kosovë, zvogëlimin e numri të veturave të paregjistruara në Kosovë dhe koordinimi i aktiviteteve institucionale, për mundësinë e anëtarësimit të Kosovës në Kartonin e Gjelbër në Bruksel. Po ashtu, Grupi Punues me datë 29.11.2018, mbajti një takim ku ishte i ftuar Guvernatori i BQK-së, në të cilin takim u diskutua për nevojën e organizimit të takimeve me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shoqatën e Sigurimeve, në kuadër të procesit të nxjerrjes së një Udhëzimi Administrativ për çështjen e regjistrimit të veturave të paregjistruara.
- Grupi Punues i caktuar nga Komisioni, më 5.6.2018, mbajti një takim konsultativ lidhur me Projektligjin për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare. Në këtë takim, ishin të ftuar dhe prezent kryetari dhe një anëtar i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, guvernatori i BQK-së, përfaqësues nga Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare, nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile dhe përfaqësuesi i Korporatës Ndërkombëtare Financiare të Grupit të Bankës Botërore. Në këtë takim u diskutua lidhur me përmbajtjen e Projektligjit për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, dhe për nevojën e rregullimit dhe funksionimit të institucioneve mikrofinanciare. Pjesëmarrësit e ftuar paraqiten mendimet e tyre lidhur me Projektligjin dhe rekomandimet e tyre i dërguan me shkrim.
- Më datë 10.10.2018, Objektin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, është mbajtur Punëtorja e Përbashkët në mes Komisionit për Buxhet dhe Financa, Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit, e mbështetur nga GIZ. Tema e punëtorisë: Diskutime lidhur me Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2017. Ndër tjera u diskutua edhe për nevojën e trajtimit të rekomandimeve të auditimit, gjatës shqyrtimit të Projektbuxhetit të Kosovës 2018 në Komision.

10. Bashkëpunimi me komisionet e Kuvendit

- Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, më 10.4.2018, mbajti mbledhje të përbashkët, ku u bë shqyrtimi i propozimeve për hartimin e Draft-ligjit për Transmetuesin Publik.
- Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, më 22.3.2018, mbajti një mbledhje të përbashkët në të cilën ministri i Financave, z. Bedri Hamza, raportoi në lidhje me Shpenzimet e Paparashikuara për vitin 2018.
- Më 5.6.2018, në një takim Konsultativ, në lidhje me Projektligjin për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, të organizuar nga Grupi Punues i Komisionit, morën pjesë si të ftuar, kryetari dhe një anëtar i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.
- Më 25.6.2018, në dëgjimin publik për Projektligjin nr.06/L-072 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, të organizuar nga Komisioni, morën pjesë si të ftuar, kryetari dhe një anëtar i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

11. Vizitat brenda vendit

Komisioni, respektivisht Grupi Punues, në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, realizoi 7 vizita në terren, me ç'rast u takua me ministra, guvernatorin e BQK-së dhe përfaqësues tjerë të institucioneve të vizituara. Për të gjitha vizitat e realizuara, Grupi Punues përgatiti Raporte të veçanta për komisionin si dhe Raportin final me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit, i cili është miratuar në Komision dhe është proceduar për shqyrtim në Kuvend. Ndërkaq, Grupi Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, në kuadër të aktiviteteve të planifikuara, zhvillojë një takim në Ministrinë e Financave.

12. Vizitat jashtë vendit

- **Konferenca Ndër-parlamentare, me temë:“Fuqia e kuletës (parasë), fuqitë buxhetore dhe procedurat e PE-së”, 25-27 shkurt 2018, Shkup, Maqedoni**

Zëvendëskryetarja e parë dhe një anëtar i Komisionit, më 25-27 shkurt 2018, morën pjesë në Konferencën Ndër-parlamentare, me temë:“Fuqia e kuletës (parasë), fuqitë buxhetore dhe procedurat e PE-së”, organizuar nga Parlamenti Evropian dhe Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në Shkup..

Pjesëmarrësit e ftuar në Konferencë ishin anëtarët/deputetët e Parlamentit Evropian dhe parlamenteve të vendeve të para-anëtarësimit: Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi, Kosovës, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Turqisë.

Qëllimi i konferencës ishte njohja me procesin dhe procedurat e përgatitjes dhe miratimit të buxhetit të Bashkimit Evropian dhe rolin e institucioneve të BE-së, në këtë proces, veçanërisht për rolin e Parlamentit Evropian në procesin e miratimit dhe mbikëqyrjes buxhetore, si dhe mundësia e shkëmbimit të njohurive dhe përvojave të deputetëve pjesëmarrës të komisioneve buxhetore dhe financiare, me qëllim të mësimit të eksperiencave të reja dhe adaptimin e standardeve evropiane, në procesin e miratimit dhe mbikëqyrjes parlamentare buxhetore, në shtetet e parlamenteve të para-anëtarësimit në BE.

- **Seminari me temë “Politikat Makroekonomike të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Ndërtimi i Kapaciteteve”, 10-14 qershor 2018, Vjenë, Austri**

Kryetari dhe tre anëtarë tjerë të Komisionit, morën pjesë në seminarin me temë “Politikat Makroekonomike të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Ndërtimi i Kapaciteteve”, organizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, që u mbajt në Vjenë-Austri, më 10-14 qershor 2018.

Pjesëmarrësit e ftuar në konferencë ishin anëtarët/deputetët nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe ndoshta Serbia.

Qëllimi i seminarit është rritja e mirëkuptimit të ndërsjellë mbi çështjet ekonomike të zgjedhura nga parlamentet e vendit dhe stafi i FMN-së, me një fokus të veçantë në perspektivën aktuale ekonomike me të cilën përballen vendet në rajon dhe rolin e parlamentarëve në përgjegjshmërinë, transparencën dhe mbikëqyrjen.

- **Punëtorja me temë "Zhvillimi i marrëdhënieve efektive të punës në mes të Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Kuvendit", 26-27 qershor 2018, Strugë, Maqedoni**

Me ftesë nga Auditori i Përgjithshëm, z. Besnik Osmani, më 26-27 qershor 2018, në Strugë të Maqedonisë, u mbajt një punëtori me temë “Zhvillimi i marrëdhënieve efektive të punës në mes të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Kuvendit të Kosovës”, të organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, me përkrahjen e projektit “Reformimi i Sistemeve të Financave Publike në Kosovë” implementuar nga GIZ-i.

Në punëtori morën pjesë Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Auditori i Përgjithshëm (u.d.) i Republikës së Maqedonisë, anëtarët e dy komisioneve parlamentare, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, Grupi për Planifikim Strategjik i ZKA-së dhe përfaqësues të GIZ-it.

Në këtë takim u diskutua për mënyrat e thellimit të bashkëpunimit në mes të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe komisioneve parlamentare, me ç’rast u shqyrtuan edhe përvojat rajonale të këtij bashkëpunimi dhe kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit, si dhe është prezantuar drafti i planit strategjik trevjeçar i Zyrës Kombëtare të Auditimit.

- **Konferencë Ndërparlamentare, me temë: “Menaxhimi i mirë të fondeve të BE-së: Kompetencat e Kontrollit Buxhetor të Parlamentit Evropian”, organizuar nga Parlamenti Evropian, 10-13 korrik 2018, Bruksel -Belgjikë**

Kryetari dhe zëvendëskryetarja e parë Komisionit, më 10-13 korrik 2018, në Bruksel -Belgjikë morën pjesën në Konferencën Ndërparlamentare, me temë: “Menaxhimi i mirë të fondeve të BE-së: Kompetencat e Kontrollit Buxhetor të Parlamentit Evropian”, organizuar nga Parlamenti Evropian.

Pjesëmarrësit e ftuar në konferencë ishin deputetët e Parlamentit Evropian, të institucioneve dhe agjencive të BE-së dhe parlamenteve të vendeve të para-anëtarësimit: Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Bosnjës dhe Hercegovinës.

Qëllimi i konferencës ishte njohja me procesin e kontrollit buxhetor të Parlamentit Evropian dhe roli i Komisionit për Kontroll Buxhetor të PE-së dhe bashkëpunimi dhe

koordinimin me institucionet dhe mekanizmat tjerë institucionalë të BE-së, në procesin e kontrollit buxhetor të buxhetit të Parlamentit Evropian dhe fondeve tjera evropiane, përfshirë edhe fondet e para anëtarësisimit (IPA fondet) të dedikuara për vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe mundësia e shkëmbimit të njohurive dhe përvojave të deputetëve pjesëmarrës të komisioneve buxhetore dhe financiare, me qëllim të mësimin të eksperiencave të reja dhe adaptimin e standardeve evropiane në procesin e miratimit dhe mbikëqyrjes parlamentare buxhetore.

13. Takimet e kryetari të komisionit

Mbledhje konsultative dhe aktivitete të tjera të kryetarit të komisionit, të ndërlidhura me kompetencat e tij dhe të komisionit:

- Takim në mes të kryetarit të Komisionit me përfaqësues nga Ambasada e Britanisë së Madhe, në Prishtinë, Temë diskutimi: Përzgjedhja e Komisionit për Ndhimë Shtetërore.
- Takim në mes të kryetarit të komisionit dhe përfaqësuesve të Shoqatës së Sigurimeve në Kosovë. Temë diskutimi: Kartoni i Gjelbër.
- Takim në mes kryetarit të Komisionit dhe Projektit të USAID-it. Temë diskutimi: Roli dhe funksionet e Komisionit, specifikiht në procesin buxhetor.
- Takim me Bordin e ZRRE-së. Temë diskutimi: Projektbuxheti i ZRRE-së për vitin 2019 dhe Projektligji për Pagat.
- Takim me përfaqësues të KQZ-së. Temë diskutimi: Projektbuxheti i KQZ-së për vitin 2019.

14. Rezime e punës së komisionit

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së komisionit për vitin 2018

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1.	Numri i mbledhje të mbajtura	27
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	218
3.	Procesverbale të hartuara	27
4.	Projektligje të shqyrtuara dhe amendamentuara (në cilësi të Komisionit FunkSIONAL)	6
5.	Projektligje për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare	5
6.	Projektligje të shqyrtuara (në cilësi të komisionit të përhershëm)	68
7.	Projektligje në procedurë të shqyrtimit	8
8.	Numri i amendamente të propozuara	200
9.	Numri i amendamente të shqyrtuara	1,655
10.	Numri i raporteve tjera të hartuara për projektligje (në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL) për komisionet e përhershme	68
11.	Numri final i raporteve të hartuara për projektligje (në cilësi të Komisionit FunkSIONAL) për shqyrtim në Kuvend	6
12.	Numri i Raporteve me rekomandime për Projektligjet për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare	5
13.	Numri i grupeve punuese të formuara	17
14.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	18
15.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	2

16.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve dhe agjencive të pavarura	4
17.	Shqyrtimi i raporteve vjetore financiare të institucioneve dhe agjencive të pavarura	25
18.	Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës	1
19.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	11
20.	Numri i vendimeve të cilat i mori komisioni	18
21.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	4
22.	Vizitat e realizuara brenda vendit	8
23.	Dëgjim publik për Projektligjin nr.06/L-072 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare	1
24.	Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjitnr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare	1
25.	Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit, të papërfunduar	1
26.	Pjesëmarrje e ministrit të Financave dhe zv.ministrit të Financave dhe arsyetimi i çështjeve në kuadër të fushëveprimtarisë së Ministrisë që u shqyrtuan në mbledhje	17
27.	Raportimi i udhëheqësve të institucioneve/agjencive të pavarura në Komision	28
28.	Raportim i drejtorit të Doganave të Kosovës dhe drejtorit të Administratës Tatimore të Kosovës, në kuadër të procesit të monitorimit të realizimit e planit të të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2018	1
29.	Shqyrtimi i raporteve financiare, kërkesave buxhetore të Administratës së Kuvendit të Kosovës dhe raportimi për Kryesinë e Kuvendit	6
30.	Raporte me rekomandime për zgjedhjen e anëtarëve të bordit të institucioneve dhe agjencive të pavarura	3
31.	Rekomandime, njoftime dhe përfundime për Kryesinë e Kuvendit, sipas përfundimit të Kryesisë	1
32.	Mbledhje të përbashkëta me komisionet tjera parlamentare	4
33.	Takime tjera të mbajtura nga Komisioni: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Takim Konsultativ <u>lidhur me Projektligjin për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.</u> ▪ Takim Konsultativ <u>lidhur me Çështjen e Kartonit të Gjelbërt.</u> ▪ <u>Punëtori në mes KBF, KMFP, ZKA dhe GIZ. Tema: Diskutime lidhur me Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2017.</u> 	3
34.	Takim me institucione ndërkombëtare	2

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim Përbërja dhe struktura e Komisionit:

1. Igor Simiq, kryetar (GP – LS);
2. Xhelal Sveçla, nënkryetar i parë (GP –VV);
3. Danush Ademi, nënkryetar i dytë (GP- 6+);
4. Kujtim Shala, anëtar (GP – LDK);
5. Fadil Beka, anëtar (GP – PDK);
6. Haxhi Shala, anëtar (GP – Nisma)
7. Zoran Mojsilović, anëtar (GP– LS);
8. Jasmina Zhivković, anëtare (GP– LS);
5. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-214, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
6. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
7. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
8. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, dhe me Ligjin nr. 05/L-080, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
9. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
10. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
11. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të Huajt, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
12. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-026 për Azil, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
13. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-037 për metrologji, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
14. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-029 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
15. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
16. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
17. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/ Prishtinën, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
18. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-009 për ndërmjetësim, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
19. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-0134 për Mbrojtjen e Konsumatorit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
20. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-027 për miniera dhe minerale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*

21. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
22. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
23. *Shqyrtimi i Projekt-kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të mitur, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
24. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
25. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjaku, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
26. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
27. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-040 për Masat mbrojtëse në importe, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
28. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
29. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-066 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shofer, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
30. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-070 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
31. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
32. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
33. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-069 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e trafikut Rrugor, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
34. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-071 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
35. *Shqyrtimi i Projekt-Rregullores së Kuvendit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
36. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijës dhe Teknologjisë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
37. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*

38. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
39. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës , me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
40. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-022 për Ndërmarrje Sociale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
41. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-043 për lirin e asociimit në Organizata Joqeveritare, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
42. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
43. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
44. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-079 për eficiency e energjisë me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
45. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-132 për automjete, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
46. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
47. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
48. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
49. *Shqyrtimi i Projektligji nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
50. *Shqyrtimi i Projekt-kodit Penal nr. 06/L-074 të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
51. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
52. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
53. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
54. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;;*

55. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
56. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
57. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
58. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 Ligji i sportit ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për sport, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
59. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
60. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
61. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
62. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
63. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
64. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/22 për kinematografinë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
65. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqësuesve, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
66. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
67. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
68. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*
69. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*

70. *Shqyrtimi i Projektligjit nr .06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;*

d) Shqyrtime tjera

Në cilësinë e Komisionit përgjegjës, Komisioni ka shqyrtuar këto dokumente, si:

- *Shqyrtimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018-2022.*

e) Mbajtja e dëgjimeve publike

f) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

g) Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit

Gjatë periudhës së viti 2018, Kryetarja dhe anëtarët e Komisionit kanë realizuar vizitë zyrtare jashtë vendit, si:

➤ **Vizitë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë në Luksemburg;**

Delegacioni i Komisionit për Integritet Evropian ka realizuar një vizitë studimore në Institucionin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, në Luksemburg, nga data 2-3 maj 2018.

➤ **Pjesëmarrja në tre takimet e COSAC-ut;**

○ Kryetarja dhe dy nënkryetarët e Komisionit kanë marrë pjesë në Konferencën e Komisioneve Parlamentare për Çështjet e Bashkimit Evropian të Parlaenteve të BE-së (COSAC), e cila është mbahet në Sofje të Bullgarisë nga data 21 - 22 janar 2018.

○ Ndërsa, kryetarja dhe nënkryetari i parë i Komisionit kanë marrë pjesë në Takimin Plenar LIX të Konferencës së Komisioneve Parlamentare për Çështjet e Bashkimit Evropian të Parlaenteve të BE-së (Plenary COSAC), e cila është organizuar në kuadër të dimensionit parlamentar nga Presidenca Bullgare e Këshillit të BE-së, në Sofje të Bullgarisë nga data 17 - 19 qershor 2018.

○ Gjithashtu, kryetarja dhe nënkryetari i parë i Komisionit kanë marrë pjesë në Takimin Plenar LX të Konferencës së Komisioneve Parlamentare për Çështjet e Bashkimit Evropian të Parlaenteve të BE-së (Plenary COSAC), i organizuar nga Presidenca Austriake e Këshillit të BE-së, në Vjenë të Austrisë nga data 18 deri me 20 nëntor 2018.

➤ **Në takimin e COSAP-it;**

Kryetarja dhe dy zëvendëskryetarët e Komisionit kanë marrë pjesë në Konferencën e 13-të të Komisioneve Parlamentare për Integritet/çështjet evropiane të vendeve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim- Asociimit- (COSAP), që është mbajtur në Shkup të Maqedonisë, nga datat 25-27 shkurt 2018.

➤ **Pjesëmarrja në konferencën ndërparlamentare në Sofje të Bullgarisë;**

Një anëtar i Komisionit ka qenë pjesë përbërëse e delegacionit të Kuvendit të Kosovës, në kuadër të pjesëmarrjes në Konferencën Ndërparlamentare, me temën: Transformimi i rajonit të Ballkanit Perëndimor – Një perspektivë parlamentare mbi rolin dhe të ardhmen e procesit të pranimit në BE, organizuar

nga Parlamenti Evropian dhe Kuvendi Kombëtar i Republikës së Bullgarisë në Sofje, më 5 tetor 2018.

h) Pritja e delegacioneve parlamentare të huaja (homologe)

Në periudhën e këtij viti, Komisioni ka pritur për vizitë këto delegacione:

- Delegacionin e Komisionit për Çështje Evropiane të Parlamentit të Kroacisë;
- Delegacionin e Komisionit për mbrojtje të konsumatorëve dhe çështje ligjore të Bundestagut Gjerman.

i) Takimet individuale të kryetares dhe anëtarëve të tjerë të komisionit

Gjatë këtij sesiioni anëtarët e Komisionit kanë realizuar takime si në vijim:

- a) Takim me z. Riccardo Serri- Shef i seksionit Politik, Ekonomik dhe Integritet Evropian – Charge d’Affairs i Zyrës së BE-së në Kosovë;
- b) Takim me Ambasadorin e Francës;
- c) Takim me Ambasadorin e Gjermanisë;
- d) Takim me Ambasadoren e Holandës;
- e) Takim me Shefin e Zyrës Belge në Kosovë; dhe
- f) Takim me Ambasadoren e Kroacisë.

j) Rezime

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit.

Nr.	Indikatorët	Total
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	25
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	157
3.	Procesverbale të hartuara	23
4.	Projektligje të shqyrtuara	74
5.	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komision	/
6.	Numri i grupeve punuese të formuara	/
7.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	/
8.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të Komisionit të Përhershëm <i>(të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)</i>	1685
9.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të Komisionit të Përhershëm <i>(të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)</i>	70
10.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të Komisionit FunkSIONAL	15
11.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të Komisionit FunkSIONAL	4
12.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
13.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	/
14.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	/
15.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	2
16.	Numri i raportimeve të ministrave	7
17.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	6
18.	Vizitat e realizuara brenda vendit	/
19.	Dëgjime publike	/
20.	Tryeza	/
21.	Monitorimi i ligjeve	/
22.	Monitorimi i ligjeve në procedurë në komision	/

23.	Numri i peticioneve	/
24.	Dëgjime buxhetore	/
25.	<i>Shqyrtimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare</i>	4
26.	<i>Shqyrtim i Programit Kombëtar për zbatimin e MSA-së (PKZMSA)</i>	1
27.	Nisma ligjore të Komisionit	/
28.	Numri i strategjive dhe planeve	/

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

I. Hyrje

Raporti pasqyron punën e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, ku janë përmbledhur aktivitetet dhe punët që i ka realizuar Komisioni gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2018, konform detyrave dhe përgjegjësiqve që i ka të përcaktuara në shtojcën 2, të Rregullores së Kuvendit.

Përbërja dhe struktura e Komisionit:

Gjatë vitit 2018, përbërja e Komisionit ka ndryshuar për shkak të zhvillimeve politike nga grupet parlamentare në Kuvend dhe si rezultat i këtyre zhvillimeve, në vend të deputetëve Aida Dërguti e Visar Ymeri nga GP-PSD, anëtarë të Komisionit me vendim të seancës janë emëruar deputetët Glauk Konjufca dhe Fitore Pacolli.

II. Aktivitetet e Komisionit

Aktivitetet e Komisionit gjatë të vitit 2018, janë si vijon:

a. Mbledhjet e Komisionit

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike gjatë vitit 2018, aktivitetet e tija i ka mbështetur kryesisht sipas Planit dhe programit të tij të punës, duke i zbatuar procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Komisioni gjatë kësaj periudhe mbajti gjithsej 30 mbledhje.

Mbledhjet e Komisionit ishin të hapura dhe u përcollën nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare.

Komisioni në raste të veçanta të përcaktuara me ligj, takimet i ka zhvilluar të mbyllura për pjesëmarrësit e tjerë dhe nuk i ka publikuar procesverbalet nga takimet e mbyllura, gjë që mund të ndikojë në mos pasqyrimin e saktë të punës së Komisionit, nga organizatat joqeveritare.

Për çdo takim të Komisionit, u mbajt evidenca mbi pjesëmarrjen e vëzhguesve të punës së Komisionit. Puna e Komisionit kryesisht është përcjellë nga mediat e shkruara edhe ato elektronike.

Gjatë kësaj periudhe Komisioni kryesisht u angazhua në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, përkatësisht ministrive përkatëse, shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, avancimin e diplomacisë parlamentare, takimeve të Komisionit me delegacione të huaja parlamentare, dëgjimin e kandidatëve të propozuar për ambasadorë dhe ngritjen e bashkëpunimit ndër-parlamentar.

b. Temat e trajtuara në Komision:

- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Kosovës dhe Malit të Zi;
- Raporti vjetor i punës së Komisionit për vitin 2017;
- Shqyrtimi i draft-planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2018;
- Raportim i Zëvendëskryeministrit z. Enver Hoxhaj, më 30.1.2018;
- Raportim i ministrit të MPJ-së, z. Behgjet Pacolli, më 31.1.2018;
- Formimi i grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimi i Komisionit;
- Diskutim në lidhje me propozimet për emërimet e reja në shërbimin diplomatik dhe respektimin e kuotës së paraparë me ligj;
- Raportimi i shefit të negociatave me Serbinë z. Avni Arifi, në lidhje me platformën e Qeverisë së Kosovës për procesin e dialogut Kosovë-Serbi;
- Raportim i ministrit të MPB, z. Flamur Sefaj, në lidhje me procesin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol, më 27.2.2018;
- Raportimi i shefit të negociatave me Serbinë z. Avni Arifi, në lidhje me platformën e Qeverisë së Kosovës për procesin e dialogut Kosovë-Serbi, më 29.3.2018
- Dëgjimi i kandidatit për ambasador, më 3.4.2018;
- Takim me z. Besian Mustafa drejtor i përgjithshëm i KIESA
- Takim i komisionit me Grupin Parlamentar të Miqësisë Kuvajt –Kosovë;
- Shqyrtimi i Projekt-Platformës shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve;
- Takim me diasporën për Dialogun e strukturuar për të drejtat e diasporës;
- Funkcionalizimi i grupeve të miqësisë;
- Raportim i ministrit të MPJ-së, z. Behgjet Pacolli, më 12.6.2018;
- Raportim i Zëvendëskryeministrit Enver Hoxhaj, më 20.6.2018.
- Raportim i Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike z. Dardan Gashi, më 25.7.2018;
- Dëgjimi i kandidatëve të propozuar për ambasadorë më 31.0.2018;
- Dëgjimi i kandidatit të propozuar për ambasador më 20.9.2018;
- Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës dhe Investime Strategjike z. Dardan Gashi, lidhur me Ligjin për Diasporë dhe çështje tjera nga fushëveprimtaria e ministrisë më 02.10.2018;
- Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë për dialogun;
- Shqyrtimi i vlerësimeve të sindikatës së MPJ-së lidhur me shkeljet në shërbimin e jashtëm;
- Shqyrtimi i mundësive të aplikimit të Kuvendit të Kosovës në disa organizata parlamentare;
- Zgjerimi i listës ekzistuese të ekspertëve;
- Angazhimi i ekspertit për Strategjinë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërparlamentar;
- Takim me ministrin e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike z. Dardan Gashi më 13.12.2018;
- Shqyrtimi i draft Strategjisë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe marrëdhëniet ndërparlamentare;
- Shqyrtimi i draft Raportit nga mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën;

- Raportim i fundvitit i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme z. Behgjet Pacollit, lidhur me fushëveprimtarinë e MPJ-së më 19.12.2018;

Pos temave të sipërpërmendura, që u trajtuan në mbledhjet e Komisionit, Komisioni mbajti edhe një Tryezë e përbashkët me shoqërinë civile, në lidhje me kornizën për dialogun politik.

Në bashkëpunim me KDI, Komisioni duke u bazuar në Memorandumin e bashkëpunimit në mes të Kuvendit dhe KDI-së organizoi dy takime: takimin e tretë dhe të katërt koordinues të komisioneve parlamentare, rreth rolit mbikëqyrës në dialogun Kosovë-Serbi.

c. Shqyrtimi i projektligjeve

- *Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit Funkcional*

Komisioni gjatë këtij sesi shqyrtoi Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.

d. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit

Komisioni gjatë periudhës janar – dhjetor 2018 ka mbikëqyrë zbatimin e Ligjit nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën. Me vendim të komisionit, raporti me rekomandimet nga mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji nuk u proceduan për shqyrtim në seancë plenare, për arsye se Qeveria do ta procedojë ligjin e ri për diasporën në Kuvend.

Komisioni bazuar në fushëveprimtarinë e tij, përmes grupeve punuese gjendet në fazën e mbikëqyrjes së zbatimit të këtyre ligjeve:

- Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
- Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
- Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës,
- Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare dhe
- Ligjit për Investimet Strategjike në përbërje.

Pritet që Komisioni të ndërmarrë hapat e nevojshme për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve.

e. Dëgjimi i kandidatëve për ambasadorë

Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike gjatë vitit 2018 bëri dëgjimin e katër kandidatëve të propozuar për emërim në pozitën e ambasadorit të Kosovës dhe me këtë rast e hartoi raportin nga dëgjimi i këtyre kandidatëve.

f. Komunikimi i Jashtëm

Komisioni, përkatësisht një delegacion i tij realizoi një vizitë zyrtare në Norvegji, nga data 7 maj 2018 deri më 10 maj 2018 ku u takua me komisionin homolog, zyrtarë të Parlamentit të Norvegjisë, zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Jashtme si dhe me zyrtarë dhe organizata të ndryshme.

Anëtarët e komisioni me ftesë të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike kanë marrë pjesë në konsultimet publike të organizuara në diasporë lidhur me Ligjin për Diasporën, si vijon:

- Francë 08.10.2018-10.10.2018
- Zvicër 12.10.2018-15.10.2018
- Suedi 19.10.2018-21.10.2018
- Turqi 05.11.2018-11.11.2018
- Gjermani 11.11.2018-17.11.2018
- Itali 21.11.2018-25.11.2018
- Austri 20.11.2018-22.11.2018
- Mbretëria e Bashkuar 22.11.2018-26.11.2018
- ShBA 26.11.2018-11.12.2018

g. Vizitat nga delegacionet e huaja

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike pati takim me Grupin parlamentar të Miqësisë Kuvajt - Kosovë. Në këtë takim anëtarët e Komisionit falënderuan delegacionin për vizitën e bërë dhe kërkuan mbështetje për investime dhe përkrahje për integrim të Kosovës në strukturat ndërkombëtare.

Më 19 korrik 2018, Komisioni u takua me kryetarin e Nënkomitetit për Politikë të Jashtme të Parlamentit të Australisë z. Chris Crewther, me të cilin u diskutuan çështjet e politikës së jashtme, u kërkua mbështetja e Australisë në rrugëtimin e Kosovës deri në njohjen e plotë ndërkombëtare si dhe u falënderua për mbështetjen e gjertanishme.

Komisioni në organizimin e KDI-së u takua me delegacionin e Shërbimit të Jashtëm të Parlamentit Zviceran, me qëllim të mbështetjes dhe rritjes së bashkëpunimit në mes Parlamentit të Kosovës dhe atij të Zvicrës si dhe duke promovuar shkëmbimin e eksperiencave në mes përfaqësuesve të dy parlamenteve në fushën e politikës së jashtme dhe mbikëqyrjes së ekzekutivit.

Më 26 nëntor 2018, disa anëtarë të komisionit pritën një delegacion të Komisionit për Çështje Evropiane nga Parlamenti i Kroacisë.

III. Rezume e punës së Komisionit për Punë të Jashtme Diasporë dhe Investime Strategjike

Pasqyra e përgjithshme e punës së Komisionit, gjatë periudhës janar – dhjetor 2018

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	30
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	86
3.	Procesverbale të hartuara	28
4.	Projektligje të shqyrtuara dhe miratuara	1
5.	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komision	-
6.	Numri i grupeve punuese të formuara	3
7.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	3
8.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit të përhershëm <i>(të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)</i>	-
9.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të komisionit të përhershëm <i>(të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)</i>	-
10.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit funksional	2

11.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të komisionit funksional	4
12.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	-
13.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	-
14.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	-
15.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	7
16.	Numri i raportimeve të ministrave	8
17.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	10
18.	Vizitat e realizuara brenda vendit	-
19.	Dëgjime publike	-
20.	Monitorimi i ligjeve	1
21.	Monitorimi i ligjeve në procedurë në komision	5
22.	<i>Peticione</i>	-
23.	<i>Tryeza</i>	1
24.	<i>Dëgjime buxhetore</i>	-
25.	<i>Raportet e auditimit të shqyrtuara</i>	-
26.	<i>Nisma ligjore që kanë marr komisionet</i>	-
27.	<i>Raport për dëgjimin e kandidatëve për ambasadorë</i>	4
28.	<i>Raportim i Shefit të negociatave</i>	2

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Përbërja dhe struktura e komisionit

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi(komisioni) në përbërjen e vet numëron 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë. Përfaqësimi i subjekteve politike në komision është si vijon:

1	ISMAJL KURTESI	kryetar i Komisionit	G/P - LVV
2	TEUTA HAXHIU	zëvendëskryetare parë	G/ P - AAK
3	MUFERA SINIK	zëvendëskryetare dytë	G/ P - 6 +
4	ARBËRIE NAGAVCI	anëtare	G/P - LVV
5	DRITON ÇAUSHI	anëtar	G/P - LVV
6	VALENTINA REXHEPI BUNJAKU	anëtare	G/P - LDK
7	FIDAN REKALIU	anëtar	G/P - LDK
8	ABDYL SALIHU	anëtar	G/P - PDK
9	NEZIR ÇOÇAJ	anëtar	G/P - PDK
10	VERICA QERANIQ	anëtare	G/P - LS
11	ALBULENA BALAJ- HALIMAJ	anëtare	G/P - NISMA

II. Hyrje

Komisioni, përmes këtij raporti paraqet punën e realizuar gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor të vitit 2018, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë që i ka të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit.

III. Fushëveprimi komisionit

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi është Komision Funkcional. Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësisë, i shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Kosovë, të gjitha çështjet e zhvillimit dhe të afirmimit të kulturës dhe të sportit në Kosovë, çështjet e pozitës së rinisë në shoqëri si dhe çështjet e inovacionit dhe ndërmarrësisë.

IV. Aktivitetet e komisionit

Komisioni, gjatë periudhës janar–dhjetor 2018, u angazhua në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë, si vijon:

a. Mbledhjet e komisionit

Komisioni, ka mbajtur gjithsej 42 (dyzet e dy) mbledhje. Mbledhjet e Komisionit kanë qenë të hapura për përfaqësues të institucioneve vendore e ndërkombëtare, shoqërisë civile, media dhe grupet e interesit që kanë shprehur interesim për çështjet e caktuara që janë shqyrtuar.

b. Grupe Punuese

Komisioni gjatë periudhës raportuese ka themeluar 3 (tre) grupe punuese dhe janë mbajtur 7 (shtatë) takime të këtyre grupeve punuese:

1. Grup punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturorë,
2. Grup punues për mbikëqyrjen e Ligjit nr.05/L-090 për Sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit,
3. Grup punues për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë.

c. Shqyrtimi i Projektligjeve

Komisionit për periudhën raportuese janar-dhjetor 2018, shqyrtoi 19 (nëntëmbëdhjetë) projektligje:

1. Projektligji nr.06/L-045 për Ratifikimin e Marrëveshjen Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching SPARK-ut të Holandës (SPARK), mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica (*është shqyrtuar në Seancën Plenare të mbajtur më 15.3.2018 dhe nuk është miratuar*),

2. Projektligji nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës *(është shqyrtuar dhe miratuar në Seancën Plenare të mbajtur më 23.7.2018)*,
3. Projektligji nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transferim të Dijes dhe Teknologjisë *(është shqyrtuar dhe miratuar në Seancën Plenare të mbajtur më 2.11.2018)*,
4. Projektligji nr.06/L-053 për ratifikimin e marrëveshjes MASHT-ADA *(është shqyrtuar dhe miratuar në Seancën Plenare të mbajtur më 15.3.2018)*,
5. Projektligji nr.06/L-073 për Statusin e punëtorëve të Arsimit Shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 *(është proceduar për lexim të dytë)*,
6. Projektligji nr.06/L-093 për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së *(është proceduar për miratim në parim)*,
7. Projektligji nr.06/L-095 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS+“, Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport *(është shqyrtuar dhe miratuar në Seancën Plenare të mbajtur më 20.9.2018)*,
8. Projektligji nr.06/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në programin Evropa Kreative për mbështetjen e sektorëve kulturorë dhe kreativë *(është shqyrtuar dhe miratuar në Seancën Plenare të mbajtur më 20.9.2018)*,
9. Projektligji nr.06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport *(është proceduar për lexim të dytë)*,
10. Projektligji nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit *(është proceduar për lexim të dytë)*,
11. Projektligji nr.06/L-117 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore *(është proceduar për miratim në parim)*,
12. Projektligji nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive *(është proceduar për lexim të dytë)*,
13. Projektligji nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë *(raporti me amendamente është proceduar në komisione të përhershme)*,
14. Projektligji nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta *(raporti me amendamente është proceduar në komisione të përhershme)*,

15. Projektligji nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat (*raporti me amendamente është proceduar në komisione të përhershme*),
16. Projektligji nr.06/L-125 për Ratifikimin e Marrëveshjen Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching SPARK-ut të Holandës (SPARK), mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica (*me kërkesë të MASHT ende nuk është shqyrtuar në komision*),
17. Projektligji nr.06/L-129 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës/Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ (Giz Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit Agjencioni Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar) për Bashkëfinancimin e Projektit Cetep (*është shqyrtuar dhe miratuar në seancën plenare të mbajtur më 18.10.2018*),
18. Projektligji nr.06/L-135 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (*është proceduar për miratim në parim*),
19. Projektligji nr.06/L-139 për Ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave në nivel të studimeve Master ndërmjet Ambasadës së Francës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (*është proceduar për miratim në seancë plenare*).

d. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese

Komisioni, për periudhën raportuese janar-dhjetor 2018, e shqyrtoi raportin vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor.

e. Dëgjime publike dhe tryeza

Komisioni gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2018, organizoi 3 (tre) dëgjime publike në lidhje me:

- *Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,*
- *Projektligjin për Inovacion Shkencor dhe Transferim të Dijes dhe Teknologjisë,*
- *Projektligji për Statusin e punëtorëve të Arsimit Shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.*

Komisioni gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2018, organizoi 3 (tre) tryeza pune me temë:

- *Tryezë pune lidhur me rëndësinë e organizimit të edukimit parashkollor,*
- *Tryezë pune lidhur arsimimin e peronave me nevoja të veçanta,*
- *Tryezë pune lidhur e prioritetet në fushën e arsimit parauniversitar.*

f. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisioni, në planin e punës për vitin 2018 ka paraparë mbikëqyrjen e zbatimit Ligjit për Trashëgiminë Kulturorë të Kosovës dhe Ligjit për Sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, janë formuar grupet punuese për mbikëqyrje, mirëpo grupi punues nuk ka arritur që gjatë vitit të përfundojë mbikëqyrjen e këtyre ligjeve.

g. Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit

Komisioni për periudhën raportuese realizoi 2 (dy) vizita pune jashtë vendit:

- 23-25 prill 2018 vizitë në Shqipëri dhe
- 18-21 nëntor 2018 vizitë në Bruksel.

Komisioni për periudhën raportuese realizoi disa vizita punë në institucione të ndryshme si MASHT, MKRS, UP, DKA si dhe vizita në shkolla gjatë mbajtjes së provimit të maturës shtetërore.

h. Pritja e delegacioneve të huaja

Komisioni, për periudhën raportuese janar – dhjetor 2018, priti 1 (një) delegacion të Malit të Zi, si dhe 1 (një) delegacion të shtetit të IOWA-së.

i. Raportimi i udhëheqësve të institucioneve në Komision

Gjatë periudhës raportuese, në komision raportuan ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 7 (shtatë) herë, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit 3 (tre) herë, ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë 2 (dy) herë, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore 2 (dy) herë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë i AKA-së 2 (dy) herë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës 1 (një) herë dhe Rektorët e Universiteteve Publike 1 (një) herë.

j. Organet e pavarura

Gjatë periudhës raportuese, konkretisht më 17.4.2018, u bë emërimi i anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Komisioni ka bërë përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe më 8.10.2018 ka proceduar rekomandimin për emërim në seancë plenare.

k. Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të komisionit

Gjatë periudhës raportuese, komisioni mbajti takime pune me përfaqësues të delegacionit të IOWA-s, shefen e Zyrës së BE-së në Prishtinë, zonja Natalija Apostollova. Komisioni në bashkëpunim me Germin ka mbajtur takim me diasporën shqiptare, takim me udhëheqëset e kopshteve me bazë në komunitet, takim me përfaqësues të GIZ-it, me Bankën Botërore, me Fondint Monetar Ndërkombëtar dhe KDI-në.

V. Rezume e punës së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	42
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	168
3.	Procesverbale të hartuara	42
4.	Projektligje të shqyrtuara	19
5.	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komision	12

6.	Numri i grupeve punuese të formuara	3
7.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	7
8.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit të përhershëm (të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)	/
9.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të komisionit të përhershëm (të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)	/
10.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të Komisionit Funkcional	109
11.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të Komisionit Funkcional	18
12.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
13.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	1
14.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	1
15.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	3
16.	Numri i raportimeve të ministrave	12
17.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	2
18.	Vizitat e realizuara brenda vendit	6
19.	Dëgjime publike	3
20.	Monitorimi i ligjeve	/
21.	Monitorimi i ligjeve në procedurë në komision	2
22.	Tryeza	3

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Përbërja dhe struktura e komisionit

Nr. rendor	Emri dhe mbiemri	Pozita	Përkatësia politike
1	Sala BERISHA - SHALA	kryetare	G/P – PDK
2	Dardan SEJDIU	zëvendëskryetar i parë	G/P – PSD
3	Adem Hoxha	zëvendëskryetar i dytë	G/P – LS
4	Liburn ALIU	anëtar	G/P – LVV
5	Glauk KONJUFCA	anëtar	G/P – LVV
6	Hykmete BAJRAMI	anëtare	G/P – LDK
7	Lutfi ZHARKU	anëtar	G/P – LDK
8	Memli KRASNIQI	anëtar	G/P – PDK
9	Muharrem NITAJ	anëtar	G/P – AAK
10	Veton BERISHA	anëtar	G/P – NISMA

11	Duda BALJE	anëtare	G/P – 6+
----	------------	---------	----------

I. Hyrje

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal (në tekstin e mëtejshëm: komisioni), është Komisioni Funkcional i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Qëllimi i tij është t'i shqyrtojë të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me ekonominë, infrastrukturën, tregtinë, industrinë, energjetikën, transportin, telekomunikacionin etj.

Më qëllim të pasqyrimin të punës së tij për vitin 2018 të Legjislaturës VI, është hartuar ky Raport, i cili përmban të dhëna, informacione dhe shënime, që tregojnë për aktivitetet dhe punët që i ka realizuar komisioni gjatë kësaj periudhe, në pajtim me detyrat dhe me përgjegjësitë që i ka të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në bazë të marrëveshjes së grupeve parlamentare, komisioni pati në përbërje anëtarë të të gjitha grupeve parlamentare, në bazë të numrit të votave të fituara në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 11 qershor 2017.

II. Fushëveprimi i komisionit

Komisioni në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësisë i shqyrton të gjitha çështjet që përfshijnë:

- Shqyrtimin e projektligjeve të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e veprimtarive ekonomike të Kosovës, duke i bërë rekomandime Kuvendit dhe ministrisë përkatëse etj.;
- Krijimin e infrastrukturës ligjore për mjedis më të sigurt për investime, për marrëveshje tregtare, për koncesione në infrastrukturë, energjetikë, resurse minerale dhe që lidhen me zhvillimin e këtyre degëve ekonomike;
- Angazhimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave të përgjithshme në fushën e ekonomisë, të tregtisë, të industrisë dhe të transportit;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrive dhe agjencive rregullatorë që i raportojnë komisionit, dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe agjencive rregullatorë të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera të përcaktuara me Rregulloren dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij komisioni;

Në ushtrimin e funksioneve, komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga komisioni. Komisioni Parlamentar për të marrë informacione shtesë nga grupet e interesit apo aktorët kryesorë për zbatimin e ligjit dhe mbikëqyrjes efektive të politikave, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, organizon dëgjime publike dhe tryeza të rrumbullakëta, ku diskutohet legjislacioni në interes të zhvillimit ekonomik dhe mënyrat për të nxitur biznesin dhe prodhimin vendor në Kosovë, thithjen e investimeve të huaja, përmirësimin e mjedisit të biznesit, dhe për funksionimin dhe fuqizimin e agjencive dhe rregullatorëve që i raportojnë komisionit.

III. Aktivitetet e Komisionit

Komisioni gjatë këtij viti ka zhvilluar aktivitetet e tij në bazë të Planit të tij të Punës, të hartuar gjithnjë duke u bazuar në Strategjinë legjislativë të Qeverisë. Këto aktivitete komisioni i ka realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta, mbledhjeve të grupeve të punës, monitorimit të zbatimit të ligjit, takimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit dhe nëpërmjet vizitave zyrtare në institucionet përkatëse, me qëllim të mbikëqyrjes së punës së tyre.

Duke u bazuar në Strategjisë legjislativë të Qeverisë, komisioni në fillim të punës së tij, në janar të këtij viti, e miratoi Planin e Punës, në bazë të cilit edhe i zhvilloi aktivitetet e veta. Po ashtu në shtator të këtij viti komisioni miratoi planin e rishikuar për sesionin e dytë.

a) Mbledhjet e komisionit

Komisioni gjatë vitit 2018 të Legjislaturës VI, realizoi gjithsej 43 (katër dhjetë e tre) mbledhje të rregullta. *Mbledhjen e tij të parë e mbajti më 16.1.2018*, që është aktiviteti i parë i tij për këtë vit. *Ndërkaq, mbledhja e fundit e komisionit u mbajt më 28.12.2018*, që është aktiviteti i fundit i komisionit për këtë vit. Gjatë kësaj periudhe, komisioni në tërësi realizoi 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) aktivitete, me një mesatare prej 10 (dhjetë) aktiviteteve në muaj.

Gjatë punës së vet, komisioni, i zbatoi procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit. Gjithnjë në mbështetje të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i realizoi mbledhjet dhe takimet e tij të rregullta, në të cilat u shqyrtuan rreth 200 (dyqind) pika të rendit të ditës. Në mbledhjet e Komisionit, sipas ftesës, morën pjesë përfaqësues të ministrive (ministra etj.) dhe përfaqësues të organizatave të tjera.

Mbledhjet e komisionit ishin publike dhe u monitoruan nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare vendore e ndërkombëtare. Punën e komisionit e monitoruan përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, NDI-së, INDEP, KDI-së, asociacione dhe organizata të tjera. Po ashtu, puna e komisionit pati hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe në ato elektronike.

b) Shqyrtimi i projektligjeve

Komisioni si organ i Kuvendit, duke zbatuar mandatin e tij, miratimin e ligjeve apo hartimin e ligjeve, gjatë këtij viti, shqyrtoi Projektligjet në kuadër të fushëveprimit e tij. Gjatë këtij viti, Komisioni arriti që falë angazhimit të tij të bëjë të mundur shqyrtimin e 22 (njëzetë e dy) projektligjeve, ndërsa prej tyre janë miratuar nga Kuvendi gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) projektligje; 3 (tri) projektligje janë proceduar për lexim të dytë në Kuvend, si dhe një Projektstatut është në procedurë të shqyrtimit në Komision.

Projektligjet e miratuara në lexim dytë janë si në vijim:

1. Projektligji për Standardizim, 26.1.2018;
2. Projektligji për Shoqëritë Tregtare, 16.5.2018;
3. Projektligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, 30.3.2018;
4. Projektligji për Pajisjet nën presion, 30.3.2018;
5. Projektligji për Metrologji, 30.3.2018;
6. Projektligji për Kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, 30.3.2018;
7. Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit, 17.5.2018;
8. Projektligji për masat mbrojtëse në importe, 12.7.2018;

9. Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) (2014-2020), 23.7.2018.
10. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-064 për Patentë Shoferi, 14.9.2018;
11. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-0120, 14.9.2018;
12. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, 14.9.2018;
13. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-179 për Transportin rrugor, 14.9.2018;
14. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-183 për Transportin tokësor të mallrave të rrezikshme, 14.9.2018;
15. Projektligji për Produkte të ndërtimit, 7.11.2018;
16. Projektligji për Eficiencën e Energjisë, 7.11.2018;
17. Projektligji për Ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit, 25.10.2018;
18. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, 21.12.2018;
19. Projektligji për shërbimet postare, 21.12.2018;

Projektligjet e proceduara për seancë plenare në lexim të dytë janë si në vijim:

1. Projektligji për miniera dhe minerale;
2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Automjete;
3. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Protokolin shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore.

Në procedurë të shqyrtimit në Komision është:

1. ***Projektstatuti i Trepçës.***

Në lidhje me shqyrtimin e projektligjeve të lartcekura, gjatë këtij sesioni Komisioni formoi 12 (dymbëdhjetë) grupe të punës, për secilin Projektligj, apo pako projektligjesh nga një grup të punës. Në grupe punuese janë trajtuar Projektligjet nga aspekti profesional dhe teknik, ku për të cilat kryesuesi i grupit punues, ka ftuar ministrinë e linjës, ekspertë të ndryshëm që kanë marrë pjesë në hartimin e Projektligjit si dhe mori opinionet e shoqërisë civile. Gjithsejtë janë mbajtur 26 mbledhje të grupeve punuese. Gjatë shqyrtimit të këtyre Projektligjeve, *Komisioni hartoi dhe miratoi 330 (treqind e tridhjetë) amendamente.*

c) Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese

Komisioni në bazë të fushëveprimit të tij, gjatë këtij viti shqyrtoi edhe raportet vjetore të agjencive të pavarura, të themeluara nga Kuvendi. Komisioni lidhur me këto raporte, në disa raste kërkoi raport shtesë. Komisioni hartoi Raporte me Rekomandime, të cilat ishin temë diskutimi në mbledhje plenare të Kuvendit të Kosovës.

Në këtë vit, raportet vjetore të punës të institucioneve raportuese, janë shqyrtuar të gjitha raportet nga ana e Komisionit si vijon:

1. Raporti vjetor i punës së Zyrës së Rregullatorit për Energji.
2. Raporti vjetor i punës së Autoritetit të Aviacionit Civil;
3. Raporti vjetor i punës së Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
4. Raporti vjetor i punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;
5. Raporti vjetor i punës së Autoritetit Rregullativ Hekurudhor;
6. Raporti vjetor i punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
7. Raporti vjetor i punës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut;
8. Raporti vjetor i punës së Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Prej raporteve të shqyrtuara, Komisioni miratoi 8 (tetë) *Raporte me Rekomandime* dhe njëherësh e miratoi edhe raportin e punës së tyre.

d) Shqyrtimi i kërkesave/propozimeve të institucioneve publike dhe sektorit privat

Komisioni, gjatë kësaj periudhe shqyrtoi kërkesa të institucioneve publike dhe private dhe të gjitha i adresoi në bazë të Rregullores së Kuvendit, si në vijim:

- Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për anëtarë të Bordit Zyrës së Rregullatorit për Energji, të propozuar nga Qeveria;
- Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të propozuar nga Qeveria;
- Shqyrtimi i Raportit të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2015 dhe 2016, të propozuar nga Qeveria;
- Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.07/21, datë 22.12.2017 për Ndërmarrjen “Qendra Shoqërore, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike- Pallati i Rinisë – PRN067, të propozuar nga Qeveria;
- Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për kryesues të bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji të propozuar nga Qeveria;
- Shqyrtimi i kërkesës së ARKEP për shkarkimin e një anëtari të bordit të ARKEP;
- Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për kryesues dhe anëtarë të bordit të AKP-së, të propozuar nga Qeveria.

e) Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni gjatë këtij viti realizoi gjithsej 3 (tre) dëgjime publike. Dëgjimet publike Komisioni i organizoi në lidhje me projektligjet në procedurë.

Siç u cek edhe me lartë, dëgjimet publike legislative ishin si në vijim:

1. Projektligji për Miniera dhe Minerale(28.3.2018);
2. Projektligji për Mbrojtjen e Konsumatorit (4.4.2018);
3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për Automjete (18.7.2018);

f) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisioni pati parasysh se një prej detyrimeve kushtetuese është edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit, e jo vetëm nxjerrja e tij.

Gjatë këtij viti Komisioni ka paraparë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike. Ky aktivitet është në fazën fillestare.

g) Kontrolli parlamentar

Duke ushtruar mandatin e tij si mbikëqyrës i punës së Qeverisë/Ministrive që i raportojnë Komisionit, ministrat e dikastereve përkatëse apo zëvendësit e tyre janë ftuar për raportim dhe seanca dëgjimore në Komision, varësisht nga tema të cilën e ka trajtuar Komisioni.

Më poshtë kemi listën e raportimeve të ministrive në Komision gjatë kësaj periudhe:

1. Raportim i z.Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbledhje të Komisionit më 23.1.2018, lidhur me pretendimet e Bechtel – Enka, për penalet që kanë derivuar nga mospërmbushja e detyrimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në ndërtimin e Autostradës “Arben Xhaferi”;
2. Raportim i z. Xhavit Zariqi, zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit më 30.1.2018, lidhur me Projektligjin nr.06/L-027 për Miniera dhe Minerale, Projektligjin nr.06/L-031 për Pajisjet nën Presion, dhe Projektligjin nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës;
3. Raportim i z.Bajram Hasani, ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit më 7.2.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit; Projektligjit nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;
4. Raportim i z.Rasim Demiri, ministër për Zhvillim Rajonal, në mbledhje të Komisionit më 14.2.2018, lidhur me prioritetet e ministrisë;
5. Raportim i z.Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit më 21.2.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-037 për Metrologji dhe Projektligjit nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;
6. Raportim i z.Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit më 27.2.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;
7. Raportim i z.Besnik Beka, zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit më 27.2.2018, lidhur me Raportin e performancës së ndërmarrjeve publike, për vitin 2015 dhe 2016;
8. Raportim i z. Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit, më 19.3.2018, lidhur me gjendjen në: a) Shoqërinë Aksionare Trepça SH.A.; b) Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës SH.A.; dhe, c) Ndërmarrjen Publike Telekom i Kosovës SH.A.;
9. Raportim i z.Fehmi Mujota, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbledhje të Komisionit, më 16.5.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Pakos së projektligjeve të Ministrisë së Infrastrukturës për harmonizim me Ligjin për kundërvajtje;
10. Raportim i z.Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit, më 12.6.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.06/L-079 për Eficiencë të energjisë;
11. Raportim i z.Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit më 26.6.2018, lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e

- Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) (2014-2020), 23.7.2018;
12. Raportim z.Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit, më 11.7.2018, lidhur me gjendjen në Ndërmarrjen Publike Telekomit i Kosovës SH.A.;
 13. Raportim i z.Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbledhje të Komisionit, më 2.10.2018, lidhur me Projektligjin për Ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit;
 14. Raportim i z.Valdrin Lluka, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhje të Komisionit, më 6.11.2018, lidhur me procesin e ndërtimit të Termocentralit Kosova e Re;
 15. Raportim i z.Endrit Shala, ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit, më 20.11.2018, lidhur me punën e ministrisë për vitin 2018 dhe planifikimet për vitin e ardhshëm;
 16. Raportim i z.Bekim Jupa, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit, më 10.12.2018, lidhur me Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Protokolin shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore;
 17. Raportim i z.Endrit Shala, ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbledhje të Komisionit, më 28.12.2018, lidhur me çmimet e naftës.

h) Vizitat e komisionit

Vizitat brenda vendit

Gjatë vitit 2018, Komisioni i realizoi 6 (gjashtë) vizita brenda vendit, me qëllim që të shoh për së afërmi gjendjen në institucionet dhe subjektet, veprimtaria e të cilave ka të bëjë me fushëveprimin e Komisionit, si vijon:

- Vizitë në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, më 7.2.2018;
- Vizitë në Autoritetin e Aviacionit Civil, më 27.2.2018;
- Vizitë në KOSTT, në bashkëpunim me KDI-në, më 22.3.2018;
- Vizitë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, më 4.7.2018;
- Vizitë bizneseve prodhuese dhe tregtare në Ferizaj, më 9.11.2018;
- Vizitë ndërmarrjes publike KEK-ut, më 19.12.2018.

Vizitat jashtë vendit

Komisioni, në vazhden e punës së tij, realizoi edhe anën e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke marrë pjesë në Konferenca rajonale dhe në seminare të Parlamentit Evropian, si dhe në punëtori të ndryshme etj. Kështu, gjatë këtij viti realizoi gjithsej 8 (tetë) vizita jashtë vendit, si vijon:

- Më 12 mars 2018, me SECCP- Turqi;
- Më 24 prill 2018, në Plenumin Parlamentar të Komunitetit të Energjisë - Bruksel;
- Më 23-27 prill 2018, në Departamentin për Tregti – SHBA;
- Më 14 maj 2018, takim me kryetarët e Komisioneve Parlamentare për Energji – Bullgari;
- Më 7-8 qershor 2018, në vizitë studimore për Eficiencë të energjisë (GIZ) – Gjermani;
- Më 19-20 tetor 2018, vizitë në Vjenë Austri – EUFORES/GIZ;

- Më 27-28 nëntor 2018, vizitë në Shkup, Maqedoni, pjesëmarrje në Forumin për efikasitet të energjisë dhe klima, si dhe në Mbledhjen e Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë;
- Më 3-5 dhjetor 2018, vizitë në Podgoricë, lidhur me efikasitetin e energjisë – GIZ ORF EE.

i) Takimet e kryetares, anëtarëve dhe të Komisionit

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe të përgjegjësisve në mënyrë më efektive, Komisioni organizoi takime duke e shtrirë bashkëpunimin me të gjitha subjektet, siç janë: komisionet parlamentare, ministritë përkatëse, përfaqësuesit e agjencive të pavarura, institucione të huaja si dhe me sindikata të punëtorëve etj.

Gjatë këtij viti, u realizuan 26 (njëzet e gjashtë) takime si në vijim:

- Më 19.1.2018, takim i GP për Projektligjin për Shoqëritë Tregtare, me Odat ekonomike;
- Më 30.1.2018, takim i kryetares me përfaqësues të Ministrisë Federale të Gjermanisë;
- Më 2.2.2018, takim i Komisionit me përfaqësues të Departamentit për Tregti të SHBA-së;
- Më 16.2.2018, takim i kryetares me zv. ambasadorin e Kanadasë;
- Më 21.2.2018, takim i zv. kryetarit Dardan Sejdiu me ekspertë anglezë për konkurrencë;
- Më 27.2.2018, takim i kryetares me ekspertë holandezë, projekti për mbështetje Kuvendit;
- Më 6.3.2018, takim i kryetares me OJQ “Dplus”;
- Më 19.3.2018, takim i kryetares me OJQ “Lens”;
- Më 20.3.2018, takimi/pjesëmarrje e kryetares në Forumin e Lartë për Energji;
- Më 8.5.2018, takim i Komisionit me delegacionin nga Iowa;
- Më 8.5.2018, takim i Komisionit me përfaqësues të Bankës Botërore;
- Më 18.5.2018, takim i Komisionit me biznesmenë të diasporës;
- Më 28.5.2018, takim i Komisionit me Grupin e Miqësisë të Parlamentit Kroat;
- Më 13.6.2018, takim i kryetares me OJQ “Dplus”;
- Më 13.6.2018, takim i kryetares me Sindikatën e Trepçës;
- Më 26.6.2018, takim i Komisionit me CESS Projekti për mbështetje të Kuvendit;
- Më 7.9.2018, takim i kryetares me OJQ LENS;
- Më 7.9.2018, takim i kryetares me Sindikatën e KEDS-it;
- Më 5.10.2018, takim i kryetares me BDO-partnerin britanik;
- Më 16.10.2018 takim i kryetares me kompaninë Oberion Securities USA;
- Më 26.10.2018 takim i kryetares me Bordin e ZRRE;
- Më 29.10.2018 takim i kryetares me Klubin e prodhuesve kosovar;
- Më 26 dhe 29 tetor 2018 takim i Panelit për Bordin e KOSTT-it;
- Më 20.11.2018 takim i kryetares me BDO-partnerin britanik;
- Më 19.12.2018 takim i kryetares me BDO-partnerin britanik;
- Më 21.12.2018 takim i komisionit me Ministrin e tregtisë dhe Industrisë dhe odat ekonomike.

j) Aktivitetet tjera

Anëtarë të Komisionit gjatë kësaj periudhe, morën pjesë nëpër tryeza dhe konferenca të organizuara nga organizata apo institucione të ndryshme, në të cilat u trajtuan tema të ndryshme nga fushe veprimtaria e Komisionit.

Është mbajtur një punëtori më 6-7 korrik 2018 në Prevallë, për shqyrtimin e projektstatutit të Trepçës.

Kryetarja e Komisionit ka marrë pjesë në Komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve për Komisionin për Ndihmë Shtetërore.

Komisioni ka filluar procesin e trajtimit të aplikacioneve të kandidatëve për anëtarë të bordit të KOSTT-it.

IV. Rezume e punës së komisionit

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit.

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhje të mbajtura	44
2	Numri i pikave të rendit të ditës	200
3	Procesverbale të hartuara	44
4	Projektligje të shqyrtuara dhe të amendamentuara	22
5	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në Komision / Projektstatut	1
6	Projektligje të tërhequra nga Qeveria	///
8	Numri i formuar i grupeve punuese	12
9	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	29
10	Numri i amendamenteve të propozuara	330
12	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	22
13	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	///
14	Numri i Rekomandimeve	33
15	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	8
16	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	7
17	Numri i vendimeve të Komisionit	16
18	Vizitat e realizuara jashtë vendit	8
19	Vizitat e realizuara brenda vendit	6
20	Dëgjime publike	3
21	Monitorimi i ligjeve	///
22	Tryeza	///
22	Punëtori/Workshop	1

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

PËRBËRJA DHE STRUKTURA E KOMISIONIT

Anëtarët e komisionit:

1. Muharrem Nitaj, kryetar (G/P – AAK);
2. Besa Gaxherri, zëvendëskryetare e parë (G/P – LDK);
3. Sergjan Mitroviç, zëvendëskryetar i dytë (G/P – LS);
4. Liburn Aliu, anëtar (G/P – VV);
5. Salih Salihu, anëtar (G/P – PSD);
6. Salih Zyba, anëtar (G/P – VV);
7. Lutfi Zharku, anëtar (G/P – LDK);
8. Andin Hoti, anëtar, (G/P – PDK);
9. Ganimete Musliu, anëtare (G/P – PDK);
10. Etem Arifi, anëtar (G/P – NISMA);
11. Danush Ademi, anëtar (G/P – 6+).

I. HYRJE

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 69 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, është një nga komisionet funksionale, i cili në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësisë, shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me bujqësinë, pylltarinë, zhvillimin rural, mjedisin dhe planifikimin hapësinor.

Në Kuvendin e Kosovës, deri më sot janë miratuar 59 ligje, që lidhen ngushtë me punën e këtij komisioni. Prej tyre, 26 ligje nga fusha e bujqësisë, pylltarisë e zhvillimit rural dhe 33 ligje nga ajo e mjedisit e planifikimit hapësinor.

Komisioni me qëllim të pasqyrimin të punës së vet për vitin 2018, e hartoi këtë raport, i cili përmban të dhënat që tregojnë për aktivitetet e realizuara gjatë këtij sesioni. Komisioni mbajti 27 mbledhje të rregullta dhe 16 të grupeve të punës, formoi 10 grupe të punës, shqyrtoi 10 projektligje, 4 prej tyre janë miratuar nga Kuvendi dhe 6 janë në procedurë, ndërmori 2 nisma legislative, shqyrtoi 4 raporte të agjencive raportuese si dhe shqyrtoi 1 strategji dhe 1 plan të veprimit.

Gjatë këtij viti janë miratuar ligje me rëndësi siq janë: Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje; Ligji për Komplexin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz; Ligji për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore dhe Ligji për Veprimtaritë hidrometeorologjike, po ashtu është miratuar edhe Strategjia shtetërore për ujëra 2017-2036.

Në mbledhjet e Komisionit janë ftuar dhe kanë marrë pjesë, ministrat e resorëve përkatës për bujqësi e mjedis, udhëheqës të agjencive e departamenteve përkatëse dhe udhëheqës të agjencive të pavarura.

II. FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, është Komision Funkcional. Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësi, shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me bujqësinë, me pylltarinë, me zhvillimin rural, me mjedisin dhe me planifikimin hapësinor.

Fushëveprimi i këtij komisioni përfshin:

- Angazhimin për përcaktimin dhe përcjelljen e politikave të zhvillimit të bujqësisë, të pylltarisë, të zhvillimit rural, të mjedisit dhe të planifikimit hapësinor;
- Angazhimin për konceptimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e bujqësisë, të pylltarisë, të zhvillimit rural, të mjedisit dhe të planifikimit hapësinor, duke përcjellë modelet më të avancuara bashkëkohore nga këto fusha;
- Shqyrtimin e nivelit të zbatimit të programit të Qeverisë në fushën e bujqësisë, të pylltarisë, të zhvillimit rural, të mjedisit dhe të planifikimit hapësinor dhe i jep rekomandime Kuvendit;
- Bashkëpunimin me komisionet e tjera të Kuvendit, në veçanti me Komisionin për Buxhet e Financa, kur është fjala për financimin dhe për menaxhimin e programeve nga Qeveria;
- Shqyrtimin e legjislacionit të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet e Financa, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

Për ushtrimin e funksioneve, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës, me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.

III. AKTIVITETET E KOMISIONIT

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor gjatë vitit 2018, mbajti 27 mbledhje të rregullta dhe 16 të grupeve të punës, formoi 10 grupe të punës, shqyrtoi 10 projektligje, 4 prej tyre janë miratuar nga Kuvendi dhe 6 janë në procedurë, ndërroi 2 nisma legjislative, shqyrtoi 4 raporte të agjencive raportuese si dhe shqyrtoi 1 strategji dhe 1 plan të veprimit.

a) *Mbledhjet e Komisionit*

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, gjatë periudhës janar-dhjetor 2018, mbajti 27 mbledhje. Në mbledhjet e Komisionit janë ftuar dhe kanë marrë pjesë, ministrat e resorëve përkatës për bujqësi e mjedis, udhëheqës të agjencive e departamenteve përkatëse dhe udhëheqës të agjencive të pavarura:

Ministrjae MMPH-së znj. Albena Reshitaj, ka marrë pjesë në 1 mbledhje të Komisionit, ku është diskutuar për gjendjen e ndotjes së ajrit.

Ministri i MMPH-së z.Fatmir Matoshi, ka marrë pjesë në 2mbledhje të Komisionit, ku është shqyrtuar raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017.

Ministri i MBPZHR-së, z. Nenad Rikallo, ka marrë pjesë në 1 mbledhje të Komisionit dheraportoi për dëmet në bujqësi nga reshjet.

Zv. Ministri i MBPZHR-së, z. Mevludin Krasniqi, ka marrë pjesë në 1 mbledhje të Komisionit, ku është shqyrtuar buxheti i ministrisë për vitin 2019.

Drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, z. Idriz Blakaj, ka marrë pjesë në 3 mbledhje të Komisionit: ku është diskutuar për gjendjen në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz; ka prezantuar Raportin vjetor 2017 të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe ku u shqyrtua Projektligji për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, z.Bislim Zogaj, ka raportuar 2 herë për gjendjen aktuale të komplekseve memoriale në Kosovë.

Drejtori i Autoritetit rregullator për shërbimet e ujit, z. Raif Preteni, ka marrë pjesë në 1 mbledhje të Komisionit dhe ka prezantuar Raportin vjetor të ARRU-së për vitin 2017.

Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamorez. Beqir Mezelxhiu, ka marrë pjesë në 1 mbledhje të Komisionit, ku shqyrtua Projektligji për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore.

Kryeshefi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), z. Valdet Gjinovci, ka marrë pjesë në 2 mbledhje të komisionit dhe ka raportuar për çështjen e kualitetit të mishit dhe prodhimeve nga mishi si dhe ka raportuar për farërat dhe plehrat në Kosovë.

Avokati i popullit z. Hilmi Jashari, z.Naser Ramadani drejtor i IKSHP-së dhe z.Arben Xhukajdrejtor i KEK-ut, kanë marrë pjesë në 1 mbledhje të Komisionit ku është diskutuar për gjendjen e ndotjes së ajrit.

Kryeshefi i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, z. Ilir Morina, ka marrë pjesë në 2 mbledhje të Komisionit dhe ka prezantuar Raportet për gjendjen e mjedisit për vitin 2016 dhe 2017.

Përfaqësuesi i Këshillit Ndërministror për Ujëra z. Baton Begolli, ka marrë pjesë në 1 mbledhje të Komisionit, ku është shqyrtuar strategjia shtetërore për ujëra 2017-2036.

b) Grupet e punës

Komisioni, gjatë këtij viti formoi 10 grupe të punës: e të cilat i kanë mbajtur 16 mbledhje, në mbledhje të grupeve të punës janë ftuar dhe kanë marrë pjesë, përfaqësuesit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës; Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit; Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore; Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, etj.

- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore;
- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,

- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz;
- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për Veprimtaritë hidrometeorologjike.
- Grupi i punës për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit;
- Grupi i punës për hartimin e Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz;
- Grupi i punës për hartimin e Projektligjit për Cilësinë e Bukës;
- Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe Ligjit nr. 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural;
- Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligji nr. 04/L-110 për ndërtim.
- Grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

c) Shqyrtimi i projektligjeve

Gjatë këtij viti, Komisioni shqyrtoi 10 projektligje, 4 prej tyre janë miratuar nga Kuvendi, 2 kanë kaluar leximin e parë dhe 4 janë në pritje për lexim të parë.

- Projektligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje (*Kuvendi e miratoi më 23.7.2018*);
- Projektligji për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (*Kuvendi e miratoi më 30.3.2018*);
- Projektligji për Veprimtaritë Hidrometeorologjike (*Kuvendi e miratoi më 15.10.2018*);
- Projektligji për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz (*Kuvendi e miratoi më 18.10.2018*).
- Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, (*Kuvendi e miratoi në parim më 7.10.2018*).
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit (*Kuvendi e miratoi në parim më 25.10.2018, ndërsa Raporti me amendamente për Komisione të përhershme më:11.12.2018*).
- Projektligji për mbrojtjen nga zhurma (*Komisioni e shqyrtoi në parim më 6.11.2018. Kuvendi nuk e miratoi në parim më 21.12.2018*)
- Projektligji për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës (*Kuvendi e miratoi në parim më 21.12.2018*)
- Projektligji për produktet biocide, (*Kuvendi e miratoi në parim më 21.12.2018*)
- Projektligji për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit (*Kuvendi e miratoi në parim më 21.12.2018*)

d) Nismat legislative të Komisionit

Komisioni ka ndërmarrë 3 nisma legislative: 2 prej të cilave janë përfunduar.

- Nisma legislative për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit.
- Nisma legislative për hartimin e Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz;
- Nisma legislative për hartimin e Projektligjit për Cilësinë e Bukës (*është në fazën e grupit të punës*);

e) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve në fuqi dhe të institucioneve për zbatimin e politikave strategjike, komisioni ka vazhduar mbikëqyrjen e zbatimit të 2 ligjeve të filluara në vitin 2017.

- Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural,
- Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-110 për ndërtim.

e) Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese

Komisioni i shqyrtoi 4 raporte të agjencive raportuese, 2 prej tyre janë miratuar nga Kuvendi dhe 2 janë në pritje për votim:

- Raporti për gjendjen e mjedisit për vitin 2016 *Kuvendi e miratoi më 15.3.2018*);
- Raporti vjetor i Autoritetit rregullator për shërbimet e ujit për vitin 2017 *(Kuvendi e miratoi më 15.10.2018)*.
- Raporti vjetor i punës së Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorial të Kosovës për vitin 2017 *(Komisioni e ka shqyrtuar më 7.5.2018 dhe i ka rekomanduar seancës miratimin e tij. Raporti pritet të votohet nga Kuvendi)*;
- Raporti për gjendjen e mjedisit për vitin 2017 *(Komisioni e shqyrtoi më 20.11.2018 dhe i ka rekomanduar seancës miratimin e tij. Raporti pritet të votohet nga Kuvendi)*.

f) Shqyrtimi i strategjive dhe planeve

Komisioni gjatë këtij sesioni shqyrtoi 1 strategji dhe 1 plan, të cilat janë miratuar nga Kuvendi.

- Strategjia shtetërore për ujëra 2017-2036 *(Kuvendi e miratoi më 30.5.2018)*);
- Plani i veprimit për biodiversitetin 2016-2020 *(Kuvendi e miratoi më 30.5.2018)*.

g) Konkursi për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës

Komisioni ka shpallë 2 herë konkursin për shkak se herën e parë seanca nuk e zgjodhi drejtorin dhe konkursi u përsërit.

- Komisioni më 29 janar 2018, mori vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, konkursi u shpall më 9 shkurt 2018 dhe në konkurs aplikuan 21 kandidatë. Komisioni më 19 dhe 20 mars 2018 zhvilloi intervistën dhe përgatiti listën e ngushtë me 2 kandidatë për votim në Kuvend, mirëpo, në seancën e mbajtur më 17.4.2018, asnjëri nga kandidatët nuk i mori votat e nevojshme dhe u vendosë që konkursi të përsëritet.
- Komisioni më 24 prill 2018, mori vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, i cili u shpall më 26 prill 2018, me ç'rast aplikuan 17 kandidatë. Komisioni, më 22 maj 2018, zhvilloi intervistën dhe përgatiti listën e ngushtë me 2 kandidatë për votim në Kuvend, kurse Kuvendi në seancën e mbajtur më 6.5.2018, e zgjodhi z. Bislim Zogaj, drejtor të kësaj Agjencie.

h) Aktivitete të tjera të Komisionit

Komisioni gjatë këtij viti ka realizuar 4 vizita pune brenda vendit, ndërsa asnjë jashtë vendit.

- Më 8.10.2018, Komisioni në përbërje: *Muharrem Nitaj- kryetar, Besa Gaxherri-zëvendëskryetare dhe anëtarët e Komisionit: Ganimete Musliu, Andin Hoti, Salih Salihu, Salih Zyba dhe Danush Ademi*, realizoi një vizitë në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, me qëllim të njohjes nga afër me gjendjen e këtij kompleksi. Në vizitë u bashkangjitën edhe kryetari i Komunës së Skenderaj, z. Bekim Jashari dhe drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, z. Bislim Zogaj.
- Më 14.11.2018, Komisioni në përbërje: *Muharrem Nitaj- kryetar, Besa Gaxherri-zëvendëskryetare dhe anëtarët e Komisionit: Andin Hoti, Salih Salihu dhe Salih Zyba*, vizitoi Komunën Obiliqit, Koorporatën Energjetike të Kosovës dhe Qendrën e Automjeteve të Kosovës- Eurolab. Shkas për këtë vizitë ishte shqetësimi i madh i qytetarëve për ndotjen e mjedisit sidomos në fillim të sezonës së dimrit.
Në Komunën Obiliqit, nga kryetari i komunës z. Xhafer Gashi u njoftuan për gjendjen e mjedisit në këtë komunë, problemet e ndotjes nga termocentralet A dhe B dhe ndotësit e tjerë si dhe për implemetimin i Ligjit për Zonën e Rrezikuar të Obiliqit.
Në Termocentralin Kosova B të Koorporatës Energjetike të Kosovës në Obiliq, nga drejtori menaxhues I KEK-ut z. Nijazi Thaqi me bashkëpunëtorë, u njoftuan për ndotjen që shkaktojnë termocentralet, funksionimin e elektrofiltrave të TC-B, investimet në mbrojtjen e mjedisit, roli i KEK-ut në zbatimin e Ligjit të Obiliqit, etj
Në Qendrën e Automjeteve të Kosovës- Eurolab, nga Veton Begolli, drejtor gjeneral dhe Kumbim Shala drejtor teknik, u njoftuan për rolin e kësaj qendre në parandalimin e ndotjes së ajrit nga automjetet, procesin e homologimit dhe certifikatat ekologjike të automjeteve.
- Më 22.11.2018, në emër të Komisionit deputeti Salih Zyba, morri pjesë në tryezën e organizuar nga Avokati i popullit, me temën “Parandalimi dhe luftimi i problemeve të mjedisit” në Hotel Emerald.
- Më 6.12.2018, kryetari i Komisionit Muharrem Nitaj, takoi z. Peter Vanhoutte nga CESS (*Centre for European Security Studies*) për të diskutuar mundësitë e mbështetjes së Komisionit në vitin 2019.

IV. REZYME E PUNËS SË KOMISIONIT

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelare i indikatorëve matës të punës së komisionit

Nr.	Indikatorët	Total
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	27
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	97
3.	Procesverbale të hartuara	27
4.	Projektligje të shqyrtuara	4
5.	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komision	6
6.	Numri i grupeve punuese të formuara	10
7.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	16
8.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të Komisionit të Përhershëm (<i>të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme</i>)	-
9.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të Komisionit të Përhershëm (<i>të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme</i>)	-

10.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të Komisionit FunkSIONAL	98
11.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të Komisionit FunkSIONAL	4
12.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	-
13.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	4
14.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	7
15.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	11
16.	Numri i raportimeve të ministrave	4
17.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	-
18.	Vizitat e realizuara brenda vendit	4
19.	Dëgjime publike	-
20.	Tryeza	2
21.	Monitorimi i ligjeve	-
22.	Monitorimi i ligjeve në procedurë në komision	2
23.	Numri i peticioneve	1
24.	Dëgjime buxhetore	-
25.	Raportet të shqyrtuara të auditimit	-
26.	Shpallja e konkursit për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës	2
27.	Nisma ligjore të Komisionit	2
28.	Numri i strategjive dhe planeve	2

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Struktura e Komisionit:

1. Besa BAFTIU G/P- PSD, Kryetare,
2. Enver HOTI G/P-NISMA, Zëvendëskryetar i parë,
3. Miljana NIKOLIQ G/P-LS, Zëvendëskryetare e dytë,
4. Fatmire KOLLQAKU-MULHAXHAG/P-VV, Anëtare,
5. Drita MILLAKU G/P-VV, Anëtar,
6. Haxhi AVDYLLIG/P-LDK, Anëtar,
7. Naser RUGOVAG/P-LDK, Anëtar,
8. Flora BROVINAG/P-PDK, Anëtare,
9. Bekim HAXHIU G/P-PDK, Anëtar,
10. Time KADRIJAJ G/P-AAK, Anëtare
11. Fikrim DAMKAG/P-6+, Anëtar,

I. Hyrje

Raporti përfshinë periudhën Janar – Dhjetor 2018. Ky raport është bazuar në të dhënat e mbledhura nga puna e komisionit, nga mbledhjet e mbajtura, vizitat e realizuara, dëgjimet publike, monitorimet e ligjeve etj.

Sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni ka për detyrë të shqyrtoj dhe procedoj pa vonesë çështjet që i adresohen atij.

Komisioni ka për detyrë t'i rekomandoi Kuvendit për diskutim dhe miratim të çështjeve që kanë të bëjnë me fushëveprimin e Komisionit, apo çështjet që i janë adresuar.

II. Fushe veprimtaria e Komisionit

- Angazhimin për përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave për zhvillimin dhe

- funksionimin efikas të shëndetësisë, të punës dhe të mirëqenies sociale;
- Angazhimin për konceptimin e strategjisë së përgjithshme për mbrojtjen shëndetësore të
- qytetarëve të Kosovës dhe të qytetarëve të tjerë, që përkohësisht gjenden në Kosovë, duke e nxitur aplikimin e standardeve bashkëkohore të shëndetësisë;
- Angazhimin për konceptimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e marrëdhënieve të punës, duke e përfshirë në veçanti hapjen e vendeve të reja të punës;
- Angazhimin për sigurimin e një mirëqenieje të kënaqshme në Kosove, duke i përfshirë
- sigurimin dhe mbrojtjen sociale të qytetarëve të Kosovës, mbrojtjen sociale të invalidëve të luftës, të familjeve të dëshmorëve, të invalidëve të punës, të të burgosurve politikë dhe të familjeve të tyre, të të gjitha kategorive të të paafteve për punë dhe ndërtimin e një sistemi të efektshëm pensional për të gjitha kategoritë.
- Angazhimin për shqyrtimin e programit të Qeverisë, të mënyrës dhe të nivelit të zbatimit të tij në fushën e shëndetësisë, të punës dhe të mirëqenies sociale dhe i jep rekomandime Kuvendit;
- Angazhimin për identifikimin e programeve specifike të Qeverisë, përkatësisht të ministrisë së resorit përkatës dhe në bashkëpunim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, e bën shqyrtimin e hollësishëm si është bërë financimi dhe menaxhimi i tyre;
- Shqyrtimin e legjislacionit të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera, të përcaktuara me këtë Rregullore dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

III. Aktivitetet e Komisionit

Aktivitetet e Komisionit gjatë vitit 2018 kanë qenë si vijon:

a. Mbledhjet e Komisionit

Në mbledhjet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale është punuar sipas Rregullores së Kuvendit dhe marrë në përgjithësi është respektuar kjo Rregullore. Komisioni ka punuar në bazë të planit të punës të miratuar nga ky komision me datë 24 janar 2018.

Komisioni gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsejtë 32 mbledhje. Mbledhjet e komisionit janë mbajtur kryesisht një herë në javë. Mbledhja e parë e komisionit për vitin 2018 është mbajtur më datë 17 janar 2018. Mesatarja e pjesëmarrjes së deputetëve në mbledhje është 9 deputetë. Kohëzgjatja e mbledhjeve mesatarisht ka qenë 1:30 minuta. Për mbledhjet e komisionit rregullisht është hartuar procesverbal nga stafi mbështetës i komisionit.

Mbledhjet e komisionit janë thirrur nga Kryetarja e komisionit, e cila edhe ka përcaktuar rendin e ditës. Vendimet në mbledhjet e komisionit janë marr me konsensus ose me shumicë votash.

Mbledhjet e Komisionit çdo herë kanë qenë të hapura për publik.

b. Shqyrtimi i projektligjeve

1. Grupet punuese

Komisioni ka formuar 5 grupe punuese:

- Grupi punues për amendamentimin e Projektligjit për ndërmarrjet sociale –Flora Brovina –Kryesuese.
- Grupi punues për amendamentimin e Projektligji për gjak dhe përbërës të gjakut – Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, kryesuese.
- Grupi punues për Monitorimin e zbatimit të Ligjit për Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare – Time Kadrijaj, kryesuese.
- Grupi punues për amendamentimin e Projektligjit për Inspektoratin e punës-Bekim Haxhiu, kryesues.
- Grupi punues për monitorimin e Ligjit 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale-Naser Rugova, kryesues.

Grupet punuese kanë mbajtur gjithsej 10 mbledhje.

Rekomandimet janë përgatitur nga zyrtarët e komisionit në bashkëpunim me kryetaren e komisionit.

2. Shqyrtimi i projektligjeve

Shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e komisionit funksional

Projektligjet e shqyrtuara dhe miratuara janë:

- Projektligji për gjak dhe përbërës të gjakut –I miratuar nga Kuvendi.
- Projektligjit për ndërmarrjet sociale –I miratuar nga Kuvendi.

Projektligjet në procedurë të shqyrtimit janë:

- Projektligji për Inspektoratin e punës – në fazën e amendamentimit në Komision.
- Projektligji për Këshillin Ekonomiko – Social - në fazën e amendamentimit në Komision.

c. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese

Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale nuk ka në kompetencë të mbikëqyrë asnjë agjenci të pavarur.

d. Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private

Komisioni ka shqyrtuar 13 shkresa, nga institucione, shoqata dhe individ.

e. Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale gjatë kësaj periudhe ka mbajtur një (2) dëgjim publik:

- *Me 7 shkurt 2018, Dëgjim publik për Projektligji përndërmarrjet sociale*
- *Me 4 dhjetor 2018, Dëgjim publik për Projektligjin për Inspektoratin e punës*

f. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, Komisioni ka autoritetin të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve nga Qeveria e Kosovës ose ministria përkatëse.

Në bazë të këtij autoriteti, gjatë këtij viti Komisioni ka monitoruar një ligj , dhe ka filluar monitorimin e një ligji tjetër:

- *Monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare – raporti është miratuar në Kuvend.*
- *Monitorimin e zbatimit të Ligjit 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale – në fazën e realizimit të monitorimit.*

g. Vizitat

- *Vizitat brenda vendit*

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar këto vizita:

- Vizitë në drejtorin e SHSKUK dhe në disa klinika të QKUK.
- Komisioni ka realizuar edhe disa vizita monitoruese: në Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorisë për Integritet Evropian dhe Çështje Sociale në Komunën e Mitrovicës, Qendrës për punë sociale në Komunën e Prishtinës, strehimoren „Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve” – Prishtinë, Qendrën për Punë sociale në komunën e Ferizajt, strehimoren „ Shtëpia ime ” në Ferizaj
- Vizitë drejtorit të SHSKUK.
- Vizitë në Klinikën e Onkologjisë.
- Vizitë në Ministrin e Shëndetësisë.
- Vizitë në AKPPM.
- Vizitë QKUK - Këshillit Grevist.

- *Vizitat jashtë vendit*

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale gjatë kësaj periudhe ka realizuar një(1) vizitë :

- *Vizitë në Republikën e Shqipërisë 17- 20 qershor 2018*

h. Takimet dhe raportimet e ministrave në Komision

Me ftesë para Komisionit, kanë raportuar Ministri i Shëndetësisë, z. Uran Ismaili dhe Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica.

1. Ministri i ministrisë së punës z. Skender Reçica ka raportuar për procesin e ratifikimit të marrëveshjes se pensioneve në mes të shtetit të Kosovës dhe shtetit të Zvicrës.
2. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë z. Uran Ismaili ka raportuar për Adresimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit të performancës për efikasitetin dhe efektivitetin në implementimin e sistemit informativ unik të integruar shëndetësor dhe procesin e revidimit të listës esenciale të barnave.
3. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë z. Uran Ismaili ka raportuar për furnizimin me barna nga lista esenciale, procesin e revidimit të listës esenciale të Barnave, funksionalizimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe vonesat në procedimin e projektligjeve.
4. Ministri i ministrisë së punës z. Skender Reçica ka raportuar për Zbatimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, zbatimin e Ligjit për personat e verbër, zbatimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, funksionimin e Këshillit Ekonomiko Social dhe rrezikshmërinë në punë;

5. Ministri i ministrisë së punës z. Skender Reçica ka raportuar për vonesat në përmbushjen e agjendës legislative, për projeksionet buxhetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2019 dhe për zbatimin e Ligjit për personat e dhunuar gjatë luftës;
6. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë z. Uran Ismaili ka raportuar për procesin e revidimit të listës esenciale të barnave, për vonesat në procedimin e Projektligjeve në Kuvend dhe për projeksionet buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2019.

i. Tryezat e Komisionit

Tryezat e organizuara nga Komisioni:

- Tryezë në bashkëpunim me UNDP- Roli i Kuvendit të Republikës së Kosovës në zbatimin e Rezolutës Nr.06-R-001 të Kuvendit mbi miratimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm;
- Tryezë - Statusi i Fondit Pensional të Kosovës, në kontekstin e dialogut Kosovë-Serbi;
- Tryezë në bashkëpunim me NDI - Përdorimi i substancave narkotike nga fëmijët në Kosovë;

Tryezat ku kanë marrë pjesë anëtarët e Komisionit :

- Pjesëmarrje e kryetares në tryezën e organizuar nga KOMF –UNICEF.
- Pjesëmarrje e kryetares dhe anëtarëve të Komisionit në tryezën e organizuar nga UNDP.
- Pjesëmarrje e kryetares dhe anëtarëve të Komisionit në tryezën e organizuar nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me revidimin e listës esenciale të barnave.
- Pjesëmarrje e kryetares dhe anëtarëve të Komisionit në tryezën e organizuar nga INDEP
- Pjesëmarrje e kryetares dhe anëtarëve të Komisionit në tryezën e organizuar nga FSSHK.
- Pjesëmarrje e kryetares dhe anëtarëve të Komisionit në tryezën e organizuar nga KDI.

j. Takimet e kryetares dhe anëtarëve të komisionit

1. Takim i kryetares dhe anëtarëve të Komisionit me ministrin e shëndetësisë z. Uran Ismaili.
2. Takim i kryetares dhe anëtarëve të Komisionit me konsulentin ndërkombëtar të OBSH, Z.Ian Gray nga Britania e Madhe.
3. Takim i kryetares me z. Peter Vanhoute dhe Merijn Hartog, nga projekti i Qeverisë Holandeze për mbështetje Kuvendit të Kosovës.
4. Takim i kryetares me përfaqësues të UNICEF në Kosovë.
5. Takim i kryetares dhe anëtarëve të Komisionit në Ministrinë e Shëndetësisë –shënimi i javës së imunizimit.
6. Takim i kryetares dhe anëtarëve të Komisionit mbajtur në Qeverinë e Kosovës me rastin e shënimit të ditës botërore të shëndetit.
7. Takim i kryetares me Florina Duli nga OJQ – Iniciativa Kosovare për Stabilitet – IKS.

8. Takim i kryetares me përfaqësues të UNICEF dhe përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë
9. Takim i kryetares me përfaqësues nga KDI
10. Takim i kryetares dhe anëtarëve të Komisionit me ministrin e shëndetësisë Z. Uran Ismaili dhe drejtorët e MSH.
11. Takim i kryetares me përfaqësues të UNICEF dhe KOMF.
12. Takim i kryetares me përfaqësues të UNDP.
13. Takim i kryetares me Florina Duli nga OJQ – Iniciativa Kosovare për Stabilitet –përkrahje për Projektligjin për Inspektoratin e punës.
14. Takim i kryetares me ekspertin e OBSH z. Lorenzo Moja.
15. Takim i komisionit me Këshillin Greviste në QKUK.

IV. Rezume e punës së Komisionit

Tabela – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së komisionit.

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	32
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	131
3.	Procesverbale të hartuara	30
4.	Projektligje të shqyrtuara	2
5.	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komision	2
6.	Numri i grupeve punuese të formuara	6
7.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	10
8.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit të përhershëm <i>(të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)</i>	
9.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të komisionit të përhershëm <i>(të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)</i>	
10.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit funksional	104
11.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të komisionit funksional	2
12.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	0
13.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	0
14.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	13
15.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	5
16.	Numri i raportimeve të ministrave	6
17.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	1
18.	Vizitat e realizuara brenda vendit	10
19.	Dëgjime publike	2
20.	Monitorimi i ligjeve	1
21.	Monitorimi i ligjeve në procedurë në komision	1
22.	Tryeza	3
23.	Takime tjera të kryetares dhe anëtarëve të Komisionit	15

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Përbërja dhe struktura e Komisionit

1	Nait Hasani	Kryetar	GP-PDK
2	Shqipe Pantina	Zëvendëskryetare e parë	GP-PSD
3	Jasmina Zivkovic	Zëvendëskryetare e dytë	GP -LS
4	Valon Ramadani	Anëtar	GP-VV
5	Adem Mikullovc	Anëtar	GP-VV
6	Arban Abrashi	Anëtar	GP-LDK
7	Imet Rrahmani	Anëtar	GP-LDK
8	Xhevahire Izmaku	Anëtare	GP-PDK
9	Rasim Selmanaj	Anëtar	GP-AAK
10	Milaim Zeka	Anëtar	GP-Nisma
11	Albert Kinolli	Anëtar	GP- 6+

I. Hyrje

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me qëllim të pasqyrimin të punës së tij, ka hartuar raportin e tij, i cili përmban të dhëna, informacione dhe shënime që tregojnë aktivitetet dhe punët që i ka realizuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2018, konform detyrave dhe përgjegjësisë që i ka të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.

II. Fushëveprimtaria e Komisionit

Fushëveprimi i këtij Komisioni përfshinë:

- Shqyrtimin, përcaktimin dhe koordinimin e politikave të punës për një shërbim objektiv civil për të gjithë qytetarët, pa dallime, mbi bazën e objektivitetit, të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë;
- Projektet e aftësimit dhe të ngritjes profesionale të kuadrove për shërbimin civil;
- Propozimin e masave për ofrimin e shërbimeve të inxhinierisë dhe të menaxhimit të ndërtesave;
- Propozimin e masave për administrimin e sistemit të pagesave dhe listën e pagave të shërbimit civil;
- Shqyrtimin e standardeve për shërbimet e teknologjisë informative, që duhet përdorur;
- Shqyrtimin e implementimit të politikës së punës për sigurimin e shërbimeve të furnizimit në përputhje me rregullat dhe me procedurat e përcaktuara;
- Shqyrtimin e çështjeve për administrimin dhe regjistrimin e OJQ-ve;
- Shqyrtimin e çështjeve me rëndësi për mbledhjen, mirëmbajtjen, analizën dhe për publikimin e statistikave zyrtare;
- Shqyrtimin e çështjeve për administrimin dhe për mirëmbajtjen e sistemit kadastror;
- Mbikëqyrjen e administratës lokale dhe funksionimin e pushtetit lokal;
- Shqyrtimin e legjislacionit të fushëveprimin të tij;
- Shqyrtimin e listës së anëtarëve për Komisionin e Pavarur për Media dhe për Bordin e Mediave Publike;

- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimi i buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera, të përcaktuara me rregullore dhe të çështjeve të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

Në ushtrimin e funksioneve Komisioni bashkëpunon me Ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministritë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.

III. Aktivitetet e Komisionit

a. Mbledhjet e Komisionit

Komisioni ka miratuar Planin e punës, në bazë të të cilit ka zhvilluar aktivitetet e tij. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2018, Komisioni ka mbajtur gjithsejtë 40 mbledhje. Mbledhjet e komisionit kanë qenë publike dhe janë monitoruar nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe jo qeveritare vendore e ndërkombëtare. Punën e komisionit e kanë vëzhguar përfaqësuesit e OSCE-së, NDI-së, KDI-së, GIZ, GAP, BIRN, asociacione dhe organizata të tjera. Gjithashtu, puna e komisionit ka pasur hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe elektronike.

b. Shqyrtimi i projektligjeve

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka shqyrtuar dhe ka rekomanduar miratimin e Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA).

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional ka hartuar, shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës,.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional ka hartuar Projektligjin për Transmetuesin Publik të Kosovës, i cili projektligj është në procedurë për miratim në parim në seancë plenare.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për lirinë e asociimit në Organizatat Joqeveritare, i cili projektligj është miratuar në seancë plenare, dhe është në procedurë për lexim të tretë pas vërejtjeve nga Zyra e Presidentit.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës;

Komisioni ka në procedurë të shqyrtimit dhe amendamentimit projektligjet si në vijim:

1. Projektligjin nr. 06/L-111, për Pagat në Sektorin Publik;
2. Projektligjin nr. 06/L-113, për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura;
3. Projektligjin nr.06/L-114, për Zyrtarët Publik;
4. Projektligjin nr.06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike;
5. Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.
6. Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional ka marrë nismën ligjore për hartimin e Draftligjit për Mediet në Kosovë.

c. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese.

Komisioni për Administratë publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka shqyrtuar raportet vjetore të organeve të pavarura si në vijim:

1. *Raportin vjetor të punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil;*
2. *Raportin vjetor të punës së Radiotelevizionit të Kosovës;*
3. *Raportin vjetor të Statistikave Zyrtare;*
4. *Raportin vjetor të punës së Komisionit të Pavarur për Media.*
5. *Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.*

d. Aktivitetet tjera të Komisionit

Komisioni ka mbajtur tri dëgjime publike: për Pligjin për OJQ, P/ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Pakon ligjore për reformën e administrates publike.

Komisioni ka mbajtur pesë tryeza dhe katër punëtori lidhur me projektligjet që bien në fushëveprimtarinë e Komisionit;

Komisioni ka mbajtur mbledhje të përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa në lidhje me draftimin e Ligjit për transmetuesin publik të Kosovës;

Grupi Punues i Komisionit për Administratë Publike me Komisionin për Buxhet dhe Financa ka mbajtur dy takime për amendamentimin e Projektligjit për OJQ.

Komisioni ka formuar grupin punues për amendamentimin e projektligjit për qasje në dokumente publike.

e. Vizitat e komisionit brenda dhe jashtë vendit

Komisioni gjatë kësaj periudhe ka realizuar 11 vizita jashtë vendit.

IV. Rezyme e punës së Komisionit

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhje të mbajtura	38
2	Numri i pikave të rendit të ditës	148
3	Procesverbale të hartuara	30
4	Projektligje të shqyrtuara	13

5	Numri i grupeve punuese të formuara	2
6	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	5
7	Numri i amendamenteve të propozuara	93
8	Numri i amendamenteve të shqyrtuara	/
9	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	13
10	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
11	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	5
12	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	/
13	Numri i vendimeve që i ka marrë Komisioni	6
14	Vizitat e realizuara jashtë vendit	11
15	Vizitat e realizuara brenda vendit	/
16	Dëgjime publike	3
17	Monitorimi i ligjeve	/
18	Tryeza	5

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së

Përbërja e Komisionit

1. Haxhi Shala -kryetar	GP-NS
2. Rexhep Selimi- zëvendëskryetar i parë	GP-VV
3. Zoran Mojsilovic - zëvendëskryetar i dytë,	GP-LS
4. Xhelal Sveçla-anëtar	GP-VV
5. Aida Derguti	GP-PSD
6. Ismet Beqiri- anëtar	GP-LDK
7. Ramiz Kelmendi -anëtar	GP-LDK
8. Fatmir Xhelili-anëtar	GP-PDK
9. Fadil Beka-anëtar	GP-PDK
10. Daut Haradinaj -anëtar	GP-AAK
11. Bahrim Shabani-anëtar	GP 6+

I. Hyrje

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë (tutje Komisioni), është komision funksional i Kuvendit të Republikës së Kosovës, përgjegjës për çështjet e sigurisë. Veprimtaria e punës së Komisionit gjatë vitit 2018, është zhvilluar në dy sesionit e Kuvendit dhe ky raport është hartuar në baze të aktiviteteve të dy sesioneve. Komisioni, gjatë vitit 2018, ka zhvilluar aktivitetin e tij, në bazë të planit të punës, të miratuar në fillim të vitit. Këto aktivitete janë realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta të komisionit, mbledhjeve të grupeve të punës, dëgjimeve publike, takimeve zyrtare dhe vizitave në terren.

II. AKTIVITETET E SESIONIT PRANVEROR

1. Mbledhjet e Komisionit

Komisioni, gjatë këtij sesioni, ka mbajtur 15 (pesëmbëdhjetë) mbledhje të rregullta. Mbledhja e parë në këtë vit është mbajtur më 23 janar 2018. Në mbledhjet e Komisionit, sipas ftesës, kanë marrë pjesë përfaqësues të ministrive (ministra, zëvendësministra) dhe përfaqësues të organizatave të tjera. Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike, janë mbikëqyrur dhe monitoruar nga organizata vendore e

ndërkombëtare. Aktivitetet e Komisionit janë pasqyruar edhe në raportimet e mediave të shkruara dhe atyre elektronike.

2. *Shqyrtimi i projektligjeve*

Komisioni gjatë këtij sesiioni ka shqyrtuar këto projektligje :

- Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214,
- Projektligjin 06/L-014 për Infrastrukturë Kritike
- Projektligjin Nr.06/L-026 për Azil;
- Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për te Huajt

3. *Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve të pavarura*

Komisioni, në bazë të fushëveprimit të tij, gjatë këtij sesiioni ka shqyrtuar:

- Raportin vjetor te punës për vitin 2017 të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtën e të Dhënave Personale.
- Raportin vjetor të Inspektoratit Policor të Kosovës për vitin 2017

4. *Seancat raportuese para Komisionit*

Gjatë këtij sesiioni para Komisionit kanë raportuar ministrat e linjës si vijon:

- Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me prioritetet dhe sfidat e kësaj ministrie;
- Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme (2 herë), lidhur me prioritetet dhe sfidat e kësaj ministrie dhe rreth zbatimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe Marrëveshjeve të Brukselit mes Kosovës dhe Serbisë;
- Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme(1 herë), lidhur me zhvillimet në Inspektoratin Policor të Kosovës
- Ministri i Punëve të Brendshme(1 herë) lidhur me objektivat e Ministrisë

5. *Dëgjime publike*

Komisioni, për këtë periudhë, nuk ka realizuar dëgjime publike.

6. *Vizitat e punës së Komisionit brenda vendit*

Gjatë këtij sesiioni , Komisioni ka realizuar këto vizita brenda vendit:

- Vizitë pune në Forcën e Sigurisë, Komanda e Trajtimit dhe Doktrinës ne Ferizaj më 29 maj 2018;
- Vizitë pune në Inspektoratin Policor të Kosovës, datë 14 mars 2018

7. *Vizitat e punës së Komisionit brenda dhe jashtë vendit*

Gjatë këtij sesiioni , Komisioni ka realizuar këto vizita jashtë vendit:

- Pjesëmarrja në programin trajnues të Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Bruksel, datë 28-31 janar 2018;
- Pjesëmarrja në takimim e përvitshëm të Komisioneve parlamentare të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Shkup datë 24-26 qershor 2018.

8. Pritja e delegacioneve të huaja

Gjatë këtij sesion 2018, Komisioni ka pritur në takim ish Komisionarin e Forcave të Armatosura të Republikës federale të Gjermanisë z. Reinhold Robbe, datë 6 mars 2018.

9. Tryeza dhe konferenca

- Tryezën e Rrumbullakët mbi "Çështjet dhe Sfidat e Llogaridhënies së Inteligjencës në Shoqëritë Demokratike 26 shkurt 2018
- Tryeza e Rrumbullakët për Monitorimin e Zbatimit të Ligjit të Kosovës për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike 5 korrik 2018.

10. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit

Komisioni gjatë këtij sesioni ka realizuar mbikëqyrjen e zbatimit të një ligji:

- Ligjin Nr.03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Përgjatë këtij procesi, në takimet e grupeve punuese kanë raportuar gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) zyrtar/përfaqësues të institucioneve që janë konsideruar të nevojshme për këtë mbikëqyrje.

III. AKTIVITETET E SESIONIT VJESHTOR

1. Mbledhjet e Komisionit

Komisioni, gjatë këtij sesioni, ka mbajtur 8 (tetë) mbledhje të rregullta. Në mbledhjet e Komisionit, sipas ftesës, kanë marrë pjesë përfaqësues të ministrive (ministra, zëvendësministra) dhe përfaqësues të organizatave të tjera. Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike, janë mbikëqyrur dhe monitoruar nga organizata vendore e ndërkombëtare. Aktivitetet e Komisionit janë pasqyruar edhe në raportimet e mediave të shkruara dhe atyre elektronike.

2. Shqyrtimi i projektligjeve

Komisioni, gjatë këtij sesioni ka shqyrtuar këto projektligje :

- Projektligjin Nr. nr.06/L-082 për Mbrojtën e të Dhënave Personale;
- Projektligjin Nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes;
- Projektligjin Nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
- Projektligjin Nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

3. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve të pavarura

Komisioni, në bazë të fushëveprimit të tij, gjatë këtij sesioni nuk ka pasur në shqyrtim ndonjë raport.

4. Seancat raportuese para Komisionit

Gjatë këtij sesioni para Komisionit kanë raportuar ministrat e linjës si vijon:

- Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, datë 2 tetor 2018, lidhur me situatën e sigurisë në vend dhe objektivat e Ministrisë.
- Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, datë 19 dhjetor 2018, lidhur me objektivat e Ministrisë.
- Raportimi i Drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, datë 19 dhjetor 2018

5. Dëgjimet publike

Komisioni, për këtë periudhë, ka realizuar dy (2) dëgjime publik lidhur me pakon e projektligjeve për transformimin e FSK-së. Qëllimi i këtyre dëgjimeve publike, ka qenë diskutimi më banoret e komuniteteve lokale, lidhur me pakon e ligjeve për mandatin e ri të FSK dhe perspektiva e komuniteteve për shërbim në të ardhmen.

- Dëgjimi i parë është mbajtur me date 6 nëntor në Prizren;
- Njëri dëgjim publik është organizuar në Prizren ndërsa tjetri në Çagllavicë.

6. Vizitat e punës së Komisionit brenda vendit

Gjatë këtij sesioni, Komisioni ka realizuar këto vizita një vizite brenda vendit:

- Vizitë pune në Ministrinë e Forcës së Sigurisë, datë 30 tetor 2018

7. Vizitat e punës së Komisionit jashtë vendit

Gjatë këtij vitit, Komisioni ka realizuar këto vizita brenda vendit:

- Pjesëmarrja në seminarin ndërkombëtar- Grupi për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore, 25-27 shtator 2018, Tiranë.
- Pjesëmarrja në konferencën ndërparlamentare për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe Sigurisë si dhe për Politikë të Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes 11-12 tetor 2018, Vjenë-Austri.

8. Pritja e delegacioneve të huaja

- Takim me pjesëmarrësit e Konferencës ndërkombëtare të sigurisë;
- Takim i zv. Kryetarit të Komisionit z. Rexhep Selimi me përfaqësuesit Qendrës së Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura.

9. Tryeza dhe konferenca

Gjatë këtij sesion 2018, Komisioni nuk ka mbajtur tryeza apo konference.

10. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

- Komisioni gjatë këtij sesioni ka vijuar me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr.03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës. Përgjatë këtij procesi, në takimet e grupeve punuese kanë raportuar gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) zyrtar/përfaqësues të institucioneve që janë konsideruar të nevojshme për këtë mbikëqyrje. Grupi punues është në përfundime sipër të këtij raporti, i cili pritet që në sesionin pranveror të vitit të ardhshëm të procedohet në seancë plenare.

IV. Rezime e punës së Komisionit

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit.

Nr.	Indikatorët	Totali
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	23
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	82
3.	Procesverbale të hartuara	23

4.	Projektligje të shqyrtuara	8
5.	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komision	1
6.	Numri i grupeve punuese të formuara	8
7.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	26
8.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit të përhershëm (të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)	/
9.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të komisionit të përhershëm (të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)	/
10.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit funksional	176
11.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të komisionit funksional	8
12.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	
13.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	2
14.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	/
15.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	11
16.	Numri i raportimeve të ministrave	6
17.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	7
18.	Vizitat e realizuara brenda vendit	3
19.	Dëgjime publike	2
20.	Monitorimi i ligjeve	/
21.	Monitorimi i ligjeve në procedurë në komision	2
22.	Numri i peticioneve dhe ankesave të shqyrtuara	/

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Përbërja dhe struktura e Komisionit

1	Duda Balje	kryetare	(GP- 6+)
2	Lirije Kajtazi	zëvendëskryetare e parë	(GP- LDK)
3	Miljana Nikoliq, e zëvendësuar nga Sasha Milosavljeviq	zëvendëskryetar/e i dytë	(GP-LS)
4	Saranda Bogujevci	anëtare	(GP- LVV)
5	Frashër Krasniqi, i zëvendësuar nga Fisnik Ismaili	anëtar anëtar	(GP-LVV) (GP-PSD)
6	Mytaher Haskuka, i zëvendësuar nga Shemsi Syla	anëtar anëtar	(GP- LVV)
7	Mirjeta Kalludra	anëtare	(GP- LDK)
8	Mexhide Mjaku-Topalli	anëtare	(GP-PDK)

9	Lujeta Veselaj-Gutaj	anëtare	(GP-PDK)
10	Teuta Haxhiu	anëtare	(GP-AAK)
11	Albulena Halimaj Balaje zëvendësuar nga Veton Berisha	anëtare	(GP-Nisma)

I. Hyrje

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, është Komision Funkcional i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Aktiviteti i Komisionit bazohet në Kushtetutë, ligjet e veçanta dhe Rregulloren e Kuvendit.

Raporti i punës së Komisionit për vitin 2018, përmban aktivitetin e Komisionit brenda fushëveprimit të tij, të përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit.

Plani vjetor i punës së Komisionit dhe rendi i ditës së mbledhjeve, janë agjendat ekzekutive të punës së Komisionit.

I. Fushë veprimtaria e Komisionit Funkcional

Çështjet kryesore të fushëveprimit të Komisionit:

- Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, angazhohet për ndërtimin e infrastrukturës ligjore nën juridiksionin e tij.
- Komisioni mbikëqyrë zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për zbatimin e ligjeve, konventave ndërkombëtare dhe rekomandimeve të tjera nga fushëveprimi i tij.
- Komisioni shqyrton raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe shqyrton zbatimin e rekomandimeve të IAP-it, në fushën e përgjegjësiive të Komisionit.
- Komisioni bashkëpunon me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, në lëmin e zbatimit të ligjeve dhe standardeve, në fushëveprimin e Komisionit.
- Komisioni bashkëpunon me të gjitha organizatat qeveritare dhe joqeveritare, mbështetëse të Komisionit.
- Komisioni bashkëpunon me ekspertë të fushave përkatëse, me qëllim të marrjes së ekspertizave të nevojshme, për çështjet me interes nga fusha e Komisionit.
- Komisioni bashkëpunon me shoqërinë civile dhe mediat, në interes të punës publike dhe transparente dhe të zhvillimit të demokracisë së drejtpërdrejtë.

Të Drejtat dhe Liritë e Njeriut

Zbatimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventave dhe standardeve ndërkombëtare:

- Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;
- Konventën Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe protokollet e saj;

- Konventën ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike të njeriut dhe protokollet e saj;
- Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminim racor;
- Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminim të gruas;
- Konventën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- Konventën Evropiane për gjuhë rajonale;
- Konventën Evropiane për gjuhë rajonale dhe minoritare;
- Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare;
- Shqyrtimi i projektligjeve në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mos diskriminimi në baza ligjore;
- Monitorimi i institucioneve ndëshkimore lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut;
- Shqyrtimi i rasteve të shkeljes së të drejtave të qytetareve gjatë marrjes në pyetje në polici;
- Monitorimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në qasjen e tyre në institucionet publike-private, lidhur me realizimin e të drejtave të tyre.

Barazia Gjinore

Në pajtim me Ligjin për Barazinë Gjinore, ushtron këto veprimtari:

- Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të Ligjit për barazi gjinore;
- Mbikëqyrë punën Agjencisë për Barazi Gjinore;
- Merr nisma për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit dhe të amendamentimit të tij;
- Monitoron marrëveshjet e lidhura ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore;
- Përgatit raporte për Kuvend, në fushën e barazisë gjinore;
- Bashkëpunon me ministrinë dhe zyrat komunale;
- Monitoron aktet nënligjore dhe përcjell zbatimin e tyre;
- Bashkëpunon me OJQ- të dhe institucionet publike;
- Propozon nisma për kërkime dhe analiza në fushën e barazisë gjinore;
- Ndhmon në ngritjen e vetëdijes mbi barazinë gjinore; dhe
- I raporton Kuvendit për punën e Komisionit.

Personat e Pagjetur

Fushëveprimi i Komisionit, në këtë fushë, është përcaktuar me Rregullore të Kuvendit:

- Shqyrton raportet e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur;
- Zhvillon aktivitete sensibilizuese, mbështetëse dhe koordinuese për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur;
- Mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për personat e zhdukur.

Peticionet

Komisioni vepron konform Rregullores së Kuvendit lidhur me:

- Të drejtën parashtrimi të peticionit;
- Shqyrtimin e peticionit;
- Mbledhjen dhe vërtetimin e provave;
- Rekomandimin e peticionit;
- Nxjerrjen e përfundimit lidhur me peticionin;
- Përgjigjen në peticion;

- Komisioni Funkcional në mbledhjen e mbajtur më 8 nëntor 2017, formoi Grupin Punues për shqyrtimin e Peticioneve.

III. Aktivitetet e Komisionit

Aktivitetet e Komisionit, gjatë vitit 2018, në pikëpamje substanciale dhe kohore, janë bazuar në Planin e punës, të miratuar në fillim të këtij sesiioni.

Aktivitetet janë realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta të Komisionit, mbledhjeve të grupeve punuese, tryezave, vizitave monitoruese në terren, punëtorive dhe takimeve të kryetares së Komisionit dhe të anëtarëve të Komisionit.

Mbledhjet e Komisionit

Komisioni, gjatë vitit 2018, mbajti 33 mbledhje të rregullta.

Mbledhja e parë gjatë këtij viti u mbajt më 22 janar 2018, ndërsa, mbledhja e fundit e Komisionit, u mbajt më 19 dhjetor 2018.

Mbledhjet u mbajtën sipas planit të punës, patën organizim të mirë dhe rrjedhë demokratike. Mbledhjet u proceduan sipas Rregullores së Kuvendit dhe patën 90 pika substanciale të rendit të ditës. Në mbledhjet e Komisionit, ishin të ftuar dhe morën pjesë: ministra të ministrive përkatëse, Avokati i Popullit, përfaqësuesit e Qeverisë, dhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera relevante, varësisht prej agjendës së mbledhjeve të Komisionit.

Mbledhjet e Komisionit ishin publike dhe u përcollën nga përfaqësuesit e organizatave qeveritare dhe joqeveritare, vendore e ndërkombëtare.

Punën e Komisionit e përcollën mediat e shkruara dhe elektronike.

Shqyrtimi i projektligjeve

Shqyrtimi i projektligjeve, në cilësinë e Komisionit Funkcional. Komisioni, gjatë sesiioni pranveror të vitit 2018, shqyrtoi projektligjet:

1. Projektligjin nr. 06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.

Ky projektligj u shqyrtua dhe amendamentua nga Komisioni Funkcional dhe u procedua për shqyrtim të dytë në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës.

2. Projektligjin nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës.

Ky Projektligj është miratuar në parim në Kuvend dhe tani është në procedurë të shqyrtimit dhe amendamentimit në Komisionin Funkcional.

3. Projektligjin nr. 06/L- 076 për Peticione,

Këtë Projektligj e ka shqyrtuar në parim Komisioni Funkcional dhe i ka rekomanduar Kuvendit për mosmiratim.

Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese

Komisioni, duke u bazuar në fushëveprimin e tij, gjatë këtij viti, shqyrtoi:

1. Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për 2017.

Komisioni vlerësoi se Raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit, ka qenë përmbajtjesor dhe gjithëpërfshirës.

Sfida kryesore për IAP-in është shkalla e pakënaqshme e zbatimit të rekomandimeve.

Raporti i IAP-it u shqyrtua në Kuvend.

Shqyrtimi i peticioneve

Gjatë këtij sesi, Komisioni shqyrtoi 12 (dymbëdhjetë) peticione, të parashtruara në formë të kërkesës ose ankesës. Nga këto, dhjete peticione, tri prej tyre kanë qenë grupe, kurse nëntë kanë qenë individuale.

Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni, gjatë vitit 2018, mbajti katër dëgjime publike.

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisioni, gjatë vitit 2018, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Komisioni është në procedurë të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për barazi gjinore.

Aktivitetet lidhur me Institucionin e Avokatit të Popullit

Komisioni, duke u bazuar në fushëveprimin e tij, gjatë këtij viti, shqyrtoi:

- Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për 2017.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016.

Komisioni vlerësoi se rekomandimet e dala nga Institucioni i Avokatit të Popullit, janë duke u zbatuar nga institucionet e Republikës së Kosovës, mirëpo, kërkohet avancim në këtë drejtim. Sa i përket zbatimit të këtyre rekomandimeve, pjesa dërmuese e moszbatimit të rekomandimeve të IAP-it, ka të bëjë me sistemin gjyqësor dhe Administratën Publike.

Vizitat e Komisionit

1. Vizitat brenda vendit

Komisioni, gjatë vitit 2018, bëri 21 vizita brenda vendit, në:

1. Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës;
2. Burgun e Dubravës;
3. Zyrën për Qeverisje të Mirë;
4. Agjencinë për Barazi Gjinore;
5. Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
6. Institucionin e Avokatit të Popullit;
7. Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
8. Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
9. Komunën e Klinës;
10. Komunën e Podujevës;
11. Komunën e Fushë-Kosovës;
12. Komunën e Prizrenit;
13. Komunën e Gjilanit;
14. Komunën e Gjakovës,
15. Kompleksin Memorial në Meje të Gjakovës,
16. Komunën e Prizrenit,
17. Shtëpinë e Komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara në Prizren,
18. Komunën e Prishtinës, dhe
19. Komunën e Vitisë.

2. Vizitat jashtë vendit

Anëtarët ose anëtari i Komisionit dhe delegacioni i Komisionit gjatë vitit 2018, bëri 6

vizita jashtë vendit, si në vijim:

1. Vizita në Shqipëri, me ftesë të Kryegjyshit Botërore Bektashiane, lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Lirinë fetare në Kosovë më 13-16 prill 2018.
2. Vizita në Maqedoni, me ftesë të komisionit homolog, komisioni vizitoi Parlamentin e Maqedonisë, më 28 dhe 29 qershor 2018, ku u takuan me Kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë, Komisionin për të Drejtat e Njeriut, si dhe Klubin e Grave Deputete të Kuvendit të Maqedonisë.
3. Me ftesë të Panelit Ndërkombëtar të Parlamentarëve për Lirinë e Fesë ose Besimit, në bashkëpunim me Zyrën e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), delegacioni i Komisionit mori pjesë në Punëtorinë për deputetë nga Ballkani dhe Kaukazi i Jugut. Punëtorja u mbajt në Bukuresht të Rumanisë, më 15-17 qershor 2018.
4. Vizita në Pragë, pjesëmarrja e një anëtare të Komisionit në Konferencën ndërparlamentare të Parlamentit Evropian, me temë: "Mbështetja e lirisë së shprehjes, duke përfshirë lirinë e medias, në BE dhe më gjerë", mbajtur më 15 qershor 2018.
5. Organizuar nga Organizata Save the Children, pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit në trajnimin lidhur me: "*Disiplinën Pozitive në Prindërimin e Përditshëm*", që ka të bëjë edhe me Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës, më 27-30 korrik 2018. Trajnimi u mbajt në Strugë, Republika e Maqedonisë.
6. Me ftesë të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, Mexhide Mjaku Topalli, ka marrë pjesë në Punëtorinë Rajonale mbi Kornizën Ligjore dhe Institucionale për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave të Zhdukur dhe Familjet e Tyre, që u mbajt në Sarajevë, Republika e Bosnjë e Hercegovinës, nga data 14-15 nëntor 2018.

g. Takimet individuale të kryetares dhe anëtarëve të tjerë të Komisionit

Gjatë vitit 2018, janë realizuar takimet dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit, si në vijim:

1. Takim i Komisionit me Kryegjyshin e Kryegjyshit Botërore Bektashiane, më 6.02.2018.
2. Takim i Komisionit me Grupin e Miqësisë nga Kuvajti, më 12.4.2018.
3. Takim i Komisionit me Grupin për Studime Juridike dhe politike, më 17.04,2018.
4. Pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit në hapjen e aktiviteteve për shënimin e javës së personave të pagjetur në Kosovë, më 23.4.2028.
5. Takim i disa anëtarëve të Komisionit me zëvendësministren e Kulturës, znj. Burbuqe Deva, më 13.6.2018;
6. Takim i Komisionit me kryetarin dhe anëtarë të Komisionit për Çështje Ligjore, Administratë Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Republikës së Shqipërisë, më 25 qershor 2018;
7. Takim me përfaqësues të organizatës Save the Children nga Kosova dhe Zvicra, më 27.6.2018.
8. Takim i anëtarëve të Komisionit me Drejtoreshën e organizatës Save the Children nga Suedia, më dt.10.09.2018;
9. Takim i kryetares së Komisionit me Bujar Kadriun, Kryetar i Forumit Kosovarë për Persona me Aftësi të Kufizuara.

10. Takim i anëtarëve të Komisionit me Robert Gajda, Komisioner për Mbrojtje nga Diskriminimi në Republikën e Shqipërisë dhe Hilmi Jashari, Avokat i Popullit në Republikën e Kosovës, me dt.24.09.2018;
11. Takim i kryetares së Komisionit me një delegacion të Komisionit Homolog nga Bosnje e Hercegovina, me dt.1.12.2018.
12. Pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit në Konferencën e organizuar nga IAP, me temën “Bashkëpunimi Institucional me Avokatin e Popullit” mbajtur me dt.18.12.2018, në Hotel Emerald.

IV. Rezume e punës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione- Viti 2018

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	33
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	90
3.	Procesverbale të hartuara	33
4.	Projektligje të shqyrtuara	3
5.	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në komision	1
6.	Numri i grupeve punuese të formuara	4
7.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	9
8.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara, në cilësi të Komisionit të Përhershëm <i>(të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)</i>	/
9.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje, në cilësi të Komisionit të Përhershëm <i>(të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)</i>	/
10.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara, në cilësi të Komisionit FunkSIONAL	31
11.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje, në cilësi të Komisionit FunkSIONAL	3
12.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
13.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	1
14.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	1
15.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	2
16.	Numri i raportimeve të ministrave	9
17.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	6
18.	Vizitat e realizuara brenda vendit	19
19.	Dëgjime publike	4
20.	Monitorimi i ligjeve	1
21.	Monitorimi i ligjeve në procedurë në komision	1
22.	Numri i peticioneve dhe ankesave të shqyrtuara	12
23.	Tryeza të mbajtura	2
24.	Dëgjime buxhetore	/
25.	Raportet e auditimit të shqyrtuara	/
26.	<i>Raport me rekomandime për çështje të tjera për seancë plenare</i>	2
27.	<i>Përfundime</i>	4
28.	<i>Takime të mbajtura të kryetares dhe të Komisionit FunkSIONAL, me kërkesë të institucioneve dhe organizatave të ndryshme</i>	12

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Përbërja dhe struktura e Komisionit

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, gjatë vitit 2018, të Legjislaturës VI, punoi në këtë përbërje:

1	Driton Selmanaj,	kryetar,	GP- LDK
2	Mërgim Lushtaku,	zëvendëskryetar i parë,	GP- PDK
3	Verica Ceraniq,	zëvendëskryetare e dytë,	GP- Lista Serbe
4	Andin Hoti,	anëtar,	GP- PDK
5	Avdullah Hoti,	anëtar,	GP- LDK
6	Faton Topalli,	anëtar,	GP- VV-PSD
7	Shqipe Pantina,	anëtare, deri më 14.6.2018	GP- VV-PSD
	Valon Ramadani,	anëtar, nga 14.6.2018	GP- VV
8	Blerim Kuçi,	anëtar, deri më 26.1.2018	GP- AAK
	Muharrem Nitaj	anëtar, nga 26.1.2018 deri më 30.5.2018	GP- AAK
	Ahmet Isufi	anëtar, nga 30.5.2018 deri më 15.10.2018	GP- AAK
	Emilija Rexhepi	anëtare, nga 15.10.2018	GP- AAK
9	Zafir Berisha	anëtar, deri me 15.10.2018	GP- NISMA
	Etem Arifaj	anëtar, nga 15.10.2018	GP- NISMA
10	Albert Kinolli	anëtar,	GP- 6+
11	Ali Lajçi,	anëtar,	GP- VV

I. HYRJE

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, është Komision Funkcional i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Qëllimi i tij është të mbikëqyrë shpenzimin e parasë publike nga organizatat buxhetore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Më qëllim të pasqyrimin të punës së tij në Legjislaturën VI, Komisioni e ka hartuar Raportin vjetor për vitin 2018, i cili përmban të dhëna, informacione dhe shënime, për aktivitetet dhe për punët që i ka realizuar gjatë këtij viti, në pajtim me detyrat dhe me përgjegjësitë që i ka të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

II. FUSHËVEPRIMI I KOMISIONIT

Fushëveprimi dhe kompetencat e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, janë të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit, si vijon:

- mbikëqyrja e ligjshmërisë së shpenzimeve të parasë publike në bazë të raporteve dhe pasqyrave vjetore dhe periodike të audituara, si dhe raportet e auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- mbikëqyrja e të gjitha raporteve të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, të organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike;
- mbikëqyrja e raporteve të performancës, të hartuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit;
- mbikëqyrja e raporteve të audituara dhe të performancës së shpenzimeve financiare, të hartuara nga institucionet mbikëqyrëse të fondeve publike, agjencive publike, ndërmarrjeve publike, dhe institucioneve publike të financuara nga buxheti i Republikës së Kosovës;
- mbikëqyrja e shpenzimeve publike përmes raporteve të Njësisë Qendrore Harmonizuese (NJQH), të cilat përmes ministrit të financave, i dërgohen Kuvendit dhe këtij Komisioni;
- mbikëqyrja e shpenzimeve publike, nëpërmjet raporteve të agjencive buxhetore, me kërkesë të veçantë të Komisionit;
- shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- kryerja e veprimeve në procedurën e përzgjedhjes së auditorëve të jashtëm, të cilët do të bëjnë auditimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- shqyrtimi i nevojave të Zyrës Kombëtare të Auditimit për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me ligj dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa;
- mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimi i tij.

Shqyrtimin e çështjeve të tjera, të përcaktuara me këtë Rregullore dhe çështjet të cilat, me vendim të veçantë të Kuvendit, i barten këtij Komisioni.

III. AKTIVITETET E KOMISIONIT

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ka punuar sipas Rregullores së Kuvendit, sipas rregullave të procedurës së Komisionit dhe sipas planit të punës së Komisionit.

Këto aktivitete, Komisioni i ka realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta, nëpërmjet mbledhjeve të grupeve të punës, dëgjimeve publike, takimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit, me qëllim të mbikëqyrjes së punës së tyre.

a) Mbledhjet e Komisionit

Komisioni, gjatë vitit 2018 të Legjislaturës VI, i ka realizuar gjithsej 26 (njëzetegjashtë) mbledhje të rregullta. Mbledhjen e tij të parë, në vitin 2018 të Legjislaturës VI, e ka mbajtur më 19 janar 2018, ndërkaq, mbledhja e fundit e Komisionit për vitin 2018, është mbajtur më 19 dhjetor 2018.

Në shumicën e mbledhjeve të Komisionit, sipas ftesës, kanë marrë pjesë përfaqësues të Zyrës Kombëtare të Auditimit, përfaqësues të ministrive (ministra, zëvendësministra, etj.) dhe përfaqësues të organizatave të tjera.

Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike, përveç kur Komisioni ka vendosur ndryshe dhe janë mbikëqyrur nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, vendore e ndërkombëtare. Punën e Komisionit e kanë vëzhguar përfaqësuesit e GIZ-it, OSBE-së, KDI-së, GLPS-së, asociacione dhe organizata të tjera. Po ashtu, puna e Komisionit ka pasur hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe në ato

elektronike.

b) Shqyrtimi i projektligjeve

Komisioni, gjatë vitit 2018 të Legjislaturës VI, ka shqyrtuar Projektligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L-021 në lexim të dytë dhe Projektligjin për Kontabilitet Raportim financiar dhe Auditim nr. 06/L-032 në lexim të parë.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L-021; (shqyrtimi i dytë në Komision).
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjin për Kontabilitet Raportim financiar dhe Auditim nr. 06/L-032.

c) Shqyrtimi i raporteve të auditimit të organizatave buxhetore

Gjatë vitit 2018, Zyra Kombëtare e Auditimit ka proceduar në Kuvend mbi 100 raporte të auditimit, një auditim të performancës së ZKA-së dhe Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Buxhetit për vitin 2017. Prej gjithsej 113 raporteve, 92 prej tyre janë raporte të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të OB-ve, ndërsa 9 janë për Ndërmarrjet Publike, ndërsa 11 prej tyre janë raporte të performancës, si dhe një auditimi i PVF-së të Buxhetit të Shtetit.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ka shqyrtuar raportet e auditimit për 33 organizata buxhetore si vijon:

1. Raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike për vitin 2017;
2. Raportin e performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe pasqyrave financiare të audituara për vitin 2017;
3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës S.H.A., për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016;
4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Kompanisë Regjionale „Pastërtia“ nga Ferizaj, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e SHSKUK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
6. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
7. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Universitetit të Prishtinës (UP-së) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
8. Shqyrtimi i raportit të auditimit për raportin financiar vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
9. Shqyrtimi i raportit të auditimit për raportin financiar vjetor të Fondeve të Mirëbesimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
10. Shqyrtimi i raportit të auditimit për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në Gjykatat Themelore;
11. Shqyrtimi i raportit të auditimit Efektiviteti i Sistemit Informativ të Tatimit në Pronë;
12. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017;
13. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017;

14. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Performancës për “Menaxhimi dhe shfrytëzueshmëria e aplikacionit e-Pasuria”;
15. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e SH.A. Hortikultura për vitin 2017;
16. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Kompanisë Regjionale të Ujitjes Drini i Bardhë SH.A. Pejë, për vitin 2017;
17. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për KRU Prishtina Sh.A, për vitin 2017;
18. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A Prizren, për vitin 2017;
19. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Infrastrukturës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;
20. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Stacionit të Autobusëve Sh.A. Prishtinë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;
21. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2017;
22. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;
23. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;
24. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos SH.A, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;
25. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të PVF-ve të Komunës të Prishtinës, për vitin 2017 ;
26. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të PVF-ve të Komunës së Pejës, për vitin 2017;
27. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të PVF-ve të Komunës së Prizrenit për vitin 2017;
28. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të PVF-ve të Komunës së Gjakovës për vitin 2017 ;
29. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të PVF-ve të Komunës së Gjilanit për vitin 2017;
30. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të PVF-ve të Komunës së Ferizajt për vitin 2017;
31. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të PVF-ve të Komunës së Mitrovicës për vitin 2017 dhe;
32. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të PVF-ve të Komunës së Graçanicës për vitin 2017.
33. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017; dhe
34. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të performancës “ Lista esenciale e barnave”.

d) Rekomandimet e Komisionit për organizatat buxhetore

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, gjatë vitit 2018 të Legjislaturës VI, ka nxjerrë rekomandime për këto organizata buxhetore:

1. Rekomandime për Kuvendin, në lidhje me Auditimin e Raporteve Financiare dhe Raportit të Deklarimit Financiar të fushatës, të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ, për vitin 2017;
2. Rekomandime në lidhje me Raportin e auditimit të PVF-ve për Kompaninë për Menaxhimin e Deponive Sh. A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;

3. Rekomandime në lidhje me Raportin e auditimit të PVF-ve për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave „Pastërtia” në Ferizaj, për vitin 2016;
4. Rekomandime në lidhje me Raportin e auditimit të PVF-ve për SHSKUK-në, për vitin 2016;
5. Raport me Rekomandime për Projektligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
6. Raport me Rekomandime për Projektligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, raportim financiar dhe Auditim;
7. Rekomandime në lidhje me Raportin e auditimit të PVF-ve për Universitetin e Prishtinës (UP-në), për vitin 2016;
8. Rekomandime në lidhje me Raportin e auditimit të PVF-ve për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT-it) për vitin 2016;
9. Rekomandime në lidhje me Raportin e auditimit të PVF-ve për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Fondeve të Mirëbesimit (AKP dhe FM) për vitin 2016;
10. Rekomandime në lidhje me Raportin e auditimit për „Efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në Gjykata Themelore;
11. Rekomandime në lidhje me Raportin e auditimit për „Efektivitetin e sistemit informativ të Tatimit në Pronë;
12. Rekomandime, në lidhje me Raportin e auditimit të PVF-ve për Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) të Kosovës për vitin 2017;
13. Rekomandime, në lidhje me Raportin e auditimit të performancës ” Menaxhimi dhe shfrytëzueshmëria e aplikacionit e-Pasuria”, Ministrinë e Administratës Publike (MAP);
14. Rekomandime, në lidhje me Raportin e auditimit të PVF-ve për Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për vitin 2017;
15. Rekomandime, në lidhje me Raportin e auditimit të PVF-ve për KRU Drini i Bardhë SH.A për vitin 2017;
16. Rekomandime në lidhje me Raportet e Auditimit për PVF- të e Komunave për vitin 2017 për MF;
17. Rekomandime në lidhje me Raportet e Auditimit për PVF- të e Komunave për vitin 2017 për MAP;
18. Rekomandime në lidhje me Raportet e Auditimit për PVF- të Komunave për vitin 2017 për MAPL;
19. Rekomandim për Raportin vjetor të Qeverisë për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2017;
20. Raport me rekomandime - në lidhje me Raportin vjetor të Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017 dhe Raportin e Pasqyrave Financiare të audituara për vitin 2017;
21. Raport me rekomandime - në lidhje me Raportin e Auditimit për KRU Prishtina Sh.A për vitin 2017 ;
22. Rekomandime – lidhur me Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2017;
23. Rekomandim për ZKA-në; që të përfshihen në Planin Vjetor të Auditimit edhe subvencione nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe subvencione nga Ministria e Komuniteteve dhe Kthimeve;
24. Raport me rekomandime - në lidhje me Raportin e Auditimit për PVF -të e Stacionit e Autobusëve në Prishtinë, Sh. A. për vitin 2017;

25. Rekomandime në lidhje me Raportin e auditimit të PVF-ve për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për vitin 2017;
26. Raport me rekomandime në lidhje me Raportin e Auditimit për MKRS-në, për vitin 2017 dhe;
27. Raport me rekomandime në lidhje me Raportin e Auditimit për Ndërmarrjen Publike Hekurudhat e Kosovës “Trainkos SH.A” për vitin 2017.

e) Mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit të dhëna për organizatat buxhetore

KMFP-ja, përkundër përpjekjeve dhe në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe GIZ-in, nuk ka arritur të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe nga Seanca Plenare.

f) Mbajtja e dëgjimeve publike

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, gjatë vitit 2018 të Legjislaturës VI, ka mbajtur 3 (tri) dëgjime publike:

g) Pritja e delegacioneve parlamentare të huaja (homologe)

Gjatë vitit 2018, KMFP-ja ka pritur përfaqësuesit e Gjykatave Supreme të Auditimit të Shqipërisë, Maqedonisë, Polonisë, Suedisë, Danimarkës, Britanisë së Madhe, Turqisë dhe të Holandës.

h) Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve tjerë të Komisionit

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, gjatë vitit 2018 të Legjislaturës VI, ka pasur disa takime tjera, në kuadër të punës së Komisionit:

- Më 8.2.2018, KMFP-ja ka mbajtur një takim pune me auditorin e përgjithshëm të Polonisë;
- Më 4.4.2018, ka zhvilluar takim pune në mes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- Dëgjim publik i datës 25.7.2018, i organizuar nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, për të gjeturat nga auditimet e PVF-së të Komunave dhe;
- Takim pune më 10.10.2018, për prezantimin e të gjeturave dhe rekomandimeve të Raportit Vjetor të Auditimit, për pasqyrat financiare të Qeverisë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017.

IV. Rezyme e punës së Komisionit

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore të indikatorëve matës të punës së Komisionit

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1.	Numri i mbledhjeve të mbajtura	26
2.	Numri i pikave të rendit të ditës	138
3.	Procesverbale të hartuara	26
4.	Projektligje të shqyrtuara	2
5.	Projektligje në procedurën e shqyrtimit në Komision	0
6.	Numri i grupeve punuese të formuara	1
7.	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	3
8.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të Komisionit të Përhershëm (të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)	/

9.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje, në cilësi të Komisionit të Përhershëm <i>(të plotësohet vetëm nga komisionet e përhershme)</i>	/
10.	Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të Komisionit FunkSIONAL	15
11.	Numri i raporteve të hartuara për projektligje në cilësi të Komisionit FunkSIONAL	2
12.	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
13.	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese	2
14.	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	2
15.	Numri i vendimeve që i ka marrë komisioni	2
16.	Numri i raportimeve të ministrave	7
17.	Vizitat e realizuara jashtë vendit	1
18.	Vizitat e realizuara brenda vendit	2
19.	Dëgjime publike	3
20.	Monitorimi i ligjeve	/
21.	Monitorimi i ligjeve në procedurë në komision	/
22.	Numri i peticioneve dhe ankesave të shqyrtuara	/
23.	Mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, të dhëna për organizatat buxhetore	/
24.	Raportet e auditimit të shqyrtuara	34
25.	Rekomandimet e Komisionit	101
26.	Tryeza – punëtori	3

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë Përbërja dhe struktura e Komisionit

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të marrë në mbledhje plenare, datë 08 tetor 2017, për formimin e komisioneve parlamentare, Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, ka këtë përbërje dhe strukturë:

1. Donika Kadaj –Bujupi Kryetare e Komisionit	GP –LVV (deri 14 Mars 2018)
2. Ganimete Musliu, Zëvendëskryetare e parë e Komisionit	GP-PDK
3 Bahrin Shabani Zëvendëskryetari i dytë i Komisionit	GP-6+
4. Arbër Rexhaj, anëtarë i Komisionit	GP-LVV
5. Liburn Aliu, anëtar i Komisionit Shemsi Syla anëtar i Komisionit	GP-LVV (deri 14.06.2018) GP-LVV
6. Anton Quni , anëtar i Komisionit	GP-LDK
7. Teuta Rugova , anëtare e Komisionit	GP-LDK
8. Xhevahire Izmaqu , anëtare e Komisionit	GP-PDK
9. Bekë Berisha , anëtar i Komisionit	GP-AAK
10. Slavko Simic anëtarë i Komisionit	GP-LS
11. Haxhi Shala anëtar i Komisionit 11.Zafir Berisha GP -NISMA anëtarë i Komisionit	GP-NISMA (deri 15.10.2018)

I. Hyrje

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, (më tutje Komisioni) është Komisioni Funkcional i Kuvendit të Kosovës, përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, (më tutje AKI).

Komisioni është themeluar me vendim të mbledhjes plenare, të datës 13 Tetor 2018. Themelimi dhe funksionimi i Komisionit bazohet në dispozitat e Rregullores së Kuvendit, respektivisht kreu XIV, ku përcaktohen rregullat për funksionin e komisioneve. Për më tepër, gjatë procedimit apo trajtimit të një çështje në Komision, e cila proceduralisht, nuk është mbuluar me dispozitat e lartpërmendura, atëherë në mënyrë analoge zbatohen dispozitat për mbledhjen plenare.

Dinamikën e aktiviteteve për vitin 2018, Komisioni i ka përcaktuar dhe realizuar në përputhje me planin e tij të punës, të cilin e ka miratuar në fillim të vitit, ku përfshihen të gjitha aktivitetet në formë tabelore, objektivat, fushëveprimi dhe rregullat për funksionimin e brendshëm.

II. Fushëveprimi i Komisionit

Komisioni, në cilësinë e Komisionit Funkcional, është përgjegjës:

- për mbikëqyrjen e ligjshmërisë të punës së Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
- për shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
- për shqyrtimin e raporteve të Kryeministrit për çështjet në kuadër të kompetencave të tij, që lidhen me Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës, duke përfshirë veprimet e ndërmarra për korrigjimin e çfarëdo problemi në Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, të vënë në pah nga ndonjë inspektim, auditim ose hetim;
- për shqyrtimin e raporteve të drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, përkitazi me operacionet dhe shpenzimet e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës;
- për shqyrtimin e raporteve të inspektorit të përgjithshëm;
- për sigurimin e një mendimi mbi propozim buxhetin e detajuar për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës;
- për kërkim dhe hetim të informatave, përkitazi me punën e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë në përputhje me nenin 37 të Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

III. Aktivitetet e Komisionit

Aktivitetet e Komisionit gjatë vitit 2018, kanë qenë si në vijim:

a. Mbledhjet e Komisionit

Mbledhja e parë konstituive e Komisionit është mbajtur më 13 Tetor 2018. Më tej, Komisioni ka vazhduar me realizimin dhe mbajtjen e mbledhjeve të rregullta, në përputhje me planin e punës për vitin 2018 dhe në bazë të çështjeve që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me fushëveprimin e Komisionit, gjithnjë duke zbatuar procedurat e parapara me Ligjin për AKI dhe Rregulloren e Kuvendit. Në përgjithësi, që nga konstituimi e deri në përfundim të vitit 2018, Komisioni ka mbajtur 19 (nëntëmbëdhjetë) mbledhje të rregullta dhe 5 (pesë) vizita pune në Drejtoritë Rajonale të AKI.

b. Shqyrtimi i projektligjeve

Gjatë këtij viti, Komisioni, nuk ka pasur në procedurë të shqyrtimit dhe amendamentimit ndonjë projektligj.

c. Shqyrtimi i raporteve vjetore për punën e institucioneve raportuese

Gjatë vitit 2018, Komisioni ka pasur për shqyrtim raport për punën e institucionit të cilin e mbikëqyrë, përveç raportimeve gojore të stafit drejtues të Agjencisë, në bazë të *kërkesës specifike*, që përcaktohet me nenin 5, paragrafi 7, pika (XIV), nenin 9, paragrafi 6 dhe nenin 37, paragrafi 5, që ndërlidhet me ndonjë aktivitet të AKI-së ka pasur edhe këto raporte me shkrim:

Raport lidhur me vrasjen e ndodhur brenda ndërtesës së AKI-së.

Raport nga Policia lidhur me rastin e familjarit të Drejtorit të AKI-së, z. Shpend Maxhuni

Raport lidhur me rastin e personit të rrejshëm si punonjës i AKI –së.

Në përgjithësi, raportime gojore të stafit menaxhues të AKI-së, gjatë vitit 2018, kanë qenë 6 (gjashtë). Dy raportime të Drejtorit të AKI, z. Driton Gashi , dy raportime të

Inspektorit të Pergjithshëm z. Shkëlzen Sopjani dhe dy raportime të Drejtorit aktual z. Shpend Maxhuni.

d. Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private

Në këtë vit, Komisioni ka pasur për shqyrtim këto kërkesa :

- Kërkesë nga Prokuroria themelore e Prishtinës për sigurim informacioni lidhur me çështje të caktuar për punën e AKI-së.
- Kërkesë nga stafi menaxhues i AKI –së për përjashtim nga fushëveprimi i Projektligjit për paga
- Kërkesë nga stafi menaxhues i AKI-së për mbështetje në punën e AKI-së.

e. Mbajtja e dëgjimeve publike

Gjithashtu, Komisioni gjatë vitit 2018, nuk ka pasur të organizuar dhe të realizuar ndonjë dëgjim publik.

f. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Komisioni, gjatë vitit 2018, në planin e tij të punës nuk ka pasur të përcaktuar mbikëqyrjen e zbatimit të ndonjë Ligji.

g. Vizitat e Komisionit brenda dhe jashtë vendit

Brenda vendit, Komisioni ka realizuar vizitat, si në vijim:

- Vizitë zyrtare në selinë qendrore të AKI-së, më 12 Tetor 2018
- Vizitë zyrtare në Drejtorinë Rajonale të AKI-së në Prizren , më 18 Korrik 2018.
- Vizitë zyrtare në Drejtorinë Rajonale të AKI-së në Mitrovicë, më 12 Qershor 2018.
- Vizitë zyrtare në Drejtorinë Rajonale të AKI-së në Ferizaj, më 15 Maj 2018.
- Vizitë zyrtare në Drejtorinë Rajonale të AKI-së në Pejë, më 08 Maj 2018.

Jashtë vendit, Komisioni, respektivisht zëvendëskryetarja e parë e Komisionit znj. Ganimete Musliu ka zhvilluar vizitë zyrtare:

- Budva, Mali i zi nga data 14-16 nëntor organizuar nga Instituti ndërkombëtarë Republikan me temë "Qasjet bashkëpunuese për përballimin e ekstremizmit përmes veprimit"
- Bruksel në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, më datë 28-31 Janar 2018.

h. Pjesëmarrja e Komisionit në tryeza të rrumbullakëta brenda vendit

Gjatë vitit 2018, Komisioni për AKI ka marr pjesë në 2 (dy) tryeza të rrumbullakëta brenda vendit të cilat janë organizuar nga DCAF , si me poshtë:

- **Monitorimi i zbatimit të Ligjit të Kosovës për përgjimin e komunikimeve elektronike (05 Korrik 2018).**
- **Çështjet dhe sfidat e llogaridhënës së inteligjencës ne shoqëritë demokratike (26 Shkurt 2018)**

i. Pritja e delegacioneve parlamentare të huaja (homologe)

Në këtë vit, Komisioni nuk ka pritur ndonjë delegacion të huaj parlamentar, në cilësinë e homologut.

j. Takimet individuale të kryetarit dhe anëtarëve të tjerë të Komisionit

Zëvendës Kryetarja e parë e Komisionit ka realizuar një takim individual me përfaqësuesit e Qendrës së Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), realizuar më 11 dhjetor 2018.

IV. Rezyme e punës së Komisioni

Tabela A – Pasqyrimi në formë tabelore i indikatorëve matës të punës së Komisionit

Nr.	Indikatorët	Rezultati
1	Numri i mbledhje të mbajtura	19
2	Numri i pikave të rendit të ditës	42
3	Procesverbale të hartuara	17
4	Projektligje të shqyrtuara	/
5	Numri i grupeve punuese të formuara	/
6	Numri i mbledhjeve të grupeve punuese	/
7	Numri i amendamenteve të propozuara	/
8	Numri i amendamenteve të shqyrtuara	/
9	Numri i raporteve të hartuara për projektligje	/
10	Dhënia e mendimeve komisioneve të tjera	/
11	Shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese (raporte specifike)	3
12	Shqyrtimi i kërkesave të institucioneve publike dhe private	3
13	Numri i vendimeve që i ka marrë Komisioni	4
14	Vizitat e realizuara jashtë vendit	2
15	Vizitat e realizuara brenda vendit	5
16	Dëgjime publike	/
17	Monitorimi i ligjeve	/
18	Raportimi i drejtorit dhe zëvendës drejtorit të AKI-së	4
19	Raportim i inspektorit të Përgjithshëm të AKI-së	2

Komisionet ad-hoc

I. HYRJE

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 71 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi mund ta formojë një komision ad-hoc, që e ka autoritetin e Komisionit funksional. Komisioni ad-hoc është komision i përkohshëm, i cili merret me shqyrtimin e një çështjeje të veçantë. Nëse Kuvendi e formon një komision ad-hoc, në vendimin e formimit duhet të përfshihet përbërja e komisionit, në përputhje me nenin 63 të Rregullores.

II. MBLEDHJET E KOMISIONEVE

Në mbledhje, komisionet kanë shqyrtuar listat e kandidatëve të cilët kanë aplikuar për anëtarë dhe kanë ftuar për intervistë kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore për të qenë anëtarë. Gjatë intervistimit të kandidatëve, anëtarët e komisionit kanë vlerësuar me pikë, secilin kandidat në fletë vlerësimet e tyre, secili anëtar i komisionit ka pasur një fletë- vlerësim dhe poentimi ka qenë i fshehtë.

Gjatë vitit 2018, janë mbajtur mbledhjet si në vijim:

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e 2 anëtarëve të Bordit të RTK-së, ka mbajtur 3 mbledhje ka mbajtur 2 mbledhje me dt.07, 09 dhe 22.02.2018.

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e 1 anëtari të Bordit për Ankesa të Mediave, ka mbajtur 1 mbledhje me dt.20.02.2018.

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e 3 anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, ka mbajtur 2 mbledhje me dt.26.03 dhe 20.04.2018.

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e 2 anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, ka mbajtur 1 mbledhje me dt.08.05.2018.

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e 1 anëtari të Bordit të RTK-së, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, ka mbajtur 1 mbledhje me dt.23.05.2018.

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e 1 anëtari të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komuniteteve jo-shumicë, ka mbajtur 1 mbledhje me dt.25.06.2018.

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e 3 anëtarëve të Bordit të RTK-së, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, ka mbajtur 2 mbledhje me dt.25 dhe 31.11.2018.

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e 1 anëtari të Bordit të RTK-së, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, ka mbajtur 1 mbledhje me dt.05.11.2018.

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e 1 anëtari të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komuniteteve jo-shumicë, ka mbajtur 1 mbledhje me dt. 23.11.2018.

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e 1 anëtari të Bordit të RTK-së, nga radhët e komunitetit serb, ka mbajtur 1 mbledhje me dt. 26.11.2018.

Komisionet ad-hoc kanë hartuar rekomandimet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarëve në organet e pavarura.

Tabela A - Pasqyra e përgjithshme e punës së komisioneve gjatë vitit 2018

	Mbledhjet	Totali
Mbledhjet e mbajtura	12	12
Kandidatët e propozuar për anëtarë	124	124
Rekomandimet e komisioneve	10	10

Institucionet dhe Agjencionet e Pavarura

Zgjedhja e anëtarëve në bordet e institucioneve dhe agjencive të pavarura,

- Zgjedhja e një (1) anëtari joekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, më datën 26 janar 2018,
- Zgjedhja e pesë (5) zëvendësavokatëve të popullit, më datën 26 janar 2018,
- Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Mbrotjen e Komplekseve Memoriale të Kosovës, më datën 6 qershor 2018,
- Zgjedhja e një (1) anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore, më datën 30 mars 2018,
- Zgjedhja e dy (2) anëtarëve në Komisionin për Verifikim dhe Vendosje për Prona, më datën 30 mars 2018,
- Zgjedhja e dy (2) anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit për Energji, më datën 15 mars 2018,
- Zgjedhja e një (1) anëtari në Bordin e Ankesave të Mediave, më datën 15 mars 2018,
- Zgjedhja e pesë (5) anëtarëve dhe zëvendësve në Komisionin për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, më datën 15 mars 2018,
- Zgjedhja e një (1) anëtari nga komuniteti serb në Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës, më datën 15 mars 2018,
- Zgjedhja e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, më datën 15 mars 2018 (i dekretuar nga Presidenti, më datën 29 mars 2018),
- Zgjedhja e gjashtë (6) anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare për Privatizim, më datën 31 maj 2018,
- Zgjedhja e një (1) anëtari nga komuniteti shqiptar në Komisionin e Pavarur për Media, më datën 17 prill 2018,
- Zgjedhja e një (1) anëtari nga komuniteti serb në Komisionin e Pavarur për Media, më datën 17 prill 2018,
- Zgjedhja e dy (2) anëtarëve nga komunitetet e tjera në Komisionin e Pavarur për Media, më datën 30 maj 2018,
- Zgjedhja e dy (2) anëtarëve nga komunitetet pakicë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, më datën 18 maj 2018,
- Zgjedhja e tre (3) gjyqëtarëve nga komuniteti shqiptar në Gjykatën Kushtetuese, më datën 6 korrik 2018,
- Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, më datën 15 tetor 2018,
- Zgjedhja e kryesuesit dhe katër (4) anëtarëve të Bordit Drejtues të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, më datën 2 nëntor 2018,
- Zgjedhja e kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, më datën 2 nëntor 2018,
- Zgjedhja e një (1) anëtari në Komisionin e Pavarur për Media nga komuniteti shqiptar, më datën 30 nëntor 2018.

Raportet vjetore të institucioneve dhe agjencive të pavarura për periudhën e vitit 2017, të shqyrtuara në Komisionet funksionale të Kuvendit të Kosovës

1. Raporti vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, i miratuar, më datën 19 prill 2018,
2. Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji, i miratuar, më datën 20 prill 2018,

3. Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, i miratuar, më datën 24 prill 2018,
4. Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit, i miratuar, më datën 24 prill 2018,
5. Raporti vjetor i Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas, i miratuar, më datën 24 prill 2018,
6. Raporti vjetor i Agjencisë Shtetërore për Mbrotjen e të Dhënave Personale, i miratuar, më datën 24 prill 2018,
7. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, i miratuar, më datën 25 prill 2018,
8. Raporti vjetor i Akademisë së Drejtësisë, i miratuar më datën 2 maj 2018,
9. Raporti vjetor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, i miratuar, më datën 7 maj 2018,
10. Raporti vjetor i Autoitetit të Aviacionit Civil, i miratuar, më datën 7 maj 2018,
11. Raporti vjetor i Autoritetit të Pavarur të Konkurrencës, i miratuar, më datën 22 maj 2018,
12. Raporti vjetor i Organit Shqyrtues të Prokurimit, i miratuar, më datën 24 maj 2018,
13. Raporti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit, i miratuar, më datën 24 maj 2018,
14. Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, i miratuar, më datën 2 qershor 2018,
15. Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, i miratuar, më datën 12 qershor 2018,
16. Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, i miratuar më datën 3 korrik 2018,
17. Raporti vjetor i KOSTT sh.a , i miratuar, më datën 10 korrik 2018,
18. Raporti vjetor i Përfomancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, i miratuar, më datën 10 korrik 2018,
19. Raporti vjetor i RTK-së, i miratuar, më datën 22 qershor 2018,
20. Raporti vjetor i ARKEP, i miratuar, më datën 17 korrik 2018,
21. Raporti vjetor i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, i miratuar, më datën 18 korrik 2018,
22. Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, i miratuar, më datën 25 korrik 2018
23. Raporti vjetor i Përfomancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, i miratuar, më datën 10 korrik 2018,
24. Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media, i miratuar, më datën 15 tetor 2018.

Raportet vjetore të pamiratur në Komisionet funksionale

1. Raporti vjetor i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i pamiratur, më datën 08 maj 2018,

Raportet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës

1. Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji, i miratuar më datën 30 maj 2018,
2. Raporti vjetor i Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas, i miratuar më datën 30 maj 2018,

3. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit, i miratuar më datën 4 qershor 2018,
4. Raporti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit, i miratuar më datën 6 qershor 2018,
5. Raporti i Organit Shqyrtues të Prokurimit, i miratuar më datën 14 qershor 2018,
6. Raporti vjetor i Autoritetit të Pavarur të Konkurrencës, i miratuar më datën 6 qershor 2018,
7. Raporti vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, i miratuar më datën 6 qershor 2018,
8. Raporti vjetor i Akademisë së Drejtësisë, i miratuar më datën 14 qershor 2018,
9. Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, i miratua me datën 23 korrik 2018,
10. Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, i miratuar më datën 23 korrik 2018,
11. Raporti vjetor i Agjencisë Shtetërore për Mbrotjen e të Dhënave Personale, i miratuar më datën 23 korrik 2018,
12. Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, i miratuar më datën 23 korrik 2018,
13. Raporti i Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, i miratuar, më 15 tetor 2018,
14. Raporti i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, i miratuar, më datën 15 tetor 2018,
15. Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Kosovës, i miratuar, më datën 15 tetor 2018
16. Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil, i miratuar më datën 15 tetor 2018,
17. Raporti vjetor i Trustit Pensional të Kosovës, i miratuar, më datën 15 tetor 2018,
18. Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media, i miratuar më datën 21 dhjetor 2018,
19. Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, i miratuar, më datën 02 nëntor 2018,

Raportet vjetore të pamiruar nga Kuvendi i Kosovës

1. Raporti vjetor Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, nuk është miratuar me datën 23 korrik 2018,
2. Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, nuk është miratuar, më datën 15 tetor 2018.

Raportet vjetore që kanë mbetur pa u shqyrtuar në mungesë të Bordit në Komisionet funksionale

1. Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
2. Raporti vjetor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,
3. Raporti vjetor i KOSTT.

Raportet vjetore që kanë mbetur në procedurë të shqyrtimit në Kuvendin e Kosovës

1. Raporti vjetor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Letra e kryetarit të Kuvendit për Qeverinë dhe institucionet e tjera

Nëpër mes Zyrës së kryetarit të Kuvendit për Qeverinë dhe institucionet e tjera janë dërguar letra, që të ndërmerren veprime ligjore për dërgimin e propozimeve me kandidatët për emërim nga Kuvendi i Kosovës:

1. Letra e kryetarit për kryeministrin për dërgimin e kandidatëve për kryetar të Komisionit Rregullativ të Prokurimit, më datën 13 gusht 2018,
2. Letra e kryetarit për kryeministrin për dhënien e mendimit nga Qeveria në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për pesë (5) kandidatët për anëtarë të Bordit Drejtues të Trustit të Kursimeve Pensionale, më datën 11 shtator 2018,
3. Letra e kryetarit për kryeministrin për dhënien sqarimeve në letrën të përgatitur nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, më datën 17 shtator 2018,
4. Letra e dytë e kryetarit Letra e kryetarit për kryeministrin për dhënien sqarimeve në letrën të përgatitur nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, më datën 10 tetor 2018,
5. Letra e kryetarit të Kuvendit për kryeministrin për riprocedimin në Kuvend për shqyrtim të Strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit, më datën 11 tetor 2018.

Organizimi i tryezave me institucionet dhe agjencitë e pavarura

Më datën 22 maj 2018, në kuadër të DMKP, me përkrahje të organizatë joqeveritare INDEP, është organizuar një tryezë pune me të gjitha institucionet dhe agjencitë e pavarura, me temën: “Transparenca dhe Raportimi i Agjencive të Pavarura - Raportet vjetore dhe financiare dhe Opinioni i Zyrës Kombëtare të Auditimit”. Në këtë tryezë kanë marrur pjesë përfaqësuesit e institucioneve dhe agjencive të pavarura, kryetarët nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri dhe Zhvillim Rajonal si dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zyrtarë të lartë nga administrata e Kuvendit.

Përditësimi i databazës me të dhënat për institucionet dhe agjencitë e pavarura

Brenda përgjegjësive si aktivitet primar mbetet në vazhdimësi, përditësimi i të dhënave në databazën e institucioneve dhe agjencive të pavarura, mbi bazën e vendimeve të seancave plenare të Kuvendit të Kosovës për emërimin e anëtarëve të bordeve, drejtorë/kryesues dhe skadimit të mandateve.

Në sistem e databazës për përditësim mbahen tridhjetë e katër(34) institucione dhe agjenci të pavarura.


Hulumtimet legislative/ parlamentare

Për mbështetjen e punës së komisioneve parlamentare dhe deputetëve individualë, në procesin ligjvënës, shërbimi për hulumtime legislative i Kuvendit, për periudhën raportuese ka përgatitur **42 hulumtime parlamentare**.

Poashtu, me mbështetjen e USAID-të amerikan është duke u realizuar projekti “Përkrahje për Hulumtime Parlamentare dhe Përfshirje qytetare” ref: [RFA-167-14-000007](#), i cili implementohet nga KDI, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli dhe Shefit të USAID-të në Kosovë, James Hope. Qëllimi i këtij projekti të financuar nga USAID amerikan është rritja e pjesëmarrjes qytetare/shoqërisë civile, me kontribut substancial në agjendën legislative të Kuvendit. Me përkrahjen e këtij projekti në mbështetje të punës së Komisioneve parlamentare gjatë vitit 2018, janë hartuar **23 hulumtime**, të cilat janë përgatitur nga hulumtues nga shoqëria civile (ekspertë individualë dhe OJQ).

Paraqitja tabelare e hulumtimeve të përgatitura gjatë vitit 2018:

Hulumtimet e përgatitura gjatë vitit 2018	
<i>Hulumtime të përgatitura nga Shërbimi për hulumtime legislative i Kuvendit të Kosovës</i>	42
<i>Hulumtime të përgatitura nga Projekti i financuar nga USAID: hulumtues nga shoqëria civile (ekspertë individualë dhe OJQ)</i>	23
Gjithsejt:	65



Transparenca e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Gjatë tërë vitit 2018, Drejtoria për media dhe marrëdhënie me publikun ka vazhduar të kryejë punën dhe përgjegjësitë konform përshkrimit të detyrave të saj, në funksion të rritjes së transparencës së Kuvendit dhe lehtësimit të qasjes së mediave dhe të publikut në punën e tij.

Përcjellja e aktiviteteve dhe hartimi i komunikatave

Drejtoria ka ndjekur të gjitha mbledhjet dhe takimet e paralajmëruara të Kuvendit dhe të organeve të tij, ka hartuar informacionet (komunikatat) për to, i ka postuar në uebfaqe të Kuvendit dhe ua ka dërguar ato mediave.

Po ashtu, agjenda e mbledhjeve dhe takimeve paraprkishtë është bërë publike në uebfaqe të Kuvendit dhe në shumë raste u është dërguar edhe mediave në mënyrë elektronike.

Gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2018, janë hartuar dhe publikuar gjithsej 1 mijë lajme, që mbulojnë aktivitete të Kuvendit, si: seanca, mbledhje të Kryesisë, takime të kryetarit, të nënkryetarëve, të deputetëve, mbledhje të komisioneve, dëgjime publike, takime të sekretarit të Kuvendit, aktivitete të Grupit të Grave Deputete, të delegacioneve të ndryshme të Kuvendit etj.

Akreditimi i përfaqësuesve të mediave në Kuvend

Një segment i rëndësishëm i punës së Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, gjithsesi ka qenë bashkëpunimi dhe kontakti me gazetarët, fotoreporterët dhe xhiruesit e mediave të shkruara dhe elektronike nga vendi dhe bota.

Konform planit të punës, Drejtoria, përkatësisht Kuvendi, ka kryer procesin e akreditimit të përfaqësuesve të mediave.

Akreditim për vitin 2018 u janë dhënë gjithsej 422 përfaqësuesve të mediave: gazetarë, fotoreporterë dhe xhirues.

Revista “Kuvendi” dhe materialet promovuese

Janë publikuar gjithashtu tre numra të revistës “Kuvendi”, në shqip, serbisht dhe turqisht, si dhe materiale të tjera promovuese për punën e Kuvendit, si: Deklarata e Pavarësisë, broshura “Kuvendi sot”, fletëpalosje për Kryesinë e Kuvendit dhe për komisionet parlamentare.

Shënimi i ditëve të hapura dhe vizitorët në Kuvend

Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me publikun ka vazhduar të lehtësojë qasjen e qytetarëve në punën e Kuvendit, duke mundësuar vizita të shumta të grupeve të ndryshme në mjediset e Kuvendit dhe takime me deputetë.

Dhjetëra grupe qytetarësh janë pritur në takime të veçanta nga Kryetari i Kuvendit dhe deputetë të tjerë.

Duke marrë parasysh që 2018-ta ishte vit jubilar i shpalljes së pavarësisë, vizitat ishin të koncentruara kryesisht gjatë muajit shkurt, në vigjilje të festimeve për kremen e pavarësisë.

Edhe këtë vit, Kuvendi ka shënuar 1 Qershorin - Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, Ditët e Diasporës dhe 15 Shtatorin - Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë.

Gjatë këtyre ditëve, mijëra nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, bashkatdhetarë dhe qytetarë të tjerë nga e gjithë Kosova, kanë vizituar Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë takuar me deputetë dhe janë njohur me punën e tyre.

Po ashtu, janë organizuar edhe aktivitete të tjera që afirmojnë demokracinë dhe jetën parlamentare.

Edhe gjatë vitit 2018, ka vazhduar programi i Kuvendit për filloristë, Punëtoritë për demokraci “Demos-ti”, i përkrahur nga fondacioni ERSTE, me implementues OJQ TOKA.

Në përgjithësi, gjatë 12 muajve, Kuvendin e kanë vizituar 270 grupe, apo rreth 8 mijë vizitorë gjithsej, të grupmoshave dhe etnive të ndryshme.

Takimet e hapura me qytetarë

Për të nxitur një komunikim më efektiv midis qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur, në mars të vitit 2018, Kuvendi ka lansuar programin “Ditët e Kuvendit”.

Gjatë vitit 2018, Kuvendi mbajtur takime/debate të hapura me qytetarë në 10 komuna të Kosovës, duke përfshirë më shumë se një mijë qytetarë në këto takime.

Ato u mundësuan qytetarëve t’i shprehin shqetësimet dhe prioritetet e tyre te përfaqësuesit e zgjedhur.

Qasja në dokumente publike

Po ashtu Kuvendi ka trajtuar edhe kërkesat për qasjen në dokumente publike. Janë adresuar pesë kërkesa të tilla, në të cilat Kuvendi është përgjigjur pozitivisht dhe brenda afatit ligjor.

Miratimi i Strategjisë për informim dhe komunikim

Gjatë vitit të kaluar ka vazhduar puna për plotësim-ndryshimin e Rregullores për rendin dhe qasjen e mediave dhe të publikut në punën e Kuvendit, si dhe hartimin të Strategjisë për komunikim dhe informim.

Më 3 dhjetor 2018, Strategjia për komunikim dhe informim i është shpërndarë Kryesisë së Kosovës, e cila të njëjtën e ka miratuar më 18 janar 2019.

Strategjia, përveç misionit dhe vizionit për të forcuar më tej komunikimin me mediat dhe publikun në përgjithësi, si dhe për të rritur dhe lehtësuar qasjen e qytetarëve në punën legislative, parasheh në hollësi veprimet që duhet ndërmarrë gjatë tre vjetëve në vijim, për të realizuar këto synime.

Një objektivë e veçantë i kushtohet veprimeve të Kuvendit në fushën e informimit të qytetarëve lidhur me procesin e zbatimit të MSA-së dhe procesit të integritimit evropian.

Hapja e faqes zyrtare të Kuvendit në Facebook

Për të rritur praninë në mediat sociale dhe në funksion të përcjelljes së trendit të zhvillimit teknologjik, me mbështetjen e NDI-së, në shtator Kuvendi ka hapur faqen zyrtare në Facebook, në të cilën publikohen lajme dhe informacione nga puna e Kuvendit dhe e organeve të tij.

PROTOKOLLI DHE MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2018 të Legjislaturës së VI-të, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka luajtur rol aktiv në fushën ndërkombëtare dy palëshe dhe shumëpalëshe me qëllim të plotësimit të diplomacisë zyrtare në përputhje me qëllimet strategjike të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës. Për të arritur këtë qëllim, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës SH.T.Z. Kadri Veseli, ka vazhduar bashkëpunimin me përfaqësues të Trupit Diplomatik në Prishtinë, dhe me homolog të parlamenteve të vendeve tjera dhe anëtarë të parlamenteve në asamble ndër-parlamentare, si dhe me organizata të ndryshme ndërkombëtare si; Parlamenti Evropian, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Asambleja Parlamentare të NATO-së, Asambleja Parlamentare e OSBE-së, Asambleja Parlamentare për Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (PBEJL-SEECF) dhe organizatat tjera rajonale.

I. Aktivitetet e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, SH.T. Kadri Veseli, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2018

Kryetari i Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2018 ka realizuar gjithësej: katërmëdhjetë (14) vizita zyrtare jashtë Republikës së Kosovës, ndërsa ka realizuar 90 takime brenda Republikës së Kosovës.

Telegrame urimi të dërguara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës SH.T.Z. Kadri Veseli, drejtuar homologëve në parlamentet e shteteve tjera: 9 telegrame urimi.

Shkresa të dërguara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës SH.T.Z. Kadri Veseli, drejtuar homologëve në parlamentet e shteteve tjera: shtatë (7)

II. Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare

Bashkëpunimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës me institucione/ parlamente/ organizata të ndryshme ndërkombëtare në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndërparlamentare:

Bashkëpunimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës me Parlamentin Evropian:

- Pjesëmarrja e delegacioneve të Kuvendit të Republikës së Kosovës në aktivitetet e organizuara nga Parlamenti Evropian në: Seminare – Konferenca: Nëntë (9)
- Pjesëmarrje në Programin Fellowship të Parlamentit Evropian për zyrtarët e administratës Parlamenteve të vendeve të Para – Anëtarësimi: Një (1)

Bashkëpunimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës me Asamblenë Parlamentare të NATO-s:

Pjesëmarrje të delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Sesione të rregullta të Asamblesë Parlamentare të NATO-së si dhe pjesëmarrje në Seminare Rose Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-së: Pesë (5)

Bashkëpunimi i Kuvendit të Kosovës me Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKiE):

Pjesëmarrja e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në aktivitetet e organizuara nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në Sesione të Rregullta dhe takime të Komisioneve Parlamentare të mbajtura në Selinë e AP të Këshillit të Evropës në Strasbourg të Francës: Shtatë (7)

Bashkëpunimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës me Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore AP PBEJL- (SEEC) : Gjashtë (6)

Bashkëpunim me Grupe të Miqësisë Kuvendin e Kosovës të delegacioneve të parlamenteve tjera në kuadër të bashkëpunimit me Grupet parlamentare të Miqësisë të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Dy (2)

Shkresa drejtuar Kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit të Kosovës për lejimin e udhëtimeve zyrtare: Dyqind e gjashtëdhjetë e tre (263)

Raportet preliminare dhe hartimi i deklaratës së pajtueshmërisë së projektakteve të iniciuara nga Kuvendi

Sherbimi perkates i administratës së Kuvendit, sa i përket raporteve preliminare dhe deklaratave të pajtueshmërisë së projektligjeve të propozuara nga Kuvendi me acquis të BE, gjatë vitit 2018 ka pergaditur si vijon:

Nr.	Aktiviteti	Gjithsej
1	Raporte preliminare për projektligjet	18
2	Hartimi i deklaratës së pajtueshmërisë së projektligjit me legjislacionin e BE-së për projektligjet e propozuara nga Kuvendi i Kosovës	16
3	Formatizimin, standardizimin dhe inkorporimin e amendamenteve dhe krahasimin e këtyre ligjeve në të tri gjuhët (shqip, serbisht dhe anglisht)	75
4	Përgatitjen e ligjeve të dekretuara së bashku me shkresën përcjellëse për publikim në Gazetën Zyrtare	75
5	Përkthimi i amendamenteve në gjuhën angleze	1370 amandamente
6	Materiali i përkthyer në gjuhën angleze	174 faqe

Të dhënat për të punësuarit në Administratën e Kuvendit të Kosovës në vitin 2018

Puna e Kuvendit të Kosovës mbështetet nga Administrata e Kuvendit e cila ofron shërbime profesionale, si dhe shërbime tekniko – administrative për nevojat e Kuvendit dhe organeve që veprojnë në kuadër të tij. Të gjithë këta të punësuar duke filluar nga Sekretari i Kuvendit, si zyrtari më i lartë, janë nëpunës civilë të trajtuar sipas Ligjit të Shërbimit Civil.

Të dhënat për vitin 2018:

Nr. i shërbyesve civilë	Të rekrutuar	Të larguar (vdekur)	Të pensionuar
186	9	-	2

TË DHËNAT PËR BUXHETIN E KUVENDIT GJATË VITIT 2018

Raporti i buxhetit për vitin 2018 sipas Ligjit nr. 06/L-020, përfshin raportet e buxhetit dhe shpenzimeve sipas SIMFK-së, për programet: 1. Deputetët e Kuvendit 2. Administrata e Kuvendit 3. Stafi mbështetës politik.

Shpenzimet për vitin 2018 për tri programet e lartcekura janë 8.851.012,96 €

Në tabelën e mëposhtme do të paraqesim buxhetin vjetor sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2018 nr. 06/L-020, buxhetin në SIMFK ku do të japim edhe sqarimet e nevojshme për ndarjet.

TNA

Raport buxheti

	Buxheti vjetor	Buxheti përfundimtar 2018	Shpenzimet 2018	Progresi vjetor
Përshkrimi	Ligji nr. 06/L-020	SIMFK		%
	a	b	c	d=c/b
Gjithsej	11.440.534	9.572.363,98	8.851.012,96	92,46
Pagat dhe mëditjet	7.261.534	6.837.448,34	6.837.448,34	100
Mallrat dhe shërbimet	2.312.000	2.212.892,00	1.551.315,74	70,10
Shpenzimet komunale	241,000	197.911,04	179.444,34	90,67
Subvencione dhe transfere	140.000	128.312,60	128.312,60	100
Shpenzimet kapitale	1.486.000	195.800,00	154.491,94	78,90

Nga tabela e mësipërme shihet buxheti i ndarë vjetor sipas Ligjit 06/L-020, buxheti përfundimtarë në SIMFK, shpenzimet e bëra si dhe raporti në mes shpenzimeve dhe buxhetit vjetor (SIMFK).

Raporti në mes të shpenzimeve dhe buxhetit përfundimtarë (SIMFK) tregon një shpenzim të buxhetit krahasuar me buxhetin vjetor 92,46%.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet raporti i buxhetit dhe shpenzimeve sipas programeve duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-020, buxhetin në SIMFK si dhe shpenzimet për të gjitha programet.

Përshkrimi	Buxheti vjetor sipas ligjit 06/L -020	Buxheti përfundimtarë në SIMFK	Deputetët e Kuvendit Shpenzimet	Administrata e Kuvendit Shpenzimet	Stafi mbështetës politik shpenzimet	Totali i Shpenzimeve
	a	b	c	d	e	f=c+d+e
Gjithsej	11.440.534	9.572.363,98	4.497.031,76	3.362.271,28	991.709,92	8.851.012,96
Pagat dhe mëditjet	7.261.534	6.837.448,34	3.735.672,39	2.245.632,85	856.143,10	6.837.448,34
Mallrat dhe shërbimet	2.312.000	2.212.892,00	633.046,77	782.702,15	135.566,82	1.551.315,74
Shpenzimet komunale	241,000	197.911,04		179.444,34		179.444,34
Subvencione dhe transfere	140.000	128.312,60	128.312,60			128.312,60
Investimet kapitale	1.486.000	195.800,00		154.491,94		154.491,94

Në kolonën **a** paraqitet buxheti i ndarë vjetor, në kolonën **b** paraqitet buxheti përfundimtarë në SIMFK, ndërsa në kolonat **c,d,e** paraqiten shpenzimet sipas programeve, derisa kolona **f** paraqet shpenzimin total për të gjitha programet .Në mënyrë më të hollësishme për secilin program buxhetin dhe shpenzimet do ti paraqesim në tabelat në vijim.

Numri i të punësuarve i lejuar me Ligjin e Buxhetit për vitin 2018 dhe numri i të punësuarve në muajin dhjetor 2018

Programet	Numri i punëtorëve në ligjin e buxhetit 2018	Numri aktual i punëtorëve në fund të 2018	Me orar të shkurtuar
Anëtarët e Kuvendit	120	119	0
Administrata e Kuvendit	214	183	0

Stafi Mbështetës Politik	60	59	0
Gjithsej	394	361	0

Në tabelën e mëposhtme paraqesim buxhetin dhe shpenzimet për programin Deputetët e Kuvendit

	Buxheti vjetor për vitin 2018	Buxheti përfundimtarë në SIMFK	Shpenzimet 2018	Progresi
Përshkrimi	Ligji nr. 06/L-020			
	a	b	c	d=c/b
Pagat dhe mëditjet	3.949.389,50	3.375.672,39	3.375.672,39	100
Mallrat dhe shërbimet	1.040.000	1.025.000,00	633.046,77	61,76
Subvencione	140.000	128.312,60	128.312,60	100
Gjithsej	5.129.389,50	4.888.984,99	4.497.031,76	91,98

Në kolonën **a** paraqitet buxheti i ndarë vjetor sipas Ligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, në kolonën **b** kemi paraqitur buxhetin përfundimtarë në SIMFK, ndërsa në kolonën **c** paraqiten shpenzimet.

Shpenzimet e bëra për vitin 2018 shihen për të gjitha kategoritë ekonomike por edhe për nga totali i tyre, ndërsa përqindja e shpenzimeve në krahasim me buxhetin përfundimtarë shihen në kolonën **d**.

Raporti në mes të buxhetit dhe shpenzimeve për vitin 2018 tregon një shpenzim të buxhetit krahasuar me buxhetin vjetor në SIMFK prej 91,98%.

Në tabelën e mëposhtme paraqesim buxhetin dhe shpenzimet për programin Administrata e Kuvendit

	Buxheti vjetor për vitin 2018	Buxheti përfundimtarë në SIMFK	Shpenzimet 2018	Progresi
Përshkrimi	Ligji nr. 06/L-020			
	a	b	c	d=c/b
Pagat dhe mëditjet	2.456.113,43	2.245.632,85	2.245.632,85	100

Mallrat dhe shërbimet	1.142.000	1.042.892,00	782.702,15	75,05
Shpenzime komunale	241.000	197.911,04	179.444,34	90,67
Investime Kapitale	1.486.000	195.800,00	154.491,94	78,90
Gjithsej	5.325.113,43	3.682.235,89	3.362.271,28	91,31

Në kolonën **a** paraqitet buxheti i ndarë vjetor sipas Ligjit nr. 06/L-020, për Buxhetin e Republikës së Kosovës, ne kolonën **b** kemi paraqitur buxhetin përfundimtarë në SIMFK, ndërsa në kolonën **c** paraqiten shpenzimet e bëra për të gjitha kategoritë ekonomike por edhe për nga totali i tyre. Raporti në mes të buxhetit dhe shpenzimeve tregon një shpenzim të buxhetit për 91,31% .

Në tabelën e mëposhtme paraqesim buxhetin dhe shpenzimet për programin Stafi mbështetës politik

	Buxheti vjetor për vitin 2018	Buxheti përfundimtarë në SIMFK	Shpenzimet 2018	Progresi
Përshkrimi	Ligji nr. 06/L-020			
	a	b	c	d=c/b
Pagat dhe mëditjet	856.030,96	856.143,10	856.143,10	100
Mallrat dhe shërbimet	130.000	145.000,00	135.566,82	93,49
Gjithsej	986.030,96	1.001.143,10	991.709,92	99,05

Në kolonën **a** paraqitet buxheti i ndarë vjetor sipas Ligjit nr. 06/L-020, për Buxhetin e Republikës së Kosovës, ne kolonën **b** kemi paraqitur buxhetin në SIMFK, ndërsa në kolonën **c** paraqiten shpenzimet e bëra për të gjitha kategoritë ekonomike por edhe për nga totali i tyre. Raporti në mes të buxhetit dhe shpenzimeve tregon një shpenzim të buxhetit për 99,05 %.

TË DHËNAT PËR PROKURIMET E ZHVILLUARA GJATË VITIT 2018

KONTRATAT e nënshkruara gjatë periudhës: 01.01.2018 - 31.12.2018

Nr.	Titulli I kontratës	Shuma (€)
1.	Furnizimi me tepisiona dhe perde	33,610.50
2.	Furnizimi me material për mirëmbajtjen e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës LOT 2: Furnizimi me material sanitarie	11,921.50
3.	Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemit kabllor	20,000.00
4.	Furnizimi me material shpenzues për nevoja të transportit	8,394.00
5.	Furnizimi me pajisje të IT-së	24,891.55
6.	Furnizimi me material të shtypur	2,429.00
7.	Furnizimi me pajisje të TI-së	8,154.91
8.	Furnizimi me pajisje dhe material për qasje të kontrolluar	5,072.20
9.	Furnizimi me mirënjohje me rastin e 10-të vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës	994.08
10.	Furnizimi me toner	7,600.00
11.	Furnizimi me material për mirëmbajtjen e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës LOT 1: Furnizimi me material elektrik	23,546.20
12.	Furnizimi me ujë të pijshëm	29,870.00
13.	Shërbimet mbështetëse në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës	43,800.00
14.	Shërbime të hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës	15,000.00
15.	Krijimi i Qendrës së të dhënave në Kuvendin e Republikës së Kosovës	447,070.00
16.	Shërbime audio-vizuele	54,000.00
17.	Shërbimet mbështetëse në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës	572,265.00
18.	Shërbime të hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës	210,000.00
19.	Furnizimi me libra për bibliotekën e Kuvendit të Republikës së Kosovës	8,916.00
20.	Shtypja e Raportit Fund-Mandator për Legjislaturën V	4,660.00
21.	Shërbime për realizim profesional të fotografive të stafit të Kuvendit	660
22.	Sigurimi i transportit për Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve (1 Qershori)	980
23.	Furnizimi me kapela me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve (1 Qershori)	405
24.	Sigurime shëndetësore për udhëtime zyrtare	5,357.32
25.	Furnizimi me kasete Mini DV dhe USB Memory	562.5
26.	Shërbime të hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës	15,000.00
27.	Shërbimet mbështetëse në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës	41,700.00
28.	Furnizimi dhe montimi i pajisjeve sinjalizuese	770
29.	Furnizimi me material shpenzues për zyrë	570.5
30.	Furnizimi me material për aktivitetin “Ditët e Diasporës - Bashkatdhetarët në Kuvend”	850
31.	Dixhitalizimi i arkivit	93,000.00
32.	Furnizimi me materiav për zyrë LOT 2: Shtypja e materialeve të	7,915.00

	ndryshme	
33.	Furnizimi me materiav për zyrë domosdoshëm për zyrë	LOT 3: Furnizimi me material të 11,276.00
34.	Furnizimi me laptop dhe desktop	LOT 1: Laptop 2 në 1 112,670.00
35.	Furnizimi me laptop dhe desktop tower	LOT 2: Desktop (PC+Monitor) Mini 31,396.30
36.	Furnizimi me orë dore	190
37.	Rifreskimi dhe pavarësimi i TIK-ut	169,000.00
38.	Mirëmbajtja mujore dhe servisimi i liftave në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës	13,908.00
39.	Sigurimi i transportit për ditën ndërkombëtare të demokracisë	980
40.	Material për ditën ndërkombëtare të demokracisë	938
41.	Furnizimi me lule për nevoja protokollare	825
42.	Shërbimet mbështetëse në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës	46,410.00
43.	Servisimi i automjeteve të llojit Toyota Land Cruiser	845
44.	Servisimi i automjetit të tipit land rover frelander	310
45.	Përzgjedhja e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të ZKA-së	6,000.00

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
RAPORTI PËR PUNËN E KUVENDIT GJATË LEGJISLATURËS V
LEGJISLATURA VI

E PËRGATITI:
DREJTORIA PËR HULUMTIME, BIBLIOTEKË DHE ARKIV

KUVENDI I KOSOVËS